



UNITED NATIONS
NORTH MACEDONIA



Raporti Vjetor i Rezultateve të OKB-së në Maqedoninë e Veriut në vitin

2022

PRILL 2023





UNITED NATIONS
NORTH MACEDONIA



Food and Agriculture
Organization of the
United Nations



International
Labour
Organization

IOM
UN MIGRATION



UNITED NATIONS
HUMAN RIGHTS
OFFICE OF THE HIGH COMMISSIONER



UNDRR
UN Office for Disaster Risk Reduction



UNECE

UN
environment
programme



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization



UNHCR
The UN Refugee Agency

unicef



UNODC
United Nations Office on Drugs and Crime



UNOPS

UN
WOMEN



World Health
Organization



UN
VOLUNTEERS

FALËNDERIM

Ky dokument është prodhuar nga Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara (ZKP) në Maqedoninë e Veriut në emër të Ekipit të vendit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut. ZKP dëshiron të falënderojë të gjitha palët e interesuara për kontributin e tyre në përgatitjen e këtij dokumenti.

Versioni i fundit i këtij dokumenti është i disponueshëm në faqen e internetit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut në northmacedonia.un.org.

Për informacione shtesë, ju lutemi kontaktoni: ZKP-në të OKB-së në Maqedoninë e Veriut rc-northmacedonia@un.org

Fotografia e kopertinës: Vizatimi më i bukur nga gara e Kombeve të Bashkuara në vizatim e organizuar në vigjile të Ditës së Kombeve të Bashkuara, si pjesë e fushatës për ruajtjen e mjedisit jetësor, "Kujdesem" ©UN RCO

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë mendimi nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të cilitdo vendi, territori, qyteti ose zone ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me përcaktimin e vijave kufitare ose kufijve të tij.

Të dhënat financiare janë të përkohshme dhe mund të ndryshojnë pas certifikimit financiar.

Përmbajtja

PARATHËNIE	4
KOMBET E BASHKUARA NË MAQEDONINË E VERIUT NË VITIN 2022	5
PARTNERËT KRYESORË TË OKB-SË PËR ZHVILLIM	6
ZHVILLIMET KRYESORE NË KONTEKSTIN VENDOR DHE RAJONAL	7
MBËSHTETJA E OKB-SË PËR PRIORITETET E ZHVILLIMIT KOMBËTAR NËPËRMJET KORNIZËS PËR BASHKËPUNIM	8
2022 REZULTATI	9
REZULTATI 1: Prosperiteti gjithëpërfshirës	9
REZULTATI 2: Shërbime cilësore për të gjithë	12
REZULTATI 3: Mjedis jetësor i shëndetshëm	18
REZULTATI 4: Qeverisja e mirë	22
FINANCIMI DHE PARTNERITETI	25
KOHERENCA, EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETI I OKB-SË	26
VLERËSIMI DHE MËSIMET E NXJERRA	28
FINANCIMI DHE MOBILIZIMI I RESURSEVE	29
Pasqyra financiare	29
Mobilizimi i resurseve	30
OKB NË MAQEDONINË E VERIUT NË VITIN 2023	31
ANEKSET	32

** Për rezultate të detajuara të vitit 2022, shikoni Aneksin (faqe 37)*

Parathënie



*„Ne kemi nevojë për unitet, solidaritet dhe zgjidhje shumëpalëshe për të adresuar krizat e ushqimit dhe energjisë dhe për të eliminuar deficitin e besimit që po minon veprimin global anembanë botës.”
Antonio Guterres, Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara*



Në vitin 2022, shpresat dhe përfitimet nga rimëkëmbja prej COVID-19 dhe ringjallja ekonomike globale u përmbysën nga ndikimi i krizave të energjisë, sigurisë ushqimore dhe financiare – të gjitha të këtë të ndikuara në mënyrë të konsiderueshme nga lufta në Ukrainë – që vazhduan të tendosin ekonominë në nivel global dhe rajonal, duke sfiduar jetesën e njerëzve dhe duke shkaktuar pengesa për arritjen e Agjendës 2030.

Në Maqedoninë e Veriut – si në shumë vende të tjera – konteksti sfidues vendosi një presion të konsiderueshme mbi qeverinë që të vazhdojë t'i prioritetizojë proceset reformuese dhe ndryshimet strukturore, pasi hapësira fiskale është zvogëluar dhe cenueshmëria është rritur.

Në të njëjtën kohë dhe pavarësisht sfidave, vendi bëri përparim të rëndësishëm në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), duke demonstruar përkushtimin e tij të pakompromis për zbatimin dhe adresimin e prioritetëve që shkojnë dorë për dorë me prioritetet dhe qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Sfidat e të sotmes kërkojnë vizion dhe përkushtim, por edhe shkathësi dhe fleksibilitet nga vendimmarrësit, partnerët zbatues dhe shoqëria. Në këtë frymë, viti 2022 ishte edhe një vit i angazhimit të vazhdueshëm strategjik shembullor dhe partneritetit të ngushtë ndërmjet Qeverisë së Maqedonisë së Veriut dhe organizatave të Kombeve të Bashkuara që kanë aktivitete operative për zhvillim në vend.

Zbatimi i Kornizës së Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2021-2025 (KBZhQ), që është dokumenti kryesor strategjik udhëzues për punën e OKB-së në Maqedoninë e Veriut, ka qenë i lidhur ngushtë me procesin e reformës së sistemit për zhvillim të OKB-së, duke u bazuar në parimet kryesore të veprimit të përbashkët dhe efikasitetit të shtuar të sistemit të OKB-së për t'i mbështetur qeveritë dhe shoqëritë drejt zhvillimit të përsheptuar të qëndrueshëm. Për më tepër, ne ishim gjithashtu në gjendje t'i përgjigjeshim së bashku nevojave të reja në kontekstin e krizës aktuale, duke u mbështetur në atë që mësuam gjatë pandemisë së COVID-19.

Ne vazhduam të demonstrojmë për çdo ditë se puna e përbashkët çon në rezultate më të mira dhe më të qëndrueshme, rrit efikasitetin dhe eliminon dyfishimin e veprimeve.

Maqedonia e Veriut ka qenë një mbështetëse e fortë e procesit të reformës së OKB-së - në nivel global, si një kampion i multilateralizmit; dhe në nivel lokal, në vend, ku puna jonë e përbashkët karakterizohet nga një bashkëpunim dhe koordinim

Rosana Duxhak

Koordinator e Përhershme e Kombeve të Bashkuara

i shkëlqyer drejt synimeve tona të përbashkëta në të gjitha fushat prioritare të KBZhQ-së.

Zbatimi i Planeve të Përbashkëta të Punës për vitin 2022 kontribui në adresimin e prioritetëve kryesore të zhvillimit. Ka rritje të punësimit të grupeve të rrezikuara dhe janë krijuar vende pune. Në të njëjtën kohë, është përmirësuar mjedisi rregullator dhe shërbimet për punëtorët, fermerët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Në fushën e shërbimeve sociale, OKB-ja mbështeti reforma të avancuara arsimore dhe sociale përmes zhvillimit të politikave dhe shërbimeve për ata që kanë nevojë. Në fushën e mjedisit jetësor, OKB-ja mbështeti uljen e ndotjes së ajrit në Shkup, rritjen e zonave të mbrojtura dhe përforcimin e mbrojtjes së biodiversitetit. Ndërgjegjësimi i të rinjve për ndryshimet klimatike u rrit dhe rreziqet nga përmblytjet dhe nga epidemitë u reduktuan ose zbutën. Në fushën e qeverisjes së mirë, puna e OKB-së kontribui në vazhdimin e procesit të decentralizimit, decentralizimit fiskal dhe zhvillimit lokal, përparimin me formulimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim për dy dekadat e ardhshme, për një sistem drejtësie të përmirësuar që është miqësor për fëmijët dhe për rritjen e kapaciteteve kombëtare për të realizuar prioritetet strategjike të lidhura me anëtarësimin në BE dhe Agjendën 2030.

Këto janë vetëm disa rezultate për arritjen e të cilave kemi punuar së bashku. Ato janë një dëshmi epër mundësitë, por edhe shpresë – përkundër sfidave që ndikojnë në paqen, stabilitetin dhe zhvillimin socio-ekonomik, të cilat do të ndihen me vite të tëra.

Ato duhet të vazhdojnë të jenë udhërrëfyes në punën tone, pasi ne përpiqemi që askush të mos lihet pas.

Mbështetja e vlerave dhe parimeve të OKB-së të cilat i përmban Karta, të cilat vazhdojnë të vihen në provë, mbetet çelësi për tejkalimin e krizave aktuale përmes përpjekjeve tona të përbashkëta.

Bujar Osmani

Ministër i Punëve të Jashtme

Kombet e Bashkuara në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022



UNITED NATIONS
NORTH MACEDONIA



22

agjenci të OKB-së të përfshira në aktivitete operative për zhvillim në Maqedoninë e Veriut

Kombet e Bashkuara në Maqedoninë e Veriut i realizojnë aktivitetet e tyre në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit, angazhimet për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, agjendën e anëtarësimit në BE dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ) të Agjendës 2030.

OKB-ja ka punuar për arritjen e prioritetëve të përcaktuara në Kornizën e Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të OKB-së 2021-2025 dhe të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, përmes ofrimit të asistencës teknike, zhvillimit të kapaciteteve, shkëmbimit të njohurive dhe programeve inovative pilot.

Në vitin 2022, 22 agjenci të Kombeve të Bashkuara janë përfshirë në aktivitete operative për zhvillim në Maqedoninë e Veriut, duke punuar së bashku përmes Ekipit të Kombeve të Bashkuara në vend (UNCT) dhe nën udhëheqjen e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së (KP), përfaqësuesit të caktuar të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për operacionet e zhvillimit në vend. 17 nga këto organizata kishin prezencë fizike në Maqedoninë e Veriut, ndërsa 5 prej tyre aktivitetet i realizuan nga distanca. Ekipi i OKB-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 përfshinte personel dhe staf mbështetës prej më shumë se 320 personash, të vendosur në vend, si dhe ekspertë nga e gjithë bota.

FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ITU	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit*
IOM	Fondi Monetar Ndërkombëtar
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNDRR	Zyra e OKB-së për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë *
UN-Habitat	Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore*
UNDSS	United Nations Department for Safety and Security
UNECE	Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara *
UNEP	Programi për Mjedisin Jetësor i Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara *
UNFPA	Fondi për Popullsinë i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNICEF	Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara
UNIDO	Organizata për Zhvillimin Industrial e Kombeve të Bashkuara
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve
UNV	Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara*
UN WCO	Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara
UN Women	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave
WHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë

* Prani fizike KBZhQ



Food and Agriculture
Organization of the
United Nations



International
Labour
Organization



IOM
UN MIGRATION



UNITED NATIONS
HUMAN RIGHTS
OFFICE OF THE HIGH COMMISSIONER



UNDRR
UN Office for Disaster Risk Reduction



UNECE



UN
environment
programme



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization



UNFPA



UNHCR
The UN Refugee Agency



UNODC
United Nations Office on Drugs and Crime



UNOPS



UN
WOMEN



World Health
Organization



UN
VOLUNTEERS


Partnerët kryesorë të OKB-së për zhvillim

Gjatë vitit 2022, OKB-ja vazhdoi të punojë ngushtë me mbi 110 partnerë – pushtete qendrore dhe lokale, shoqërinë civile, partnerët ndërkombëtarë, sektorin privat, komunitetin akademik dhe të gjithë aktorët e tjerë – për të mundur rëndësinë dhe ndikimin e veprimit të saj për njerëzit në Maqedoninë e Veriut.

Një listë e detajuar e palëve të interesuara me të cilat OKB-ja ka zhvilluar partneritetet në vitin 2022 është dhënë në aneks.

Partnerët që dhanë kontribute bujare në aktivitetet e OKB-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022*

Të dhënat e datës 31 mars 2023, bazuar në shpenzimet efektive në vitin 2022, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor të vitit 2022, në miliona dollarë amerikanë.



*Kontribuesit e fondeve të tërhequra, vertikale dhe tematike të cilat i mbështetën aktivitetet e OKB-së në Maqedoninë e Veriut në 2022 të paraqitura sipas rendit alfabetik.

Zhvillimet kryesore në kontekstin vendor dhe rajonal

Ndikimi i krizave të ndërlidhura rajonale dhe globale në vitin 2022 i mbingarkoi kapacitetet institucionale në Maqedoninë e Veriut dhe globalisht, dhe kërcënoi seriozisht standardin e jetesës së njerëzve, veçanërisht të grupeve më të rrezikuara.

Kriza globale e energjisë dhe rritja e çmimeve të ushqimeve e vështirësuan ringjalljen ekonomike pas COVID-19, e këto tendenca u intensifikuan edhe më shumë për shkak të luftës në Ukrainë. Ndikimi në Maqedoninë e Veriut ishte kryesisht indirekt për shkak të varësisë së madhe nga importi i energjisë dhe ushqimit, dhe ekspozimit të fortë tregtar në tregjet e Bashkimit Evropian (BE). Njerëzit, por edhe bizneset, e veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) janë goditur fuqishëm nga inflacioni dhe kriza energjetike që minuan konkurrencën tashmë të ulët të ekonomisë. Tregu i punës vazhdoi të rritet në vitin 2022, por papunësia e të rinjve vazhdoi. Financimi i deficitit buxhetor dhe i shpenzimeve sociale u bë gjithnjë e më i vështirë pasi që mekanizmat financiarë vazhduan të shteren dhe tregjet e kapitalit u përkeqësuan.

Kapitali njerëzor mbeti sfida kryesore ekonomike, me një rënie të vazhdueshme të popullsisë të konfirmuar nga Regjistrimi i popullsisë i vitit 2021 për shkak të tendencës së vazhdueshme të plakjes dhe emigrimit. Pavarësisht reformave në arsim, rezultatet e të nxëniet mbetën të ulëta dhe të paharmonizuara sa duhet me aftësitë e nevojshme për tregjet e të ardhmes. Megjithatë ndikimi i COVID-19 u zvogëlu, sistemi shëndetësor vazhdoi të kishte vështirësi për shkak të mungesës së resurseve dhe stafit mjekësor. Reformat sociale dhe lufta kundër informalitetit nuk i kanë dhënë ende rezultatet e synuara, ndërkohë që të drejtat e fëmijëve, veçanërisht të atyre me aftësi të kufizuara, janë përmirësuar.

Përqendrimi në ndryshimet klimatike, mjedisin jetësor dhe burimet natyrore u reduktua për shkak të krizës energjetike, e cila kontribuoi në një përkeqësim të lehtë të ndotjes së ajrit në krahasim me periudhën para COVID-19. Por, rritja e çmimeve të energjisë nxiti gjithashtu stimujt drejt tranzicionit të gjelbër dhe i bëri më tërheqëse investimet në energjinë e ripërtërishme. Vazhduan sfidat në lidhje me tre liqenët kryesore, me ç'rast situata në Prespë dhe në Liqenin e Dojranit është veçanërisht shqetësuese dhe përkeqësohet. Investimet në menaxhimin e ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta, menaxhimin e burimeve natyrore, si dhe fokusi më i madh në riciklim mbetën të pamjaftueshme nga ajo që nevojitet.

Pavarësisht sfidave, në vitin 2022 BE-ja filloi shqyrtimin e nivelit të transpozimit të legjisllacionit të BE-së, por negociatat do të hapen zyrtarisht vetëm pasi të ndryshohet Kushtetuta për të përfshirë grupe etnike shtesë në preambulë. Ndërkohë, sfidat dhe vonesat brenda procesit të anëtarësimit në BE kanë ulur mbështetjen e publikut për integrimin në BE dhe kanë thëlluar polarizimin politik të shoqërisë.

Bashkëpunimi rajonal vazhdoi në mënyrë aktive përmes Dialogut të Forumit të Prespës të nivelit të lartë dhe iniciativës "Ballkani i Hapur". Iniciativa, që synon krijimin e një tregu të vetëm për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, u tregua e dobishme në përballjen e krizës ushqimore dhe energjetike në vitin 2022.

Pavarësisht përmirësimeve në renditjet ndërkombëtare, korrupsioni dhe mungesa e llogaridhënies mbetën problem kryesor shoqëror. Përfshirja dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara dhe e shoqërisë në përgjithësi në hartimin e politikave u përmirësua, por kapaciteti zbatues, barazia dhe

besimi i publikut në institucione vazhduan të zvogëlohen. Qeveria vazhdoi të jetë e përfshirë në mekanizmat e OKB-së dhe mekanizmat evropianë të të drejtave të njeriut, mirëpo integrimi dhe ndjekja e rekomandimeve të tyre mbetën sfida.


Konteksti politik sfidues i ngarkoi edhe më tej kapacitetet institucionale në Maqedoninë e Veriut, ndërsa kriza shumëdimensionale e përkeqësoi mjedisin tashmë të vështirë operativ për pushtetet lokale. Zhvillimi digjital mbetet një nevojë urgjente, me ç'rast vendi shënon rezultat nën mesataren evropiane në një kornizë më të gjerë rregullatore.

Vendi mbetet pjesë e një prej rrugëve kryesore për lëvizjet e përziera të migracionit drejt Evropës, që rezultoi në më shumë se 27.391 kalime të parregullta të kufirit të zbuluara në vitin 2022, kryesisht nga Siria, Pakistani, Maroku dhe vende të tjera. Rreth 22.000 refugjatë mbërritën nga Ukraina, por vetëm 5.900 mbetën në vend. Çrënjësia e problemit të njerëzve pa shtetësi, megjithatë afër zgjidhjes, nuk u arrit në vitin 2022.


Vazhduan konsultimet për të formuluar një Strategji Kombëtare njëzet vjeçare për Zhvillim, e po ashtu u nisën disa reforma të rëndësishme, si reforma e re buxhetore, si dhe politika që i synojnë më mirë grupet e rrezikuara si gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe romët.

Rishikimi në vitin 2022 i Analizës së Përbashkët të Vendit (APV) të OKB-së e përsëriti nevojën për të përforcuar kapacitetet e menaxhimit dhe zbatimit të të dhënave, për të forcuar luftën efektive kundër korrupsionit dhe informalitetit dhe hartimin e masave kundër krizës që synojnë fuqimisht nevojat e më të rrezikuara në kontekstin e mjeteve të pamjaftueshme financiare. Pavarësisht sfidave aktuale, vendi duhet të vazhdojë me angazhimin për investime strategjike në kapitalin njerëzor, sigurinë ushqimore, ndryshimet klimatike, mjedisin jetësor dhe rezistencën ndaj fatkeqësive.

Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK)



2022 Rritja e PBB-së



Source: SSO, 2023

Mbështetja e OKB-së për prioritetet e zhvillimit kombëtar nëpërmjet Kornizës për bashkëpunim

Kjo pjesë thekson kontributin dhe rezultatet e OKB-së për Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 dhe rezultatet nga puna me partnerët në katër fusha – duke përfshirë prosperitetin gjithëpërfshirës, shërbimet cilësore për të gjithë, mjedisin jetësor të shëndetshëm dhe qeverisjen e mirë.

Pasqyra e përgjithshme e KBZhQ-së


Duke u mbështetur në traditën e fortë të punës së OKB-së në Maqedoninë e Veriut, KBZhQ-ja mbështet zhvendosjen nga zbatimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve drejt një mbështetjeje më të synuar të OKB-së, si organizatë që mundëson dhe ofron këshilla paraprake të politikave, inovacionit dhe ekspertizës.

Veprimi i OKB-së bazohet në dëshmi, gjë që kërkon kapacitete të përforcuara statistikore, mbledhje më të mirë të të dhënave të ndara dhe përmirësim të koordinimit dhe ndarjes së informacionit në të gjitha nivelet. Të gjitha aktivitetet kryhen së bashku me autoritetet kombëtare dhe lokale, shoqërinë civile, sektorin privat, partnerët ndërkombëtarë dhe palët tjera.

Programet e promovojnë barazinë gjinore, angazhimin qytetar të të rinjve, ndërtimin e besimit dhe mundësitë e barabarta për të gjithë, për t'i realizuar të drejtat e tyre njerëzore dhe potencialin e plotë. Duke pranuar se njerëzit nuk janë pranues pasiv të shërbimeve, por agjentë të ndryshimit, ndërhyrjet e OKB-së

e mbështesin transformimin shoqëror për një qasje më aktive dhe më të përgjegjshme individuale dhe të komunitetit ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Per vlerat e detajuara për të gjithë treguesit e rezultateve shih Aneksin 3; për rezultatet e arritura sipas rezultatit përfundimtar dhe sipas agjencisë së OKB-së, shih Shtojcën e raportit.



2022 rezultati

REZULTATI 1

Prosperiteti gjithëpërfshirës



Deri në vitin 2025, standardi jetësor i të gjithë njerëzve në Maqedoninë e Veriut është përmirësuar përmes qasjes së barabartë në punë të denjë dhe punësimit produktiv të gjeneruar nga një ekosistem biznesi gjithëpërfshirës dhe inovativ

Kontributi në OZHQ



Harmonizimi me prioritetet strategjike të qeverisë (2022-2024) Harmonizimi me kapitujt e BE-së



- Rritje e përshpejtuar dhe e qëndrueshme ekonomike me një standard më të mirë të jetesës
- Zhvillimi i bujqësisë
- Turizmi i qëndrueshëm
- Decentralizimi dhe zhvillimi i barabartë rajonal



- Themelet në rend të parë: Zhvillimi Ekonomik dhe Konkurrueshmëria
- 11. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
- 19. Politikat Sociale dhe të Punësimit;
- 20. Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale;
- 26. Arsimi dhe Kultura

Shpenzimet në vitin 2022

\$5,311,561

Partnerët e zhvillimit:

• Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave; Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Agjencia e Punësimit; Zyrat Rajonale të Punësimit; Sindikatat; Dhomat e tregtisë; Këshillat lokalë ekonomik dhe social; Punëdhënësit; Shoqatat e fermerëve, Organizatat e prodhuesve

Në vitin 2018, garancia për të rinjtë filloi të aplikohet në Maqedoninë e Veriut, në kuadër të praktikës nga vendet e BE-së. Të dhënat më të fundit nga tregu i punës tregojnë se garancia ka ndihmuar në përmirësimin e situatës tek të rinjtë në periudhën 2018 - 2019. Në vitin 2020 është vërejtur një regres i vogël për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19 dhe në vitin 2021, një përmirësim u vu re përsëri. Në vitin 2022, 7,419 (3,595 gra), nga 20,185 persona të regjistruar në Garanci për Rininë janë punësuar brenda 4 muajve. Përqindja e pjesëmarrësve që kaluan me sukses programin në vitin 2020 është 43%. Foto: MOT

Pavarësisht sfidave të paraqitura nga krizat e njëpasnjëshme, disa nga treguesit kryesorë për këtë rezultat treguan një përmirësim solid në vitin 2022. Shkalla e punësimit vazhdoi të rritet, duke iu afruar objektivit të vitit 2025 dhe me rritje prej 2,5% që nga viti i kaluar. Numri i të rinjve që nuk janë të përfshirë në arsim është ulur ndjeshëm (22,8%) që nga viti i kaluar (24,26%), pothuajse duke arritur objektivin e vendosur për vitin 2025. Rritja për person të punësuar po ashtu ka shënuar rritje, ndërkohë që shkalla e varfërisë se të punësuarit vazhdon të rritet

(Shih Aneksin 3 për vlerat e detajuara të të gjithë treguesve).

Duke punuar me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencinë e Punësimit dhe partnerë të tjerë përkatës, OKB-ja ka kontribuar në masë të konsiderueshme për këto zhvillime pozitive. Në vitin 2022, OKB-ja mbështeti krijimin e **1.204 vendeve të punës** përmes masave të ndryshme, si këshillimi dhe mentorimi i **671 bizneseve** dhe ndërhyrje të tjera si masat e gjelbra, puna praktike dhe Programi i Punës në Komunitet në 52 nga gjithsej 81 komuna. Nga këto vende pune, të paktën 359 janë plotësuar nga romët, 36 nga personat me aftësi të kufizuara (23 persona të vetëpunësuar) dhe 34 janë krijuar me investime të gjelbra. Përveç kësaj, duke mbështetur ekonominë ende të pazhvilluar, por të domosdoshme të kujdesit, OKB-ja mundësoi licencimin e 117 ofruesve të shërbimeve të kujdesit për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe aftësoi 28 OJQ për të ndihmuar këto grupe.

5,351

persona që u janë rritur mundësitë për punësim

Duke iu përgjigjur nevojës kritike për aftësitë që i kërkon tregu dhe duke u fokusuar në grupet e cenushme, OKB-ja mbështeti rritjen e shkallës së punësimit dhe aktivizimin e **5.351 personave**, 54% e të cilëve janë gra dhe pothuajse 70% të rinj, 2.379 janë romë dhe 152 persona me aftësi të kufizuara. Për më tepër, **147 persona të aftësuar përmes trajnimit për aftësitë e së ardhmes** në fushën e transformimit digjital dhe tranzicionit të gjelbër në: ndërtim, energji të ripërtërishme, energji dhe tekstil. Duke adresuar sfidën më serioze të zvogëlimit të kapitalit njerëzor në vend, OKB-ja ndihmoi institucionet për të zbatuar planet e **Garancisë për të rinjtë** që rezultoi në regjistrimin e **20.185 të rinjve që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim ose trajnim (NAPT)** përmes rrjetit të ofruesve të shërbimeve të udhëhequr nga Agjencia e Punësimit, nga të cilat 7.419 (3.595 gra) janë punësuar brenda 4 muajve nga regjistrimi. Prej tyre, 2.400 të rinj NAPT (1.553 gra, 193 romë dhe 6 persona me aftësi të kufizuara) u regjistruan me ndihmën e OJQ-ve, duke rritur shërbimet sociale në kuadër të komunitetit. Kjo kontribuoi në një ulje të ndjeshme të normës së të rinjve NAPT në vitin 2022 (22,8%) duke u ulur për pothuajse 2% që nga viti i kaluar (24,26%), pothuajse duke arritur synimin e vendosur për vitin 2025.

Gjatë gjithë vitit, OKB-ja punoi me autoritetet për të përmirësuar politikat dhe mjedisin rregullator dhe shërbimet për zhvillim gjithëpërfshirës, duke përfshirë qasjen pjesëmarrëse dhe të bazuar në dëshmi.

Në fushën e tregut të punës, OKB-ja e lehtësoi dialogun social trepalësh për hartimin e **Ligjit të ri për Marrëdhëniet e Punës** dhe e mbështeti zhvillimin e "Ligjit të ri për Punësimin dhe

Ljupčo Nikolovski

MBPEU

"Përballë sfidave të përkeqësuar nga pandemia e fundit me COVID-19 dhe lufta në Ukrainë për sigurinë e ushqimit vendor, Ministria dhe qeveria e njohën rëndësinë për të pasur një Strategji Kombëtare për Sigurinë Ushqimore dhe Ushqyerjen si një udhërrëfyes afatgjatë i prioriteteteve kombëtare, veprimeve dhe burimeve të nevojshme për të promovuar prodhimin bujqësor të vendit, për të rritur disponueshmërinë e ushqimit dhe për të përmirësuar përbalimin e dietave të shëndetshme për të gjithë njerëzit në Maqedoninë e Veriut, si dhe për t'i bërë sistemet ushqimore të qëndrueshme dhe rezistente ndaj krizave të ardhshme, të cilat mund të ndikojnë në sigurinë kombëtare të ushqimit." *Credit: Government MK*

Sigurimin në rast të Papunësisë" për t'i mundësuar Agjencisë së punësimit (AP) t'i zbatojë tendencat e fundit në aktivizimin grupeve të cenushme në tregun e punës, me instrumente për zbatimin e modelit të kontraktimit social. Analiza e udhëhequr nga OKB-ja e harmonizimit ligjor me **Konventën e ILO-s për përfundimin e dhunës dhe ngacimit ndaj grave dhe burrave në botën e punës, Nr. 190** u vërtetua nga Këshilli Ekonomik dhe Social dhe u fut në proces parlamentar.

Për të nxitur ekonominë rurale, OKB-ja mbështeti amendamentet e **Ligjit për Shitjen e Tokës Bujqësore në Pronësi Shtetërore** duke e bërë plotësisht funksional privatizimin e tokës bujqësore në pronësi shtetërore. Në përgjigje të sfidave në mjedisin global, u iniciuan veprime përgatitore për zhvillimin e **Strategjisë së parë Kombëtare për Sigurinë Ushqimore** përmes një procesi konsultativ dhe pjesëmarrës, me dëshmi analitike dhe propozim për mekanizmin e koordinimit kombëtar ndërinstitucional. Duke njohur sfidën e migrimit, OKB-ja ndihmoi institucionet për **përfshirjen e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik të vendit**, duke ngritur kapacitetet e më shumë se 20 aktorëve institucionale me kompetenca në çështjet e lidhura me diasporën, duke përfshirë projektet e përfshirjes së diasporës.

Ekonomia e gjelbër u përforcua duke futur **masat e tranzicionit të gjelbër për kompanitë në Planin Operativ Qeveritar të vitit 2022** me vlerë prej 333.000 dollarë. Shërbimet për krijimin e aftësive u përmirësuan me prezantimin e **konceptit për përmirësimin e aftësive profesionale për të rriturit** në Qendrat rajonale gjithëpërfshirëse të përsosshmërisë. Me mbështetjen e OKB-së, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës kreu Vlerësimin kombëtar të aftësive digjitale për të kuptuar ofertën dhe kërkesën aktuale të aftësive digjitale të të punësuarve në sektorin privat, bizneset fillestare (start-up-et) dhe sektorin e arsimit dhe në bashkëpunim e zhvilloi **Profilin e Inovacionit Digjital**. Rekomandimet e të dyjave kontribuan në hartimin e Strategjisë Kombëtare të TIK-ut 2023-2027.

3,102 hektarë

në proces të konsolidimit

Përveç kësaj, digjitalizimi u përmirësua edhe përmes disa produkteve specifike si p.sh. **mjeti digjital HANA**, i cili ofron qasje në të dhënat e shkruara në gjuhën shqipe për personat me shikim të dëmtuar, si dhe **Mjeti për Monitorimin dhe Analizën e Çmimeve të Ushqimit (MAÇU)** i vendosur në internet. I përshtatur dhe i lidhur me sistemet kombëtare të mbledhjes së të dhënave, MAÇU u lëshua në përdorim nga MBPEU-ja me mbështetjen e OKB-së në vitin 2022, për të mundësuar monitorimin dhe analizën e lehtë të çmimeve të ushqimeve vendore dhe globale, që është me rëndësi thelbësore në adresimin e sigurisë ushqimore (sigurimit të ushqimit) në kontekst krize.

Paralelisht, OKB-ja punoi gjithashtu në masa specifike për të adresuar informalitetet dhe cilësinë e vendeve të punës. Në këtë kontekst, u përmirësua rregullativa e tregut të punës duke i ngritur kapacitetet e Inspektoratit të Punës. Kjo përfshin **trajnimin e 106 inspektorëve** për Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, duke zhvilluar një platformë për **e-mësim dhe një faqe të re të internetit** me aplikacione digjitale për punëdhënësit dhe punëtorët, si dhe duke ofruar **pajisje të re matëse dhe të TI-së**. Për të adresuar informalitetet në sektorin HORECA (hotelet, restorantet dhe kafenetë), u zbatua një masë pilot me Shoqatën e Hoteleve, Restoranteve, Kafeneve dhe Kampeve – HOTAM, **me procedura të thjeshtuara të punësimit dhe me kontribute dhe sigurime sociale të ulura për punëtorët sezonalë në Ohër dhe Strugë**. Për të përmirësuar sigurinë dhe shëndetin e vendeve të punës në ndërtim, miniera dhe bujqësi, OKB-ja bëri një analizë të mangësive të harmonizimit të rregulloreve me konventat e ILO-s, e cila u vërtetua nga institucionet.

OKB-ja iu përgjigj gjithashtu sfidave më kritike për një ekonomi

Mirjana Kapkoska-Angeleska

ËSHTË NJË GRUA FERMERE NGA FSHATI
DABJAN (KOMUNA E DOLLNENIT)

Ajo ka trashëguar pronë nga gjyshi i saj, pas denacionalizimit të tokës bujqësore. Por ajo vështirë se mund ta kultivonte tokën e saj, pasi ajo përbëhej nga 65 parcela të shpërndara nëpër vende të ndryshme në fushë. Falë përpjekjeve të përbashkëta të BE-së, FAO-s dhe MBPEU-së, të gjitha parcelat e saj tani janë konsoliduar në një - tetë hektarë parcelë e madhe dhe me formë të rregullt. "Tani, më në fund, e ktheva tokën time për ta përdorur për prodhimtari bujqësore" - thotë Mirjana. Foto: FAO

rurale të qëndrueshme dhe konkurruese, si p.sh. copëtimi i tokës, infrastruktura e pamjaftueshme rurale dhe menaxhimi i shëndetit të kafshëve, si dhe hendeku i theksuar gjinor në sektorin bujqësor. Në vitin 2022, me mbështetjen e BE-së, OKB-ja vazhdoi asistencën për zbatimin e Programit Kombëtar të Konsolidimit të Tokës nëpërmjet zbatimit të njëkohshëm në terren të dhjetë projekteve të konsolidimit të tokës. Ky proces përfshinte miratimin e planeve për konsolidimin e tokës dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore duke mbuluar 3.102 hektarë tokë bujqësore, në pronësi të 2.954 pronarëve të tokave bujqësore (633 gra). Si rezultat i kësaj, numri i parcelave të tokës në këto zona është reduktuar tashmë për pothuajse 2,5 herë, respektivisht nga 8.237 në 3.344 parcela, ndërsa madhësia mesatare e parcelave është trefishuar (nga 0,42 hektar në 1,34 hektar) në zonat ku u përfundua konsolidimi i tokës, kështu që u adresua problemi strukturor i fermave të vogla dhe parcelave të copëtuara të tokës, që e zhbllkoi potencialin e

prodhimtari bujqësor dhe e përmirësoi konkurrencën e fermave. Këtë vit, në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, 70 gra fermerë përfituan nga rritja e mbështetjes financiare (nga 3.000 euro në 6.000 euro) përmes masës së mundësuar nga OKB-ja që synon mbështetjen e grave prodhuese të produkteve bujqësore. Për të ndihmuar në harmonizimin e menaxhimit të shëndetit të kafshëve me standardet e BE-së, OKB-ja bëri një vlerësim përgatitor për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë për të përmirësuar Sistemin Kombëtar të Informacionit për Kafshët.

70 fermerë

të mbështetura financiarisht



Ndërhyrjet e OKB-së mundësuan krijimin e 1204 vendeve të punës me kohë të plotë dhe të pjesshme (622 me kohë të plotë, 582 me kohë të pjesshme) përmes masave të ndryshme, duke përfshirë masat e reja të gjelbra të prezantuara në vitin 2022. Nga këto, 68.5% janë gra, 30.5% janë persona të rinj deri në 29 vjeç, 34.7% janë romë dhe 42 vende pune (3.5%) janë për personat me aftësi të kufizuara. Foto: UNDP

REZULTATI 2

Shërbime cilësore për të gjithë



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut kanë qasje universale në shërbime sociale cilësore të bazuara në të drejta – qasje në kujdes shëndetësor, arsim dhe mbrojtjen e nevojshme sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve - të rrënjësura në sisteme rezistente ndaj situatave emergjente

Kontributi në QZHQ



Prioritetet strategjike të qeverisë

- Gjithëpërfshirja sociale (kujdes për të gjitha kategoritë e rrezikuara) dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor
- Sistem modern arsimor
- Sistem shëndetësor i qëndrueshëm dhe modern
- Rinia në fokus
- Një shoqëri për të gjithë

Kontributi në procesin e anëtarësimit në BE




- Grupi 2, Kapitulli 28: Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit
- Grupi 3, Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe të Punësimit; Kapitulli 25: Shkenca dhe hulumtimi, Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura

Shpenzimet në vitin 2022

\$5,128,417

Partnerët e zhvillimit:

- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Institutet shoqat apo drejtoritë shëndetësore; Institutet për trajnim profesional; Sindikata e Punëtorëve Shëndetësorë; Shoqëria civile; Komunitetit akademik, Sektori privat



Branka Todevska, infermiere, merr vaksinën e gripit sezonal. "Unë vakcinohem çdo vit për të mbrojtur veten dhe i bëj thirrje të gjithë të tjerëve që të vakcinohen për të mirën e tyre", thotë Branka. Foto: OBSH

Të dhënat më të fundit të disponueshme tregojnë se ka një rritje të lehtë të popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë (nga 21,6% në vitin 2019 në 21,8% në vitin 2020), edhe atë më së shumti të më të rinjtë (nga 27,8% në vitin 2019 në 30,3% në vitin 2020). Ky numër shënoi rritje të mëtejshme me krizën e fundit që ndikoi në mënyrë disproporcionale në kategoritë e cenueshme dhe futi më shumë njerëz në varfëri, ose 13.000 persona të tjerë, nga të cilët 5.000 fëmijë, sipas vlerësimit të analizës së mbështetur nga OKB-ja për ndikimin e krizës në familjet e Maqedonisë së Veriut. Kjo, gjithashtu shkaktoi një rënie të lehtë të indeksit të zhvillimit njerëzor, i cili u ul nga 0,774 në vitin 2021 në 0,770 në vitin 2022. Megjithatë, renditja e vendit u përmirësua nga vendi 82 në vendin e 78.

Duke përdorur KOVID-19 si një moment shtytës, mbështetja dhe ndihma teknike e OKB-së për Ministrinë e Shëndetësisë jo vetëm që e lehtësuan përgjigjen ndaj nevojave të sistemit

shëndetësor emergjent, por gjithashtu mundësuan përforcimin e sistemit kombëtar shëndetësor. Kjo u arrit, ndër të tjera, përmes gjenerimit të dëshmimeve me rëndësi kritike për hartimin më të mirë të politikave dhe përmirësimit të dizajnit të shërbimeve me fokus në pacientin.

Vlerësimi i kontekstit ligjor kombëtar identifikoi ndryshimet e nevojshme në kornizën ligjore dhe rregullatore kombëtare për të mundësuar zbatimin e reformës së kujdesit shëndetësor parësor (KSHP). Analiza e situatës së Ndërhyrjes së Hershme në Fëmijëri (NHF) jo vetëm që ofroi të dhënat më të reja rreth sistemit, por mundësoi të zbulohet një hendek i ri për sa i përket barazisë në qasjen në shërbimet e ndërhyrjes së hershme, duke dëshmuar një pabarazi të qartë sipas të ardhurave në qasjen në shërbimet e NHF-së. Protokollet dhe rrugët klinike për sëmundjet prioritare jo të transmetueshme, do të kontribuojnë në prezantimin e standardit minimal të

cilësisë për ofrimin e kujdesit në praktikën e përditshme. Analiza sistematike e proceseve administrative për mjekët e kujdesit parësor shëndetësor identifikoi **tepricat dhe mundësitë konkrete për të rritur efikasitetin** e administrimit të KSHP-së. Planifikimi dhe dizajnimi i një sistemi për caktimin elektronik të termineve për kujdesin parësor shëndetësor do t'u mundësojë pacientëve **të shmangin pritjet e gjata në qendrën e tyre shëndetësore**, pa imponuar një ngarkesë plotësuese administrative për KSHP-në. Softueri digjital që është zhvilluar dhe që është duke u pilotuar, do të mundësojë konsultim më të lehtë midis profesionistëve shëndetësorë në nivelin parësor, dytësor dhe terciar, duke i kursyer kështu pacientët nga shpenzimet financiare për shkak të udhëtimeve të panevojshme dhe duke i shmangur turmat në dhomat e pritjes nëpër spitale. Rezultatet e sipërpërmendura kontribuojnë në arritjen e synimeve të QZHQ-së 3.8 (Arritja e mbulimit universal shëndetësor) dhe 3.4 (Ulja e vdekshmërisë së parakohshme nga sëmundjet jo të transmetueshme), si dhe të treguesit të rezultateve të ZhQKB mbi nevojën e paplotësuar të vetë-raportuar për kontroll dhe kujdes mjekësor, i cili në vitin 2020 ishte 1,7%, e që pritet të përmirësohet përsëri në vitin 2022 pas COVID-19.

Vlerësimi i parë gjithëpërfshirës i strukturës për planifikim dhe procese **të fuqisë punëtore shëndetësore**, i hodhi themelet drejtë zhvillimit të një **Strategjie të re (të parë) për Fuqinë Punëtore në Shëndetësi (SFPSH)**. Me mbështetjen e OKB-së, Ministria e Shëndetësisë, Fakulteti i Mjekësisë dhe Spitali i Specializuar për Kujdesin Geriatrik dhe Paliativ hartuan një plan veprimi për transformimin e Spitalit të Specializuar për Kujdesin Geriatrik dhe Paliativ në një qendër mësimore për **sub-specializimin e ri geriatrik** dhe kanë zhvilluar një udhërrëfyes për zhvillimin e fuqisë punëtore. Kjo do të ndihmojë në përgatitjen e fuqisë punëtore të shëndetësisë për t'iu përgjigjur nevojave të popullsisë së moshuar në rritje, në përputhje me synimin 3.c të OZHQ-së (rritja e financimit në shëndetësi për mbajtjen e fuqisë punëtore në vendet në zhvillim). **Mbi 1.800 profesionistë shëndetësorë** (6,5% e numrit të përgjithshëm të fuqisë punëtore të kujdesit shëndetësor) ndoqën një sërë trajnimesh (secili në fushën e ekspertizës së tij) për dhënien e vaksinave, planifikimin e vaksinimit dhe bisedën për pranimin më të lehtë të vaksinimit të nevojshëm, sigurinë në punë, punën në shëndetin mendor, punën laboratorike, epidemiologjinë në terren, telemjekësinë, kujdesin perinatal efektiv dhe në fusha të tjera.

Svetllana Miliq

NJË AMVISE 65-VJEÇARE NGA NJË KOMUNË NË MAQEDONINË E VERIUT KISHTE KRYER NJË KONTROLL RUTINË NË NJË KLINIKË TË LËVIZSHME GJINEKOLOGJIKE QË IA NDRYSHOI JETËN. AJO U DIAGNOSTIKUA ME KANCER NË QAFËN E MITRËS NË NJË FAZË TË HERSHME DHE IU NËNSHTRUA NJË OPERACIONI PËR TË PARANDALUAR PËRHAPJEN E KANCERIT. PAVARËSISHT SE MAQEDONIA E VERIUT KA MË SHUMË GJINEKOLOGË PËR 100.000 BANORË SESA MESATARJA EVROPIANE, SHUMË QYTETE DHE FSHATRA MË TË VOGLA NUK KANË SHËRBIME SHËNDETËSORE SEKSUALE DHE RIPRODHUESE LEHTËSISHT TË QASSHME, GJË QË ËSHTË NJË PENGESË E RËNDËSISHME PËR NJERËZIT E CENUESHËM DHE NJERËZIT QË JETOJNË NË ZONAT RURALE. Foto: UNFPA

Svetllana së bashku me 2.000 gra dhe vajza nga zonat rurale dhe nga zonat me shërbime të pamjaftueshme të vendit patën mundësinë të kryenin kontroll të rregullt gjinekologjik në vendbanimin e tyre, nëpërmjet shërbimeve të klinikave

të lëvizshme gjinekologjike, të krijuara me mbështetjen e OKB-së në vitin 2021 dhe të integruara më pas në sistemin shëndetësor kombëtar. Në bashkëpunim me organizatën lokale të shoqërisë civile HOPS, këto shërbime janë shtrirë edhe për gratë dhe vajzat në burgje, punëtorët e seksit dhe përdoruesit e drogës.

Me mbështetjen e OKB-së dhe në bashkëpunim me Komitetin e Amësisë së Sigurt, Ministria e Shëndetësisë krijoi gjashtë këshilla ekzekutive operative për **zbatimin e modelit të kujdesit perinatal**, në gjashtë rajonet e Shkupit, Manastirit, Tetovës, Shtipit, Strumicës dhe Kumanovës. Këshillat do të kontribuojnë në koordinimin më të mirë të zbatimit të Planit Kryesor për Kujdesin Perinatal 2020-2030 në nivel rajonal. Duke u bazuar në aktivitetet e viteve të mëparshme, 175 profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor u trajnuan në 10 objekte/spitale për kujdesin efektiv perinatal (KEP), duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe **përmirësimin e shëndetit të nënës dhe të porsalindurve**. Ndërsa shkalla e vdekshmërisë neonatale u rrit gjatë pandemisë (nga 4,2 në 4,5%), këto investime të vazhdueshme, po ashtu edhe me mbështetjen e OKB-së, pritet të kthejnë trendin në shkallë më të ulët nga periudha para pandemisë.

340 FËMIJË

u pajisën me aftësi të përmirësuara

Në vitin 2022, OKB-ja punoi me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet shoqëruese për zbatimin e vazhdueshëm të reformës në **arsim** për të adresuar krizën e të mësuarit të shkaktuar nga boshllëqet sistematike, të përkeqësuar nga pandemia e COVID-19. Megjithëse shkollat mbetën kryesisht të hapura gjatë gjithë vitit 2022, rimëkëmbja nga humbjet e të mësuarit të lidhura me pandeminë ishte e ngadaltë dhe kontribuoi për rezultate më të ulëta arsimore, me ç'rast fëmijët më të cenueshmëm u prekën në mënyrë disproporcionale.

Në vigjilje të **Samitit të Transformimit të Arsimit (STA)** të organizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, me mbështetjen e OKB-së u organizuan një seri prej 10 konsultimesh kombëtare për të ardhmen e arsimit me mbi 600 të rinj, studentë, mësime dhënë, zyrtarë komunalë, deputetë dhe OShC. Në bazë të të dhënave nga konsultimet, në **Samitin e mbajtur në shtator në Nju Jork, kryeministri bëri në deklaratë për angazhimin kombëtar** për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit arsimor dhe avancimin e arritjeve të OZHQ 5.

Megjithëse shkollat mbetën kryesisht të hapura gjatë gjithë vitit 2022, rimëkëmbja nga humbjet e të mësuarit të lidhura me pandeminë ishte e ngadaltë dhe kontribuoi për rezultate më të ulëta arsimore, me ç'rast fëmijët më të cenueshmëm u prekën në mënyrë disproporcionale. Pjesëmarrja në arsimin parashkollor është ende e ulët, me ç'rast shumica (60%) e fëmijëve të moshës 3-5-vjeçare nuk e ndjekin **arsimin parashkollor cilësor dhe gjithëpërfshirës** (Treguesi i KBZhQ 2_10), megjithëse ka pasur rritje pas COVID-it. Për t'iu përgjigjur kësaj shtate, OKB-ja investoi në avokimin për **qasje të zgjeruar në arsimin parashkollor** krahas një procesi më të gjerë për të **optimizuar të gjithë rrjetin e shkollave** dhe për të **shfrytëzuar më mirë burimet në dispozicion**. OKB-ja ka bashkëpunuar drejtpërdrejtë me 10 komunat e para për të planifikuar optimizimin e burimeve dhe për t'i shfrytëzuar hapësirat e papërdorura në shkolla për të rritur mbulimin me arsim parashkollor, duke i pritur rezultatet e para në vitin 2023.

OKB-ja vazhdoi të mbështesë reformën e plan-programeve mësimore duke u ofruar mësime dhënë strategji efektive pedagogjike, burime dhe mjete arsimore (duke përfshirë edhe



U bashkuan mësues dhe punonjës të arsimit në punëtoritë për ngritjen e kapaciteteve të OKB-së për ndryshimin e klimës përmes eksperimenteve të reja me kosto efektive brenda klasave të tyre. Kjo qasje i ndihmon fëmijët të mësojnë bazat e shkencës dhe fenomeneve të ndryshimeve klimatike, të tilla si degradimi i ujit, ciklet e tokës dhe ngrohjes. Këto aktivitete eksperimentale në shkollë ndihmojnë gjithashtu fëmijët të zhvillojnë aftësitë e zgjidhjes së problemeve, këmbënguljen dhe bashkëpunimin. Foto: UNICEF

ato digjitale) për mësimdhënie gjithëpërfshirëse cilësore. Vëmendje e veçantë në mbështetjen e këtij viti iu kushtua mirëqenies së studentëve, si një faktor i rëndësishëm në përmirësimin e rezultateve të nxënësve, veçanërisht të atyre që vijnë nga grupet e cenueshme. **Përmbytjet e reja mësimore** u hartuan në vazhdimësi dhe janë vënë në dispozicion pa pagesë në **Eduino**, duke përfshirë burime mësimore, lojëra, aktivitete dhe një laborator virtual me eksperimente shkencore që mund të ndiqen sipas ritmit personal, duke e forcuar më tej Eduino-n si platformë kryesore në internet me materiale mësimore të verifikuara dhe me cilësi të mirë për mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit.

10,970 mësimdhënës

morën pjesë në programet e OKB-së për zhvillim profesional

Për të mbështetur përfshirjen e të gjithë fëmijëve në arsimin e rregullt dhe për të krijuar një mjedis që do të ofrojë kujdes dhe stimulim për fëmijët me aftësi të kufizuara për të mësuar dhe zhvilluar aftësitë që u nevojiten për të përparuar, OKB-ja mbështeti zgjerimin e përfshirjes së hershme në programet arsimore, transformimin e shkollave speciale në qendra burimore, ngritjen e kapaciteteve të personelit në qendrat burimore, edhe atë të 1.364 anëtarëve të **ekipeve shkollore për gjithëpërfshirje të të gjitha shkollave fillore** në vend, si dhe të 400 profesionistëve në të gjithë vendin në lidhje me Komunikimin augmentativ dhe alternativ. Si rezultat i kësaj, në vitin shkollor 2021/2022 u regjistruan 1.232 nxënës me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta fillore (911) dhe të

mesme (312). Futja e programit kombëtar për të mësuarit social dhe emocional u realizua përmes një rrjeti prej 192 mësimdhënësish për mbështetje profesionale dhe u plotësua nga një program trajnimi dy-mujor për komunitetet e qëndrueshme profesionale të të mësuarit për të promovuar një kulturë të të mësuarit të vazhdueshëm për të gjithë personelin dhe për të përmirësuar rezultatet e të nxënësve për të gjithë fëmijët.

OKB-ja vazhdoi mbështetjen për edukimin gjithëpërfshirës seksual (EGJS) dhe iniciativat e lidhura me të rinjtë duke punuar me Byronë për Zhvillimin e Arsimit në planifikimin dhe zhvillimin e procesit të pozicionimit strategjik dhe zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për EGJS. Strategjia synon të përmirësojë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nxënësve për EGJS-në dhe të rrisë vetëdijen për nevojën për EGJS në arsimin fillor.

Të gjitha këto aktivitete synojnë të përmirësojnë cilësinë e arsimit dhe rezultatet e të nxënësve, progresi i të cilave do të matet përmes treguesit KBZhQ 2_20 për rezultatet e testimit PISA nga rrethi i testimit për vitin 2022, i cili pritet të kryhet së shpejti.

OKB-ja bashkëpunoi me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe me institucione të tjera përkatëse për të mbështetur **politikën për mbrojtjen sociale, si dhe dizajnimin**



Më mbështetje nga OKB-ja, programi i mentorimit social, për gratë që kanë përjetuar dhunë, u ka ndihmuar pjesëmarrëseve të bëhen të qëndrueshme financiarisht dhe psikologjikisht. Magdalena Çadinowska Kuzmanoski, mentore sociale që ka punuar me pesë gra, shpjegon se si mentorimi social çon në punësim, siguri financiare dhe përmirësim të cilësisë së jetës për ata/ato që kanë përjetuar dhunë dhe vartësit e tyre. Zhvillimi i aftësive të buta dhe trajnimi profesional i ndihmon gratë të bëhen më konkurruese në tregun e punës, ndërsa mentorët social sugjerojnë mundësi potenciale për punësim vetëm kur janë të sigurt se ajo grua mund t'i përballojë kërkesat e vendit të punës. *Foto: UN Women*

dhe pilotimin e shërbimeve për të përmirësuar mbrojtjen e personave në nevojë.

50,000 amvisëri

do të marrin shërbime më të mira sociale nëpërmjet menaxhimit të integruar të rasteve

Në vitin 2022, mbështetja e OKB-së u fokusua në zhvillimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore të shërbimit social. Platforma e re e të mësuarit digjital për fuqinë punëtore të shërbimit social ofron ndjekjen e trajnimeve të specializuara online, të nevojshme për proceset e licencimit, si dhe trajnim për adresimin e lodhjes së mundshme të tepërt në punë, e cila deri më tani u shfrytëzua nga më shumë se 100 punëtorë të sektorit social që punojnë drejtpërdrejt me shfrytëzuesit. Paralelisht, OKB-ja ndërtoi kapacitete, mjete dhe metoda për menaxhimin e integruar të rasteve të popullsisë së cenushme, si pikë e vetme hyrëse për shërbimet mbështetëse dhe përfitimet, e cila pritet t'u shërbejë mbi 50.000 amvisërive duke filluar nga viti 2023.

Strategjia e parë ndërsektoriale e Prindërimit u zhvillua me

synimin për të siguruar një mjedis familjar që kujdeset për fëmijët në shtëpi. Si pjesë e **ndërhyrjeve prindërore**, qindra fëmijë përfituan nga aftësitë e përmirësuar të prindërimit përmes Programit të Prindërimit Përkëdhelës (100 familje), Linjës së ndihmës për prindërit (100 prindër) dhe aplikacionit të prindërimit "Bebbo" (mbi 7.000 përdorues) - të gjitha këto duke mundësuar qasje të lehtë dhe me shpenzime të ulëta në ndërhyrjen e hershme dhe mbështetjen për prindërit.

Në bazë të standardeve të reja për kujdestarinë dhe kujdesin e fëmijëve sipas lidhjes farefisnore, Qendrat rajonale për Mbështetje të Familjeve Kujdestare, që u krijuan rishtazi, fituan njohuri dhe zhvilluan aftësi për të promovuar shërbimin e mbështetjes për familjet kujdestare, për të vlerësuar dhe edukuar familjet potenciale dhe të ardhshme kujdestare, si dhe për të vëzhguar dhe mbështetur familjet ekzistuese kujdestare dhe ato që kujdesen për fëmijët sipas lidhjes farefisnore. Procesi i identifikimit dhe i kërkesave për familjet e reja kujdestare dhe qasja në informacione për popullsinë e përgjithshme, profesionistët dhe familjet aktuale kujdestare është lehtësuar përmes faqes së internetit për kujdestari <https://zgrizuvanje.gov.mk/>.

Janë zhvilluar kapacitetet kombëtare për zgjerimin e modelit të bazuar në të drejtat e njeriut të aftësisë së kufizuar dhe të vlerësimit të nevojave të fëmijëve dhe të rinjve në Rajonin Planifikues Verilindor, Lindor, të Vardarit dhe Jugperëndimor. Pas miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Mbrojtje Shëndetësore nga Parlamenti, të cilat u përgatitën me mbështetjen e OKB-së, me krijimin e inicuar të organit kombëtar dhe dhjetë organeve funksionale rajonale për vlerësim do të përfundojë futjen e modelit të ri, i cili nga viti 2023 do të sigurojë një pikë të lehtë dhe të vetme për shërbimet mbështetëse dhe përfitimet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në të gjithë vendin.

Në mbështetje të Qeverisë për të siguruar që askush të mos

lihet pas, OKB-ja siguroi dhe lehtësoi ofrimin e shërbimeve të shëndetit, arsimit dhe mbrojtjes së fëmijëve për emigrantët dhe personat e zhvendosur me forcë, duke përfshirë familjet afgane që ishin përkohësisht në vend. Rreth 26.000 emigrantë, refugjatë dhe azilkërkues të akomoduar në Qendrat e përkohshme të tranzitit në Vinojug dhe Vizbeg, morën mbështetje mjekësore dhe psiko-sociale, ndërmjetësim kulturor, aktivitete rekreative, ndihmë gjuhësore dhe nevoja të tjera të pritjes dhe mbrojtjes. 40 azilkërkues me nevoja specifike, të akomoduar në Qendrën pranuese në Vizbeg dhe në akomodim privat, u ndihmuan me arsimim dhe shërbime punësimi, si dhe me ndërhyrje mjekësore dhe mbështetje psiko-sociale. Së fundi, lidhur me zotimin e Fondit të Paktit Global për Refugjatët e mbetur nga Kosova, 5 persona fituan shtetësinë dhe 6 u kthyen vullnetarisht në Kosovë. 244 persona nga numri fillestar i refugjatëve të Kosovës janë ende në vend dhe situata e tyre pritet të zgjidhet deri në vitin 2024.


Në vitin e kaluar është shënuar progres i mirë në zbatimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna kundër Grave dhe Dhuna në Familje. Me mbështetjen teknike të OKB-së u përgatitën dokumentet kryesore, siç janë Protokollin

multisektorial (Protokollin MSR), gjashtë akte nënligjore, Programi për Riintegrimin e Viktimave. Këto dokumente ligjore përcaktojnë dispozita të reja, e lehtësojnë reagimin e shumë palëve dhe standardet dhe procedurat kryesore në mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe ofrojnë shërbime cilësore të përmirësuara për viktimat e dhunës. Mbledhja dhe analiza e të dhënave është thelbësore për hartimin e politikave të bazuara në dëshmi. Duke synuar mungesën kronike të të dhënave cilësore dhe të besueshme për dhunën ndaj grave (DhG) dhe dhunën në familje, OKB-ja mbështeti gjithashtu hartëzimin e situatës aktuale dhe të sfidave që lidhen me mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për DhG-në, pas të cilit, u iniciua zhvillimi i një sistemi për menaxhimin e informacionit.

OKB-ja mbështeti rishikimin dhe përditësimin e materialit ekzistues të trajnimit mbi Shëndetin seksual dhe riprodhues (ShSR) dhe DhBGj për profesionistët e ShSR, ofruesit e shërbimeve të DhBGj-së dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK) me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të ShSR-së dhe DhBGj-së për personat me aftësi të kufizuara. Një fushatë mbarëkombëtare që synon të gjitha gratë dhe vajzat që jetojnë në zonat urbane



Anastasia, një studente 19-vjeçare e filozofisë, e cila u detyrua të ikte nga shtëpia e saj në Ukrainë për shkak të konfliktit aktual. Ajo gjeti strehim në Maqedoninë e Veriut së bashku me motrën e saj, ku u mirëpritën nga një familje ukrainase që punon në Ambasadën në Shkup. Falë të qenit mendjehapur dhe kuriozitetit të saj, Anastasia u ftua të vazhdonte studimet në Fakultetin filozofik të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, ku i dhanë një laptop dhe të gjitha burimet e nevojshme për të vazhduar me studimet e saj. Anastasia është mirënjohëse për mundësinë për të vazhduar studimet dhe është e gatshme të përdorë aftësitë dhe intelektin e saj për të ndihmuar në rindërtimin e atdheut të saj. Dekani i Fakultetit Filozofik në Shkup beson se universitetet kanë një mundësi unike për të mbështetur refugjatët e rinj të cilët e kanë ndërprerë shkollimin për shkak të luftës apo persekutimit. OKB-ja mbështet qeverinë dhe të gjitha palët e interesuara në përpjekjet e tyre për të ofruar mbrojtje ndërkombëtare për refugjatët, dhe ata punojnë për të rritur pranimin e njerëzve të cilëve u shërbejnë, ndërsa potenciali i tyre të shfrytëzohet në vendet nikoqire, si dhe në atdheun e tyre pasi të ndjehen të sigurt për t'u kthyer. Foto: UNHCR



Takim me komunitetin lokal në komunën e Shuto Orizarit, për promovimin e shërbimeve për mbrojtje nga dhuna me bazë gjinore, të mbështetur nga OKB-ja dhe Ambasada Britanike në Shkup. Përmes kësaj fushate me rreth 455,000 individë u komunikua disa herë për përmbajtjen e fushatës. Foto: UNFPA

dhe rurale, me fokus në popullsinë rome, ngriti vetëdijen në lidhje me shërbimet e disponueshme për viktimat dhe ata/ato që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore dhe dhunë në familje në vend. Përveç kësaj, në tre komunitete u mbajtën ngjarje për komunitetin për të ngritur vetëdijen për dhunën në internet.

Me mbështetjen e OKB-së, mbi 15.000 gra viktime të dhunës përfituan nga **shërbimet e këshillimit** të Qendrës së këshillimit për viktimat e dhunës me bazë gjinore të fuqizuar me mbështetjen e OKB-së, si dhe nga këndi i parë gjithëpërfshirës i lojërave që do ta ulë barrën e ofruesve të kujdesit (kryesisht gra) të më shumë se 20 fëmijëve me paralizë cerebrale. Gjithashtu, 249 gra dhe vajza që kanë përjetuar dhunë në Rajonin Juglindor të vendit morën shërbime nga dy qendrat e sapo hapura të këshillimit psiko-social, të udhëhequra nga OShC-të partnere, "Skaj Plus" nga Strumica dhe "EHO" nga Shtipi, të mbështetura nga OKB-ja. Qëndrueshmëria e Qendrës për Këshillim Psiko-Social në Strumicë është siguruar përmes hartimit dhe miratimit të Planit lokal të veprimit komunal për dhunën me bazë gjinore. 13 gra që kanë përjetuar dhunë, të cilat janë gjithashtu të papuna për një periudhë të gjatë dhe janë nëna të vetme, fituan vende pune dhe i mbajtën ato nëpërmjet pjesëmarrjes në një program **12-mujor të mentorimit social për fuqizim ekonomik**. Këto gra kanë raportuar një rritje të vetëbesimit për të kërkuar punë dhe një situatë të përmirësuar financiare që rezulton me një cilësi më të mirë jetese dhe mirëqenie më të mirë.

REZULTATI 3

Mjedis jetësor i shëndetshëm



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga veprimet ambicioze klimatike, burimet natyrore të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe biodiversiteti i ruajtur mirë përmes menaxhimit të mirë të mjedisit jetësor dhe nga komunitetet rezistente ndaj fatkeqësive.

Kontributi në QZHQ



Harmonizimi me prioritetet strategjike të Qeverisë

• 15. Investimi për zhvillim të qëndrueshëm (1. Zhvillimi i bujqësisë, 2. Infrastruktura, 3. Energjia); 16. Mjedis jetësor i shëndetshëm; Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore



Harmonizimi me kapitujt e BE-së

• 11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural; 12: Politikë e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; 15. Energjia; 27. Mjedis jetësor dhe Ndryshimet Klimatike; 26: Arsimi dhe Kultura; 28: Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik

Shpenzimet në vitin 2022

\$10,291,711

Partnerët e zhvillimit:

Qeveria - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave; Ministria e Arsimit; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Ekonomisë; Kabineti i Zëvendëskryeministrit për Çështje Ekonomike; Qendra për Menaxhim të Krizave; Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim; Vetëqeverisjet lokale; Shoqatat e fermerëve; Dhomat e tregtisë; OJQ-të, sektori privat



Mbështetja e OKB-së për reduktimin e rrezikut nga përmbytjet vazhdoi me aktivitete të ndryshme në rajonin e Pollogskut, si dhe përgjatë lumit Èndrra e Zezë. Si rrjedhojë, më shumë se 100 mijë qytetarë të këtij rajoni tani kanë një rrezik më të ulët të përmbytjeve. Në pellgun e lumit Dream, u identifikuan masa dhe veprime të përshtatshme për zbutjen e rrezikut nga përmbytjet bazuar në modelet hidrologjike dhe hidraulike të mbështetura nga OKB-ja dhe hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe një vlerësim dhe vlerësim gjithëpërfshirës socio-ekonomik të cënueshmërisë së komuniteteve në pellgun ujëmbledhës. Në Pollog janë investuar edhe në infrastrukturën për parandalimin e rrezikut nga përmbytjet dhe në kapacitetin e agjencive përkatëse emergjente. Për shembull, janë ripyllëzuar 40 hektarë tokë erozive në Parkun Kombëtar Shar Planina, është rikonstruktuar shtrati i lumit Bogovinja dhe është pastruar rrjeti atmosferik në Gostivar. Për më tepër, kapacitetet e agjencive përkatëse të emergjencave dhe institucioneve të tjera lokale në rajonin e Pollogskut u rritën duke ofruar pajisje, duke organizuar ushtrime dhe duke shkëmbyer përvoja me kolegë nga rajoni. Foto: UNDP

OKB-ja mbështeti krijimin e një politike gjithëpërfshirëse kombëtare për ndryshimet klimatike. Pas miratimit të kontributeve ambicioze të rishikuara të përcaktuara në nivel kombëtar (KRPK), në vitin 2022, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor u mbështet për të hartuar Komunikimin e 4-të Kombëtar për UNFCCC (Komunikata e 4-të Kombëtare), i cili përfshin informacion mbi Inventarin Kombëtar të GS-ve, parashikimet sektoriale të emetimeve të GS-ve dhe masat përkatëse zbutëse, si dhe cënueshmërinë e vendit ndaj efekteve negative të ndryshimeve klimatike dhe masat e propozuara të përshtatjes. U përgatit projekt-propozimi për zhvillimin e një Plani Kombëtar të Përshtatjes dhe do të dorëzohet në FKGJ në tremujorin e parë të vitit 2023. OKB-ja gjithashtu mbështeti përmirësimin e të dhënave për ndryshimet klimatike përmes Platformës për Monitorim, Raportim dhe Verifikim (MRV) të zhvilluar rishtazi. Platforma i mundëson vendit të raportojë te UNFCCC-ja/ Marrëveshja e Parisit dhe në BE/Komunitetin e Energjisë.

Ndërgjegjësimi i fëmijëve dhe adoleshentëve për ndryshimet klimatike dhe mjedisin jetësor u përforcua përmes qasjes sistematike me shtrirje të gjerë. Në vitin 2022, Byroja për Zhvillimin e Arsimit me mbështetjen e OKB-së futi tema për ndryshimet klimatike dhe mjedisin jetësor në programin mësimor të shkencave natyrore të shkollave të rregullta fillore (klasa e 2-të dhe e 5-të), duke i plotësuar programet mësimore për klasat e 1-ra dhe të 4-ta të rishikuara më parë në vitin 2021, dhe zhvilloi materiale mësimore për kopshtet. Mbi 120 mësues të shkollave parashkollë dhe fillore u trajnuan për integrimin e koncepteve të mjedisit jetësor në mësimdhënie dhe ata më tej e shpërndanë programin tek 800 kolegë përmes komuniteteve profesionale të të mësuarit, vizitave në shkolla dhe realizimit të përbashkët. Më tej, është formuar një rrjet i qendrave shkencore për mësim në bazë të përvojës, për të mundësuar përvojë praktike për të rinjtë dhe përfshin Institutin Hidrobiologjik - Ohër, Muzeun e Shkencave Natyrore - Shkup, Parkun Kombëtar Galiçica, Qendrën Arsimore "Negrevo" në Pehçevë, Teknikën kombëtare - Shkup dhe Kopshtin botanik të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore - Shkup. Në fund, u përfshinë 140.929 të rinj, ndërsa 5.113 u angazhuan në mediat sociale përmes komunikimit të mbështetur nga OKB-ja për iniciativat zhvillimore mbi veprimin klimatik të udhëhequr nga të rinjtë.


Për të rritur qasjen në financa për ndryshimet klimatike në vend, OKB-ja e mbështeti vendin me aktivitete përgatitore dhe zbatuese për të përfituar ose rritur qasjen në katër fondet kryesore globale – Fondin e Klimës së Gjelbër, Fondin e Përshtatjes, Fondin Global të Mjedisit Jetësor dhe Fondin e Përbashkët të OZHQ. Më tej, OKB-ja mbështeti edhe Kabinetin e Zëvendëskryeminitrit për Çështje Ekonomike, si Autoritetin e Përcaktuar Kombëtar (APK) për FKGJ, dhe Ministrinë e Financave për të zhvilluar një procedurë për monitorimin, gjurmimin dhe lehtësimin e financave për klimën dhe një sistem të ri në internet për mbledhjen dhe raportimin për të dhënat për financat e klimës në faqen e internetit të IPN-së www.greendevopment.mk. Për të mundësuar transformimin dhe përfshirjen e sektorit privat drejt ekonomisë së gjelbër dhe neutrale ndaj karbonit, OKB-ja ka realizuar një vlerësim të teknologjisë klimatike për sektorin industrial dhe vazhdoi të ofrojë asistencë teknike dhe shpërblime financiare të bazuara në performancë për kompanitë.

Më tej, OKB-ja mbështeti Ministrinë e Ekonomisë dhe Agjencinë e Energjetikës për të zhvilluar legjislacionin dytësor për revizionet energjetike të ndërmarrjeve të mëdha; dhe zhvillimin e pakos së parë të mjeteve online për përfshirjen e sektorit privat në veprimin për klimën.

Për të luftuar shterimin e shtresës së ozonit, OKB-ja mbështeti rishikimin e legjislacionit kombëtar dhe mbledhjen e të dhënave për substancat që e shterojnë ozonin, Rregulloren për licencat për menaxhimin e ftohësve dhe/ose produkteve që përmbajnë ftohës, dhe Studimin për sasi të mbeturinave të ftohësve. Për më tepër, OKB-ja mbështeti monitorimin dhe kontrollin e përhershëm të konsumit të hidroklorofluorokarbureve (HCFC) dhe substancave të tjera që e shterojnë shtresën e ozonit (vlerësimi i 50 licencave të importit), si dhe monitorimin e skemës së rimëkëmbjes dhe riciklimit me 25.009,50 kg substanca të kontrolluara dhe përzjerje të tyre. Dyqanet e servisimit u vlerësuan për të bërë përgatitje për dhënie e pajisjeve për ripërtëritje dhe riciklim.

Për sa i përket përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, mbështetja më e madhe e OKB-së u përqendrua në rezistencën më të madhe të sektorit bujqësor dhe të zonave urbane. Në vitin 2022, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave me mbështetjen e OKB-së e lëshoi në përdorim Platformën kombëtare e-Agri. Platforma i informon hartuesit e politikave për krijimin e politikave të qëndrueshme bujqësore dhe u mundëson fermerëve të përmirësojnë qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor, produktivitetin dhe të ardhurat e fermave të tyre. Platforma e-Agri e integron bujqësinë globale dhe kombëtare, të dhënat meteorologjike, klimatike dhe hapësinore, duke përfshirë Platformën globale të hartës së Tokës. Më tej, OKB-ja mbështeti qeverinë në promovimin e sistemeve të farës tolerante ndaj klimës përmes analizës ligjore të legjislacionit kombëtar për farat, dhe demonstrimeve në fermë dhe trajnimeve të fermerëve, prodhuesve bujqësorë, përfaqësuesve të fermave të farave, kooperativave bujqësore dhe përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë në partneritet me Institutin e Bujqësisë të UKdheM. Më tej, është përgatitur një propozim për përmirësimin e sistemit të ujitjes, menaxhimit të tokës dhe ujërave në Radovish.

Ne aspekt të rezistencës urbane, Qyteti i Shkupit u mbështet për



OKB-ja asistoi Ministrinë bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit të ujërave në krijimin e një platforme ueb e-Bujqësie që konsolidon të dhënat kombëtare bujqësore, si p.sh.për tregun, të dhënat klimatike dhe të dhënat hapësinore, nga sisteme dhe baza të të dhënave të shumta digjitale. Platforma do t'u sigurojë politikëbërësve njohuri për të zhvilluar politika dhe masa për një tranzicion të qëndrueshëm në bujqësi. Foto: FAO

të zgjeruar bazën e të dhënave për mjedisin jetësor, informacione dhe studime të nevojshme për marrjen e vendimeve në bazë të informatave, siç është Harta e Biotopit, Inventarizimi i vendbanimeve përgjatë lumenjve, Studimi i ujërave nëntokësore, Strategjia e Menaxhimit të Ujërave, Studimi i shtigjeve të mundshme të transmetimit të kromit gjashtëvalent në ujërat nëntokësore të malit Zheden dhe ndikimi i tyre në burimin e Raçes, Dokumenti i planifikimit strategjik për ridizajnimin e hapësirave publike, si dhe dokumentacioni teknik për një korridor të gjelbër përgjatë lumenjve Seravë dhe Lepenc. Gjithashtu u mbështetën masat pilot të rezistencës urbane për të reduktuar efektet e ishujve urbanë të nxehtësisë, gjegjësisht dy kulmet e gjelbra në Qendrën tregtare të qytetit dhe në Shtëpinë e kulturës “Koço Racin” dhe gjelbërimi i shpatinave të Kalasë së Shkupit. Për më tepër, efikasiteti energjetik i kompleksit të ndërtesave të Qeverisë dhe Presidencës u përmirësua përmes zbatimit të sistemit të menaxhimit të energjisë dhe certifikimit ISO 50001.

Me mbështetjen e OKB-së, u përforcuan kapacitetet e institucioneve kombëtare për të përforcuar rezistencën e rezervave të biosferës dhe lokacioneve të trashëgimisë botërore për sa i përket ndryshimeve klimatike dhe rrezikut nga fatkeqësitë, si dhe u formua rrjeti i praktikuesve të Evropës juglindore.

Në aspekt të menaxhimit të integruar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të burimeve natyrore, tashmë është arritur një rritje e ndjeshme e sipërfaqes nën mbrojtje në 13,9% të territorit të vendit, nga një nivel bazë prej 10,34% në vitin 2019 (arritje prej 76% i Treguesit të rezulttit të KBZhQ-së: Përqindja e zonës së vendit që është përcaktuar si e mbrojtur), kryesisht falë shpalljes së Parkut të ri Kombëtar të Malit Sharr në vitin 2021, i mbështetur nga OKB-ja përmes përgatitjes së Studimit të Valorizimit. Mbështetja e OKB-së për Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor vazhdoi edhe në vitin 2022 duke u fokusuar në krijimin e institucioneve përkatëse dhe kapacitetet implementuese të Parkut Kombëtar të Malit Sharr, përmes hartimit të një Plani draft për menaxhimin e parkut, për të mundësuar mbrojtjen efektive të kësaj biosfere. Më tej, OKB-ja mbështeti përgatitjen e një Studimi të rivalizimit për Liqenin e Ohrit, që është dokumenti kryesor teknik për rishpalljen e Liqenit të Ohrit si monument i natyrës, hartimin e Planit të Menaxhimit dhe e lehtësoi angazhimin e kryetarëve të komunave përreth liqenit (Ohrit, Strugës dhe Debërcës) për të mbrojtur dhe restauruar bashkërisht liqenin në. Rojtarët e pyllit, përfaqësuesit e zonave të mbrojtura, anëtarët e shoqatave të bjeshkatarëve dhe gratë lokale u trajnuan për menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura.

Me mbështetjen e OKB-së, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e përforcoi politikën kombëtare dhe menaxhimin e ekosistemeve pyjore drejt ruajtjes më të madhe të pyjeve dhe mbrojtjes së vendbanimeve të bimëve, shpendëve dhe kafshëve. U hartuan Udhëzimet për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve për dy lokacione pilot (Bukoviq dhe Bellasicë). Për më tepër, u valorizuan 188 pyje me vlera të larta natyrore me pothuajse 56.000 hektarë dhe pemë individuale të vjetra me karakteristika të jashtëzakonshme natyrore dhe lokalitete me komunitete të rëndësishme bimore. Për të siguruar qasje të pandërprerë në ushqim, mbarështim dhe reduktim të vdekshmërisë nga aksidentet e komunikacionit të mishngrënësve të mëdhenj (veçanërisht të rrëqebullit të Ballkanit dhe ariut të murrme), OKB-ja identifikoi dhe rekomandoi masa mbrojtëse për dy korridoret pilot dhe hartoi një doracak për projektimin e kalimeve të gjelbra për kafshët e egra / korridoret biologjike mbi infrastrukturën kryesore rrugore dhe hekurudhore. Rekomandimet u morën përsipër nga institucionet përkatëse - NP “Rrugët Shtetërore”, NP “Pyjet Kombëtare” dhe disa shoqata gjuetie për zbatim. Më tej, veprime konkrete për mbrojtjen e biodiversitetit të zvarranikëve dhe amfibëve u katalizuan përmes zhvillimit të Librave të parë të Kuq Kombëtarë të Zvarranikëve dhe Amfibëve, të cilat analizojnë statusin, tendencat dhe kërcënimet ndaj këtyre specieve dhe kontribuojnë në mbrojtjen e tyre.

Për shkak të rëndësisë së mbrojtjes së tokës si një mjet kryesor për sigurimin e biodiversitetit, OKB-ja mbështeti Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunat e përzgjedhura

në punën pioniere për krijimin e kornizës së politikave për përforcimin e mbrojtjes së tokës dhe neutralitetit të degradimit të tokës. Në vitin 2022, OKB-ja e mbështeti Propozim-ligjin për Mbrojtjen e Tokës dhe përditësimin e Planeve lokale të veprimit për mjedisin jetësor për Haracinën, Sarajin, Zhelinën, Jegunovcën dhe Likovën që të përfshijnë qasjet për kontrollin e erozionit dhe ujërat e përrënjeve. Me mbështetjen e OKB-së, Maqedonia e Veriut ka përgatitur Raportin e parë Kombëtar për Konventën e OKB-së për Luftën kundër Shkretëtirizimit (UNCCD).

56,000 hektarë

pyje dhe pemë individuale të valorizuara

Progres i konsiderueshëm është arritur edhe në drejtim të reduktimit të ndotjes të ajrit, me ç'rast niveli vjetor i grimcave PM10 është reduktuar nga 51,32 µg/m3 në vitin 2019 në 35,91 µg/m3 (Treguesi i rezulttit të KBZhQ-së: Nivelet mesatare vjetore të grimcave PM 10 janë arritur plotësisht si dhe Synimi i OZHQ-së 11.2). OKB-ja kontribuoi në këtë zhvillim pozitiv, përmes përmirësimeve në kornizën e përgjithshme të politikave dhe aktiviteteve pilot për ngrohjen e shtëpive në lagjen më të ndotur Lisiçe, të kryeqytetit - Shkupit. Falë mbështetjes së OKB-së, operatorët e tregut i kanë ndryshuar praktikat dhe kanë përfshirë pajisje të reja efikase për ngrohje dhe gatim në treg, pasi janë trajnuar mbi këto teknologji dhe karakteristikat e tyre që i bëjnë ato më tërheqëse për blerësit në krahasim me produktet tjera dhe janë stimuluar përmes kornizës së re ligjore e cila kërkon që kanalet e shitjes të promovojnë pajisje që kursejnë energji. Skemat e subvencionimit për përmirësime që kanë efikasitet energjetik në ndërtesat e banimit për familjet me të ardhura të ulëta dhe ato me të ardhura mesatare u pilotua me sukses në Lisiçe, që rezultoi me një ulje prej 40% në ndotjen e ajrit për sa i përket grimcave PM10 (60,359 µg/m3 në vitin 2020 kundrejt 35,5 µg/m3 në vitin 2021) në këtë zonë dhe ulje prej 60% në emetimet ndotëse (5,56t në vitin 2021 kundrejt 2,23t në vitin 2021). Si pjesë e këtij aktiviteti pilot, 399 amvisëri, duke përfshirë amvisëritë e cenushme në aspekt ekonomik u mbështetën për të zëvendësuar ngrohjen joefikase dhe për të zbatuar efikasitetin energjetik. Në fund, u zhvillua Studimi i ndarjes së burimeve të ndotjes, duke i analizuar burimet e ndotjes së ajrit dhe duke ofruar të dhëna për Planin e Veprimit për Qytetin e Shkupit. Platforma kombëtare online për ndotjen e ajrit u zhvillua për të lehtësuar dialogun ndërmjet qeverisë, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit akademik. Progres i pjesshëm vërehet në uljen e rrezikut të përgjithshëm të katastrofave me ç'rast vlera e indeksit të rrezikut INFORM për vendin u përmirësua pak në 2,4 pikë në vitin 2022, por ende larg synimit prej 2,0 pikë (Treguesi i rezulttit të KBZhQ-së: Indeksi i rrezikut INFORM, niveli i aritjes 33%). Reformat e sistemit të përgjithshëm të menaxhimit të krizave janë ende në pritje dhe një situatë e tillë e pengon arrijtjen e objektivave të Kornizës Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë. Në këtë kontekst, OKB-ja është një nga organizatat e pakta që ka mbështetur vendin në ndërtimin e rezistencës, me fokus në reduktimin e rrezikut të epidemive dhe përmytjeve të mëdha, nëpërmjet krijimit të një sistemi gjithëpërfshirës dhe grupit të masave për t'iu përgjigjur këtyre llojeve të rrezikut nga fatkeqësitë. Disa dokumente të rëndësishme të politikave dhe udhëzime për parandalimin e rrezikut nga përmytjet u zhvilluan me mbështetjen e OKB-së. Këto përfshijnë skicën e një Strategjie Kombëtare për Zbutjen e Rrezikut nga Përmytjet, draft-Rregulloren për Përgatitjen e Planeve Komunale të Mbrojtjes nga Përmytjet, dhe draft-Udhëzuesin për Integrimin e Reduktimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë në Planifikimin Urban.

40%

ulje e ndotjes së ajrit me grimcat PM10 në vendbanimin e Shkupit përmes mbështetjes së OKB-së

Në vitin 2022, OKB-ja vazhdoi të mbështesë ndërtimin e një sistemi efektiv dhe efikas për zbulimin dhe reagimin ndaj

epidemive, si një nga burimet e rreziqeve nga fatkeqësitë. Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin e Shëndetit Publik, OKB-ja krijoi dhe aftësoi **Qendrën Operative Emergjente të Shëndetit Publik** dhe mundësoi **shkëmbimin e të dhënave në kohë reale për sëmundjet brenda rrjetit laboratorik të shëndetit publik**, nëpërmjet digjitalizimit të tyre. Kjo e rrit në mënyrë të konsiderueshme gatishmërinë dhe kapacitetin e reagimit të vendit ndaj epidemive.

Mbështetja e OKB-së për **reduktimin e rrezikut nga përmblytjet** dhe ndërtimin e rezistencës vazhdoi me aktivitete të ndryshme në rajonin e Pollogut dhe në pellgun e lumit Drin, të cilat që janë në realizim e sipër. Si rezultat i tyre, më shumë se **100,000 qytetarë** në këto rajone kanë përfituar nga reduktimi i rreziqeve nga përmblytjet. Në Pollog janë bërë investime si në infrastrukturën për parandalimin e rrezikut nga përmblytjet, ashtu edhe në aftësimin e institucioneve relevante të emergjencës. Për shembull, u pyllëzuan/ripyllëzuan hektarë tokë e gërryeshme në Parkun Kombëtar të Malit Sharr, u rikonstruktua shtrati i lumit të Bogovinës, dhe u pastrua rrjeti i ujërave atmosferikë në Gostivar. Për më tepër, institucionet relevante të emergjencës dhe institucionet e tjera lokale në rajonin e Pollogut u fuqizuan përmes sigurimit të pajisjeve, organizimit të ushtrimeve dhe shkëmbimit të përvojës me kolegë nga rajoni. Në pellgun e lumit Drin, u identifikuan masat dhe aktivitetet e duhura për zbutjen e rrezikut nga përmblytjet në bazë të modeleve hidrologjike dhe hidraulike të mbështetura nga OKB-ja dhe hartat e rrezikut nga përmblytjet dhe vlerësimi gjithëpërfshirës socio-ekonomik dhe cenusshmëria e komuniteteve të pellgut. Përfunduan punimet për restaurimin e lumit Sateska dhe devijimin e tij në shtratin e vjetër të lumit. Në aspekt të **mbeturinave të rrezikshme**, ka nisur pastrimi i pikës së nxehtë ekologjike OHIS (kompleksi i vjetër i fabrikës kimike), i ndotur me lindan kancerogjen (HCH). Pastrimi do të kontribuojë në zgjidhjen e problemit të kahershëm të ekspozimit ndaj kësaj lënde toksike për zonat me popullsi të dendur urbane në kryeqytetin e vendit. Pas aktiviteteve të mëparshme përgatitore të infrastrukturës, OKB-ja organizoi heqjen efektive të 1.083 tonë mbeturinave të HCH-së dhe

tokës së kontaminuar me HCH në vitin 2022. Ky aktivitet do të vazhdojë edhe në vitin 2023. Gjithashtu, OKB-ja mbështeti ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve qeveritarë dhe statisticienëve në lidhje me statistikat e mbeturinave elektronike në nivel rajonal, për të siguruar një pasqyrë të përmirësuar të dinamikës dhe menaxhimit kombëtar të mbeturinave elektronike që do të ofrojë të dhëna për vendimet që do të merren për politikën në nivel kombëtar. Profilët e mbeturinave elektronike të vendeve, si dhe një Raport rajonal i monitorimit të mbeturinave elektronike në Ballkanin Perëndimor janë planifikuar të prodhohen në vitin 2023.



Ka nisur pastrimi i pikës së nxehtë mjedisore të OHIS-it të kontaminuar me lindan kancerogjen (HCH). Pastrimi do të kontribuojë në zgjidhjen e një problemi të gjatë me ekspozimin ndaj kësaj substance toksike për zonat urbane me popullsi të dendur në kryeqytetin e shtetit. Pas aktiviteteve të mëparshme përgatitore të infrastrukturës, OKB-ja organizoi asgjësimin efikas të 1,083 tonëve mbetje HCH dhe toka e kontaminuar me HCH në 2022. Ky aktivitet do të vazhdojë edhe në vitin 2023. Kredia: UNOPS

REZULTATI 4

Qeverisja e mirë



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga sundimi i përmirësuar i ligjit; politikat e bazuara në dëshmi, të parashikueshme dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë; nga kohezioni më i madh shoqëror; dhe ofrimi efektiv i shërbimeve nga institucione transparente, llogaridhënëse dhe të përgjegjshme

Kontributi në OZHQ



Prioritetet strategjike të qeverisë

- Sundimi i ligjit, qeverisja e mirë dhe antikorrupsioni
- Promovimi i demokracisë dhe lirisë
- Integrimi në BE



Kapitujt e BE-së: Themelet në rend të parë



- Themelet në rend të parë
- Themelet e klasterit 1, Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore
- Themelet e klasterit 1, Kapitulli 24: Drejtësia, Liria dhe Siguria

Shpenzimet në vitin 2022

\$10,589,510

Partnerët e zhvillimit:

•Kabineti i Kryeministrit, Zëvendëskryeministri Përgjegjës për Qeverisjen e Mirë dhe Çështjet Ekonomike, Sekretariati për Çështjet evropiane, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Parlamenti, Banka Popullore, EShS-ja, Byroja për Zhvillim rajonal, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Enti Shtetëror i Revizionit, njësitë e vetëqeverisjes lokale, Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, Avokati i Popullit, Organi Kombëtar koordinues kundër Diskriminimit, IKDNJ-të, Grupi i punës ndërmënisht për miratimin e politikës të migracionit, Gjyqësori, Prokuroria Publike, Prokuroria për ndjekjen e Krimit dhe Organizuar dhe Korrupsionit, Drejtoria Doganore, OBD-ja, INTERPOL-i, Komisioni kombëtar për UNESCO-n, Dhoma e Avokatisë, ShJRM, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, Shoqata e Punonjësve Financiarë të Maqedonisë (ShPFM), Bashkësia e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale, shoqëria civile dhe komuniteti akademika



Valentin Rakip, djali që u bë një fyturë e njohur për fëmijët pa shtetësi në vend, shitës i revistës Lice v Lice, ka marrë më në fund shtetësinë e vendit. Foto: UNHCR

Maqedonia e Veriut fitoi një shtytje për reformat me fillimin e shqyrtimit të anëtarësimit në BE dhe proceseve negociuese. Aktivitetet e OKB-së kontribuan më tej në harmonizimin e kornizave ligjore, politike dhe institucionale me legjislationin e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare që i avancuan të drejtat themelore, barazinë gjinore, mosdiskriminimin, qasjen në drejtësi, të cilat kanë rëndësi kyçe për anëtarësimin në BE dhe arritjen e OZHQ-ve. Qeverisja gjithëpërfshirëse dhe transparente nxiti gëzimin e të drejtave dhe pjesëmarrjen kuptimplotë të njerëzve, duke u mundësuar grave, të rinjve,

personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të cenueshme të shprehin mendimin e tyre në hartimin e politikave dhe në vendimmarrje në nivel qendror dhe lokal. **Mbi 100 persona që përballen me diskriminim dhe përjashtim** - gra dhe vajza, persona me aftësi të kufizuara, viktime të dhunës me bazë gjinore dhe të trafikimit të qenieve njerëzore, persona që u përkasin pakicave të caktuara etnike, si romët - u fuqizuan që të përfitojnë mbrojtje nga trajtimi i pabarabartë në realizimin e të drejtave të tyre. **190 persona fituan shtetësinë** për shkak të ndërhyrjeve ligjore. OKB-ja, së bashku

me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, kontribuan në zhvillimin e një **strategjie të re për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe gjithëpërfshirjen**, dhe mbështeti kornizën kombëtare për monitorimin e zbatimit të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK), duke i rritur mundësitë për pjesëmarrje domethënëse në hartimin e politikave dhe marrjen e vendimeve që ndikojnë në jetën e tyre.

Në **sektorin gjyqësor**, mbështetja e OKB-së rezultoi me një mbrojtje më të fortë të drejtësisë penale përmes inkriminimeve të reja për dhunën në internet dhe jashtë internetit ndaj grave dhe fëmijëve. Ka filluar procesi për ta transformuar drejtësinë për fëmijët në një sistem jo ndëshkues dhe restaurues, ku interesat e fëmijëve në konflikt me ligjin janë me rëndësi parësore. Për ta mbajtur një ndryshim të tillë sistemor, u mbështet zhvillimi i Strategjisë së re Kombëtare për Parandalimin dhe Drejtësinë për Fëmijët, dhe u trajnuan 350 profesionistë të fushës së drejtësisë dhe të mbrojtjes sociale, të cilët gjithnjë e më shumë kanë zbatuar qasje multisektoriale duke e marrë parasysh traumën e përjetuar në trajtimin e fëmijëve në rrezik dhe të atyre në konflikt ose në kontakt me ligjin. Fushata multimediale **“Thjesht një fëmijë”** ka rritur vetëdijen për pasojat gjatë jetës së masave ndëshkuese dhe përvojave të pakëndshme të fëmijërisë. U avancuan aftësitë e profesionistëve të drejtësisë për **luftën kundër krimeve të rënda dhe transnacionale**, duke përfshirë trafikun e paligjshëm të drogës dhe armëve, trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën e emigrantëve dhe financimin e paligjshëm të terrorizmit. Qasja në të drejtat e viktimave dhe masat mbrojtëse për këto drejta janë përforcuar me ligjin e ri për kompensimin e financuar nga shteti të viktimave të krimeve të dhunshme, i cili u zhvillua me mbështetjen e OKB-së.

Fatmir Bytyqi

Zëvendëskryeministër përgjegjës për çështjet ekonomike
Kam marrë pjesë në punëtori (për zhvillimin e një vizioni në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim) në Shkup dhe sinqerisht jam shumë krenar që shumë të rinj, nga grupe të ndryshme etnike, përfaqësues të grupeve vulnerabël të qytetarëve diskutuan mes tyre dhe shkëmbyen ide. Çdo sugjerim, çdo vizion për zhvillimin e vendit është një thesar, sepse na ndihmon të përcaktojmë për herë të parë një dokument që do të përfaqësojë një udhërrëfyes afatgjatë dhe gjithëpërfshirës për politikën që duhet të bëjmë në 20 vitet e ardhshme. Burimi: UNDP

Rritja e kapaciteteve dhe njohurive të qeverisë, gjyqësorit, organizatave të të drejtave të njeriut dhe institucioneve të tjera të pavarura, si dhe të shoqërisë civile krijuan një klimë pozitive për ndryshim, inovacion dhe progres në prioritetet strategjike kombëtare. OKB-ja e mbështet zhvillimin e **Strategjisë së parë Kombëtare për Zhvillim** duke i vendosur hapat për zhvillimin e vendit për dy dekadat e ardhshme. Mbi 3.000 qytetarë dhe aktorë multisektorialë të zhvillimit u angazhuan në punëtori vizionare për SKZH-në, dhe në për krijimin e të ardhmeve, paralelisht me analizën bazë. Strategjia e re për Transformimin Digjital (TIK) 2023-2027 u hartua me mbështetjen e OKB-së. Në mbështetje të procesit të anëtarësimit në BE, OKB-ja vazhdoi të përforcojë procesin e përafrimit të legjislacionit dhe **aftësitë negociuese** të Kuvendit dhe të SÇE-së për integrimin evropian në priorizimin e asistencës teknike dhe integrimin e ekspertizës dhe të burimeve në fushat kritike të reformave. U përforcuan kapacitetet e SÇE-së, grupeve sektoriale të punës, dhe të **institucioneve të tjera qeveritare për integrimin e legjislacionit të BE-së për barazinë gjinore** në ligjet dhe

politikat kombëtare. U promovua përfshirja aktive shoqërisë civile dhe e mediave në procesin e anëtarësimit në BE, përmes një skeme të granteve me të cilën u mbështetën aktivitetet e lobimit, përfaqësimit, mbikëqyrjes dhe ngritja e kapaciteteve në nivel kombëtar dhe lokal. Nën udhëheqjen e SÇE-së, u krijua një rrjet i bashkëpunimit të institucioneve kombëtare që marrin pjesë në procesin e integrimin në BE.

Reforma e menaxhimit të financave publike shënon përmirësim në transparencën e shpenzimeve publike, revizionin, çmimet e transferit, treguesit për matjen e ekonomisë informale dhe vijoi në një cikël të ri reformash në periudhën 2022-2025. Sistemi u përforcua më tej me Ligjin e ri të Buxhetit, që është një nga ligjet bazë të qeverisë, i cili e përfshin barazinë gjinore si një nga parimet kryesore buxhetore dhe që është kusht për shqyrtimin e prioritetëve të barazisë gjinore në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit. Revizioni i parë i performancës në aspekt gjinor është kryer nga Enti Shtetëror i Revizionit duke dhënë rekomandime për masa më efektive qeveritare për avancimin e barazisë gjinore. Qasja e integruar e qeverisjes ndikoi në **sistemin e qeverisjes lokale** dhe në decentralizimin. Me mbështetjen e OKB-së, u zhvillua Tabela kontrolluese e të dhënave për komunat, e cila tani përdoret nga 50 komuna, për të shkëmbyer informacione mbi shpenzimet buxhetore; duke u mundësuar qytetarëve të monitorojnë shpenzimet publike në nivel tremujor. U siguruan mjete financiare shtesë për komunat duke futur dy mekanizma të reja të financimit. U hartua një metodologji për vlerësimin gjithëpërfshirës të sistemit të qeverisjes lokale dhe vlerësimin e ndikimit rregullator për të gjeneruar dëshmi dhe të dhëna për riorganizimin e kompetencave lokale. Modeli i e-Komunës u zgjerua me shërbime të reja publike të digitalizuara për më shumë se 300.000 njerëz. Numri i komunave, të cilat përdorin e-Tabelën kontrolluese për ekzekutimin e buxhetit komunal, ka rritur në gjithsej 46 komuna. Në arsimin fillor, u zhvillua një formulë e re për ndarjen e mjeteve të komunave për të gjitha shkollat fillore për të ofruar arsim me cilësi të mirë në përputhje me standardet ndërkombëtare, e cila do të zbatohet që nga viti i ardhshëm.

Strategjia e re e Barazisë Gjinore (2022-2027) u miratua duke e theksuar rëndësinë e financimit adekuat për barazinë gjinore në të gjitha 17 fushat prioritare tematike. Barazia gjinore u integrua në të gjitha fushat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, në fazën fillestare të zhvillimit të saj. Përfaqësuesit e 16 institucioneve publike dhe të palëve të tjera të interesuara fituan njohuri mbi statistikat gjinore dhe analizën gjinore. U përforcuan kapacitetet e 169 përfaqësuesve të institucioneve shtetërore për BPGJ-në në proceset e planifikimit sektorial dhe buxhetimit. Qëndrueshmëria e rezultateve dhe një ndjenjë më e fortë e pronësisë lokale për integrimin gjinor u arrit me krijimin e liderëve të barazisë gjinore në 7 institucione, të cilët e përfunduan trajnimin e parë të trajnuesve për integrimin e aspektit gjinor në proceset e IPA-s. Në nivel lokal, 307 përfaqësues, 212 zyrtarë publikë dhe 95 këshilltarë komunalë u trajnuan për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe barazinë gjinore. **Të gjitha këto rezultate së bashku me punën e partnerëve të tjerë dhe të institucioneve kombëtare kanë kontribuar në përmirësimin e Indeksit të barazisë gjinore (2022)** që u mat në rrethin e dytë, duke treguar një rritje prej 2,5 pikësh nga indeksi i vitit 2019, duke arritur në 64,5 pikë, që paraqet afrim me objektivin kombëtar prej 65 pikësh.

Qasja progresive, transparente dhe pjesëmarrëse e Kombeve të Bashkuara në hartimin e politikave të bazuara në të dhëna, i bëri politikat kombëtare më efektive dhe më të adekuata për sfidat e reja. U bënë përpjekje të rëndësishme për rritjen e kapaciteteve institucionale të lidhura me të dhënat dhe përdorimin e të dhënave nga regjistrimi i popullsisë, amvisërive dhe banesave dhe digjitalizimin e proceseve statistikore. **Publikimi i parë zyrtar i rezultateve të regjistrimit të popullsisë, amvisërive dhe banesave në vitin 2021**, që u bë me mbështetjen e OKB-së, kontribuoi në një kuptim

më të mirë të tendencave kryesore demografike në vend dhe ndikimin e tyre në politika dhe vendimmarrje. U hartua **Udhërrëfyesi Kombëtar për Statistikat e Migracionit** dhe Programi për Hulumtime Statistike 2023-2027 në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. U eksplora përdorimi i mundshëm i burimeve alternative dhe inovative të të dhënave, si p.sh. remitancat dhe të dhënat e mëdha (big data). Institucionet e drejtësisë u aftësuan për të mbledhur, integruar dhe gjeneruar të dhëna për mbrojtjen e fëmijëve, në lidhje me fëmijët në kontakt me ligjin dhe fëmijët viktime. Në nivel lokal, Indeksi i Zhvillimit Komunal (IZHK) u përditësua për të pasqyruar të dhënat e Regjistrimit të popullsisë, amvisërive dhe banesave në vitin 2021, si dhe u promovua përdorimi i statistikave dhe analizave gjinore. U përmirësua qasja në shërbime mbështetëse për gratë dhe fëmijët, viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe në familje

300 të rinj

iu bashkuan një fushate për të drejtat e tyre dhe për të drejtat e bashkëmoshatarëve të tyre

Së bashku me shoqërinë civile dhe lëvizjet lokale, OKB-ja mbështeti komunitetet e marginalizuara, narrativet pozitive dhe një **kohezion më të madh social**. 74 rekomandime të politikave në 16 komuna ishin rezultat i rreth 4.000 grave që shprehën nevojat e tyre tek vendimmarrësit lokal për infrastrukturë, transport dhe shërbime publike më të ndjeshme ndaj gjinisë. OKB-ja e promovoi **fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve** në formësimin e Strategjisë së re Kombëtare për të Rinjtë dhe në vendime të tjera të politikave, së bashku

me krijimin e këshillave rinorë lokal[në pesë komuna. 87 ngjarje dhe fushata publike gjeneruan narrative pozitive dhe perceptime të grupeve dhe personave të cenusëm të lënë pas, duke përfshirë fushatën shumë të rëndësishme #IBelong për t'i dhënë fund problemit të njerëzve pa shtetësi në vend deri në vitin 2024. Në ditën e të drejtave të njeriut, 300 të rinj u ngritën për të drejtat e tyre nën sloganin "Dinjtet, Liri dhe Drejtësi për të Gjithë".

OKB-ja i ndihmoi vendit të miratojë **Udhërrëfyenin Kundër Korrupsionit dhe Financave të Paligjshme në Ballkanin Perëndimor** dhe të përfitojë nga shkëmbimi rajonal. Vlerësimet e rrezeve të korrupsionit u ndërmorën në ndërmarrjet publike dhe më shumë se 200 nëpunës civilë, kryetarë komunash dhe këshilltarë komunalë i rritën njohuritë e tyre mbi qeverisjen lokale, mbikëqyrjen, antikorruptionin dhe menaxhimin e financave publike. Sipas kornizës së bashkëpunimit ndërkufitar me Kosovën, 415 policë nga Maqedonia e Veriut shkëmbyen përvoja me kolegët e tyre në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve dhe i bashkuan forcat në rritjen e vetëdijes për keqpërdorimin e armëve të vogla dhe të lehta. Njëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta të OKB-së, institucionet kombëtare u mbështetën për të ndjekur rekomandimet për Maqedoninë e Veriut që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit (nenet 7, 8 dhe 10; si dhe nenet 53 deri 59). U zhvilluan aktivitete për ngritjen e kapaciteteve me Ministrinë e Drejtësisë për rikuperimin e pasurisë dhe integritetin në sektorin publik duke synuar OShC-të, administratën publike dhe përfaqësuesit nga institucionet e drejtësisë dhe të prokurorisë.



Trajnim i trajnerëve mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor me pjesëmarrës nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia, Prill 2022. Foto: UN Women

Financimi dhe partneriteti

Gjatë vitit 2022, Organizata e Kombeve të Bashkuara inicioi dhe zbatoi disa ndërhyrje që synonin të kanalizojnë financime më efikase për zhvillimin e qëndrueshëm nga burime publike dhe private.

Ligji i ri për Buxhetin i miratuar nga Parlamenti në shtator të vitit 2022, i shoqëruar me Sistemin e ri të Integruar të Informacionit për Menaxhimin e Financave publike (IFMIS), ofron një mundësi për të përmirësuar informacionin në lidhje me financimin e OZHQ-ve. Reforma e re për menaxhimin e financave publike e përfshin barazinë gjinore midis parimeve kryesore buxhetore dhe parashikon etiketimin gjinor të programeve buxhetore në kuadër të IFMIS-it. Në këtë kontekst, OKB-ja vazhdoi të ndërtonte kapacitetet për buxhetimin me bazë gjinore me institucionet qendrore dhe lokale, duke përfshirë edhe mbështetjen për themelimin e Qendrës së Burimeve për hartimin e politikave dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Për herë të parë në vend dhe me mbështetjen e OKB-së, u zhvillua dhe u përdor një analizë e shpenzimeve për të vlerësuar përshtatshmërinë, efikasitetin, efektivitetin dhe barazinë e buxhetit të qeverisë në drejtësi për fëmijët, për të marrë të dhëna për fazat e ardhshme të reformës së drejtësisë për fëmijët. Ky dokument strategjik i ndihmon institucionet kombëtare dhe komunale për ndjekjen, planifikimin dhe realizimin më të mirë të shpenzimeve që lidhen me drejtësinë për fëmijët, dhe në afat të gjatë do ta përmirësojë diapazonin dhe shkallën e programeve parandaluese, si dhe ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes adekuate për fëmijët në konflikt dhe në kontakt me ligjin.

Për të përmirësuar financimin për shërbimet kritike në nivel lokal, softueri i zhvilluar për vlerësimin dhe administrimin e tatimit në pronë në komunën e Sveti Nikoles u zgjerua me module për tatimin administrativ që mundëson rritjen e mëtejshme të bazës tatimore dhe mbledhjen e tatimeve lokale për më shumë se 200%.

Formula e re për shpërndarjen e mjeteve për arsimin fillor për komunat, duke u bazuar në analizat e hollësishme të sfidave që lidhen me shpenzimet publike, u miratua nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Duke e ndryshuar buxhetin aktual të rënduar nga rrogat (89%), formula e rishikuar do të rrisë mjetet për zhvillimin profesional dhe të karrierës së fuqisë punëtore të mësimdhënësve, do t'u mundësojë shkollave të ofrojnë më shumë orë mësimi dhe të sigurojnë shpërndarje efikase të burimeve për të siguruar arsim me cilësi të mirë. Ajo gjithashtu do të sigurojë drejtësi dhe barazi duke siguruar shpërndarje më të drejtë të mjeteve për shkollat me shumë gjuhë mësimore, për fëmijët me aftësi të kufizuara, për nxënësit që kanë nevojë të udhëtojnë në shkollë dhe për fëmijët nga familjet e varfra.

Ndërsa vazhdonte punën përgatitore për krijimin e Instrumentit inovativ të Financimit të Gjellbër, OKB-ja gjithashtu porositi një studim për mënyrat inovative të financimit të dokumenteve strategjike, për të cilin u zhvilluan konsultime me një numër të madh të palëve të interesuara nga institucionet shtetërore dhe sektori privat. Studimi do të shërbejë si bazë për zhvillimin e planeve financiare për të mbështetur zbatimin e Strategjisë së ardhshme Kombëtare të Zhvillimit.

Për të rritur kontributin e sektorit privat në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, OKB-ja inicioi një studim për të eksploruar nëse dhe/ose si bizneset në Maqedoninë e Veriut

aktualisht po punojnë për të harmonizuar aktivitetet e tyre me OZHQ-të. Një nga gjetjet tregon se 51% e të anketuarve nuk janë të njohur me OZHQ-të dhe çfarë përfaqësojnë ato, gjë që sugjeron se ka hapësirë për angazhim thelbësor me sektorin privat, duke filluar me rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me Agjendën 2030 dhe duke treguar shembuj të kontributeve të sektorit privat.

Me mbështetjen e Fondit të përbashkët të OZHQ-ve, OKB-ja porositi një analizë gjithëpërfshirëse për të vlerësuar efektet e krizës së ushqimit, energjisë dhe financave në një mënyrë të synuar, të qëndrueshme dhe të bazuar në dëshmi. Duke i pasur parasysh burimet gjithnjë e më të pakta buxhetore, projekti "Identifikimi i Rrugëve Sistematike për t'iu Përgjigjur Krizës Globale të Ushqimit, Energjisë dhe Financave në Maqedoninë e Veriut" përgatiti një analizë të masave anti-krizë dhe rekomandoi mënyra dhe modalitete për t'i bërë këto masa dhe politikat më të gjera, më efektive dhe më efikase, duke përfshirë përmirësimin e synimit për nevojat e më të rrezikuara.

Për sa i përket partneritetit, përtej angazhimit të rregullt të agjencive të OKB-së me partnerët, u organizua rishikimi në mes të vitit i zbatimit të Planit të Përbashkët të Punës dhe i Punëtorive Vjetore për Planifikim me Palët e Interesuara, në të cilat morën pjesë agjencitë përkatëse të OKB-së, qeveria, OShC-të dhe partnerët ndërkombëtarë, për të reflektuar dhe planifikuar bashkërisht zbatimin e KBZhQ-së së OKB-së. Më tej, ekipi i OKB-së diskutoi qasjet dhe boshllëqet aktuale brenda secilit Grup të rezultateve si pjesë e monitorimit të rregullt të Strategjisë së Mobilizimit të Resurseve dhe Partneritetit të KBZhQ-së të OKB-së dhe prioritzoi angazhimin me sektorin privat si një fushë në të një qasje më e fokusuar nga OKB-ja do të shqyrtohet në vitin 2023.



Konferenca vjetore e OKB-se 2022 kushtuar "Identifikimi i mënyrave sistematike për t'iu përgjigjur krizës globale për ushqim, energji dhe financim në Maqedoninë e Veriut". Foto: Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të OKB -së

Koherenca, efektiviteti dhe efikasiteti i OKB-së

Në vitin 2022, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut – në partneritet të fortë me Qeverinë – vazhdoi zbatimim e reformës së sistemit të zhvillimit të OKB-së për të arritur koherencë, efektivitet dhe efikasitet më të madh të punës së saj në vend.

Viti i dytë i zbatimit të KBZhQ u karakterizua me konsolidimin e përpjekjeve kolektive dhe individuale të agjencive për t'i shndërruar parimet e reformës në praktikë – përmes planifikimit të përbashkët të koordinuar, futjes së mëtejshme në përdorim të mjeteve dhe udhëzimeve, me fokus të vazhdueshëm në rezultatet dhe realizimin efikas.

Harmonizimi dhe koherenca programore

KBZHQ-ja funksionalizohet çdo vit përmes një plani të përbashkët pune (PPP), i cili i përmbledh të gjitha aktivitetet e zhvillimit të OKB-së brenda një viti të caktuar, pas diskutimit dhe harmonizimit kolektiv përmes një procesi konsultativ brenda OKB-së dhe me partnerët kombëtarë..

PPP i vitit 2022 ishte plani i dytë vjetor i Maqedonisë së Veriut, i miratuar nga Komiteti i Përbashkët Drejtues i KBZhQ-së në mars të vitit 2022, pas konsultimeve me më shumë se 90 partnerë të OKB-së dhe të qeverisë dhe u shqyrtua gjatë konsultimeve të mesit të vitit në qershor dhe korrik. Aktivitetet prioritare, pikat e referimit dhe objektivat u përpiluan në një vend dhe shërbyen si mjet për rritjen e llogaridhënies së OKB-së ndaj të gjithë partnerëve, gjë që u theksua si një zhvillim i mirëpritur nga disa donatorë në nivel lokal. PPP-ja e vitit 2022 vazhdoi të promovojë veprimin kolektiv të OKB-së drejtë rezultateve dhe qëllimeve të përbashkëta ndër-institucionale, ku OKB-ja ka një rol si mundësues dhe ofrues i këshillave dhe ekspertizës për politikën.

Kombet e Bashkuara vazhduan me përpjekje të përkushtuara për të zhvilluar programe të përbashkëta të agjencive të shumta të OKB-së, për të mundësuar ofrimin e njohurive dhe ekspertizës gjithëpërfshirës të OKB-së për vendin për sa i përket sfidave komplekse dhe të shumëëllojshme. Në vitin 2022, OKB-ja kishte shtatë programe të përbashkëta në zbatim.

Transparenca dhe llogaridhënia

Procesi i PPP-së për vitin 2022 dhe rezultatet e tij vazhduan të promovojnë transparencën e punës së OKB-së, e cila është çelësi për reformën e sistemit të zhvillimit të OKB-së. Informacioni i detajuar – duke përfshirë financat – vazhdoi të ishte në dispozicion të të gjithë partnerëve gjatë fazës së planifikimit dhe zbatimit, duke përfshirë edhe përmes kanaleve publike. Kjo e çimento llogaridhënien si shtytësin kryesor për arritjen e rezultateve dhe vazhdoi të promovojë bashkëpunimin,

partneritetet, shkëmbimin e informacionit dhe shmangien e dyfishimit të veprimeve në programim.

Në tetor, për shembull, Koordinatorin i përhershëm i OKB-së organizoi një konferencë për shtetet anëtare të OKB-së dhe partnerët ndërkombëtarë mbi përparimin e sistemit të zhvillimit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut, i cili përfshinte një përmbledhje të produkteve të ndryshme të njohurive dhe informacionit të zhvilluara nga OKB-ja, si dhe aktivitetet e aktuale të programimit dhe të përfaqësimit. Për më tepër, u prezantuan ndryshimet dhe zhvillimet kryesore kontekstuale që shërbejnë si udhëzime për planet e përbashkëta të punës të OKB-së dhe si burim për hartimin e politikave kombëtare ([përditësimi i Analizës së Përbashkët të Vendit 2022](#)).

Informacioni për kornizën e financimit – element kyç për llogaridhënien dhe transparencën e OKB-së përmes ofrimit të një reference dhe pasqyre të vetme të situatës së financimit të KBZhQ-së dhe burimeve financiare të nevojshme, të disponueshme dhe të parashikuara, duke përfshirë shumën, burimin, kohëzgjatjen dhe sekuencën – vazhdoi të mbledhjet rregullisht dhe të përfshihej në Planet e përbashkëta të punës për vitin 2022. U bënë përpjekje të rëndësishme për të siguruar cilësinë e të dhënave financiare, kontrollin e kryqëzuar dhe vlefshmërinë brenda OKB-së dhe me të gjithë donatorët.

Në vitin 2022, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut gjithashtu vazhdoi me përdorimin e UN-INFO – Platformës qendrore të planifikimit, monitorimit dhe raportimit në internet të UNCT-së që i digjitalizon kornizat e rezultateve të përbashkëta, strategjitë dhe mjetet e tjera të koordinimit operacional –, dhe e promovon atë si mjet kryesor për të gjurmuar, mbështetur dhe ofruar "një pikë të përbashkët" për të gjitha informacionet mbi punën e OKB-së në vend, së bashku me faqen e internetit të përbashkët trigjuhësorë në vend (<https://northmacedonia.un.org>).

Foto: Foto nga takimi informues i shteteve anëtare të OKB-së në tetor. Titulli – "Përditësimi i organizuar në nivel lokal për shtetet anëtare të OKB-së (rezidentë dhe jo-rezidentë), kryetarët e organizatave bilaterale dhe multilaterale dhe institucionet financiare ndërkombëtare, mbi Progresin e sistemit të zhvillimit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut, 17 tetor 2022.

Qeverisja e përbashkët dhe koordinimi

Struktura e qeverisjes së KBZhQ-së siguron harmonizim strategjik dhe të përditshëm midis agjencive të OKB-së dhe të gjithë aktorëve të tjerë.

Komiteti i Përbashkët Drejtues (KPD) i nivelit të lartë i Qeverisë dhe i Kombeve të Bashkuara ofroi udhëzime strategjike dhe miratimin e Programit të Përbashkët të Punës (PPP) për vitin 2022, i cili u funksionalizua përmes ndërveprimit dhe koordinimit të rregullt dypalësh dhe shumëpalësh midis agjencive të OKB-së dhe ministrive partnere dhe institucioneve të tjera.



Katër Grupet e Rezultateve të KBZhQ-së, mekanizmi kryesor i koordinimit për të siguruar një qasje koherente të analizës, planifikimit, zbatimit dhe monitorimit në të gjithë sistemin e OKB-së në nivel të rezultatit, vazhduan punën e tyre dhe u takuan rregullisht – për angazhimin e brendshëm të OKB-së dhe për planifikimin e përbashkët që i përfshin homologët përkatës të qeverisë në nivelin e rezultateve.

Ekipi i OKB-së bë vend (UNCT) mbeti shtylla kurrizore për shtrirjen e OKB-së brenda vendit, i mbështetur nga Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) dhe Grupet e Rezultateve mbi mundësitë dhe sfidat programore; Grupi i Komunikimit dhe Grupi i Menaxhimit, Vlerësimit dhe Mësimimit mbi përfaqësimin dhe të dhënat; dhe grupe të shumta tematike të brendshme. Struktura e brendshme e racionalizuar dhe e rregulluar vazhdoi të rrisë koherencën dhe harmonizimin e punës së OKB-së përgjatë rezultateve dhe mandateve dhe zbatimin në nivel vendi të reformës së Sistemit të Zhvillimit të OKB-së, dhe mbështeti procese të tilla siç janë Strategjia Kombëtare për Zhvillim, konsultimet për Samitin e Transformimit të Arsimit dhe të tjera.

Roli i forcuar i Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së mbeti kyç për rritjen e rolit drejtues dhe për pozicionimin më të mirë për punën dhe ndikimin e përgjithshëm të punës së OKB-së në vend në vitin 2022. Kjo ka qenë e mundur vetëm për shkak të mbështetjes aktive për reformën e sistemit të zhvillimit të OKB-së nga qeveria, dhe të mbështetjes politike dhe burimeve të investuara globalisht nga donatorët që nga viti 2019, duke përfshirë përmes Fondit të Mirëbesimit të OKB-së për Qëllime të Veçanta që ofron fonde për përfundimin e Sistemit të Koordinatorit të Përhershëm.

Avokimi i përbashkët

Avokimi i përbashkët dhe aktivitetet e komunikimit me publikun për ta shtuar dukshmërinë e OKB-së dhe për ta sjellë punën e saj më pranë njerëzve, vazhduan të mbështeten në rrëfimin e aktivitetëve në faqen e përbashkëta të internetit brenda vendit (<https://northmacedonia.un.org>), në rrjetet sociale, Buletinin e Zhvillimit të Qëndrueshëm në internet, që shpërndahet rregullisht deri në më shumë se 2.500 abonentë.

Përveç fushatave të rregullta – 16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe fushatave rreth ditëve të ndryshme ndërkombëtare si Dita e të Drejtave të Njeriut dhe Dita Botërore e Mjedisit Jetësor – komunikimet u përforcuan ndjeshëm gjatë javës së OKB-së me një ngjarje të madhe në Shkup dhe për herë të parë me dy ngjarje jashtë Shkupit, një në Kavadar dhe një në Strugë. Ato përfshinin një garë për vizatim që kishte për qëllim t'i stimulojë fëmijët e vegjël dhe adoleshentët të mësojnë më shumë rreth OZHQ-ve dhe sfidave me të cilat po përballemi për të siguruar mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe për të minimizuar efektet e ndryshimeve klimatike. Mbi 200 fëmijë nga të gjitha anët e vendit dërguan vizatime, kurse më të suksesshmit u ftuan edhe në manifestimin kryesor të Ditës së Kombeve të Bashkuara në vitin 2022, që u mbajt në Shkup. Gjithashtu filloi iniciativa dhe fushata e re afatgjatë mbi mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike, si avokim i përbashkët me Delegacionin e BE-së.

Organizata e Kombeve të Bashkuara në Maqedoninë e Veriut ka bërë hapa të rëndësishme në përfundimin e pranisë dhe shtrirjes së saj në mediat sociale në vitin 2022, duke e rritur bazën e fansave në Facebook dhe Twitter për më shumë se 10% në nivel vjetor.

Një nga përfitimet kryesore të pranisë së OKB-së në Maqedoninë e Veriut në mediat sociale është aftësia e saj për t'u lidhur me të rinjtë, të cilët shpesh janë përdoruesit më aktivë të mediave sociale. Duke komunikuar me publikun në moshë të re, organizata mund të rrisë vetëdijen për çështje të rëndësishme dhe të frymëzojë një brez të ri avokuesish për zhvillim të qëndrueshëm, ndryshimet klimatike dhe të drejtat e njeriut.



Nga fushata e përbashkët, 16 ditë aktivizim kundër dhunës me bazë gjinore. Foto: OKB - Zyra e Koordinatorit të Përhershëm

Efikasiteti

Realizimi i Agjendës globale të Efikasitetit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut përqendrohet në zbatimin e Strategjisë së Operacioneve të Biznesit (BOS) 2.0, me të cilën vlerësohet se do të kursehen 1,3 milion dollarë amerikanë përmes eliminimit të shpenzimeve të transaksionit, kursimit të kohës së stafit dhe përfitimit nga ekonomitë e shkallës gjatë një periudhe pesëvjeçare.

Në vitin 2022, puna u përqendrua rreth përfundimit të Ekipeve të Menaxhimit të Operacioneve (OMT), i përfaqësuar plotësisht nga të gjitha agjencitë e OKB-së me prani operacionale në vend. Puna e tij përparoi me vlerësimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara në më shumë se 30 hapësira për ngjarje dhe hotele që shfrytëzohen nga OKB-ja anëmbanë Maqedonisë së Veriut, gjë që e ndihmon kontributin kolektiv të OKB-së në avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Kontribut gjithashtu u dha edhe për një mjedis më të shëndetshëm dhe më të gjelbër përmes identifikimit të mënyrave kolektive për hedhjen e sigurt të pajisjeve të TI-së të përdorura nga disa agjenci të OKB-së.

Megjithatë ndikimi i COVID-19 në modalitetet e punës u ul në vitin 2022, sigurimi i vazhdimësisë së punës dhe funksionimit pa ndërprerje, dhe njëkohësisht siguria dhe shëndeti i stafit të saj, mbetën prioritet kryesor. Organizimi fleksibël i punës dhe puna nga distanca vazhduan në raste të caktuara, të shoqëruara me kalimin gradual të kthimit në zyrë. Në fund të vitit 2022, fuqia punëtore rezidente e OKB-së në Maqedoninë e Veriut përbëhej nga një personel prej më shumë se 320 të punësuarish kombëtar dhe ndërkombëtar – 56% gra dhe 44% burra.

Vlerësimi dhe mësimet e nxjerra

Vlerësimi i PZhQ-së

Vlerësimi përfundimtar i pavarur i strategjisë që i parapriu KBZhQ-së, Partneriteti për Zhvillim të Qëndrueshëm (PZHQ) 2016-2020, u krye në fund të vitit 2019, me rezultate që vënë në pah zhvillimin e KBZhQ-së për periudhën 2021-2025.

Në raportin e vlerësimit të PZHQ-së janë renditur pesë fusha të rekomandimeve për OKB-në, për t'i përmirësuar rezultatet apo koordinimin e saj.

- ◊ Përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive
- ◊ Menaxhimi i të dhënave dhe hartimi dhe monitorimi i programeve;
- ◊ Qëndrueshmëria e ndërhyrjeve të ndërmarra;
- ◊ Qëndrueshmëria e financimit; dhe
- ◊ Përforcimi i rolit të Ekipit të OKB-së në vend (UNCT) në koordinim me partnerët e zhvillimit

Ekipi i OKB-së në vend i ka shqyrtuar plotësisht pesë grupet e rekomandimeve të vlerësimit. Sikurse edhe në vitet e mëparshme, vëzhgimet e tyre i mundësuan Koordinatorit të përhershëm të OKB-së dhe Ekipit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut një pasqyrë bazë për menaxhim e mëtejshëm të operacioneve gjatë vitit 2022. Deri në fund të vitit 2022, Ekipi i OKB-së në vend realizoi plotësisht mbi 70% të veprimeve, ndërsa pjesa tjetër mbeten të zbatueshme dhe vazhdojnë gjatë gjithë ciklit të KBZhQ-së.

Një vlerësim i kryer nga jashtë i ndërhyrjeve të mbështetura nga UNICEF-i që synonin të përmirësojnë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara arriti në përfundimin se ndërhyrjet kontribuan dukshëm në rritjen e disponueshmërisë dhe ofrimit të shërbimeve, si dhe të burimeve njerëzore

të kualifikuara, dhe ndihmuan ndjeshëm për të ndryshuar pozitivisht paradigmen dhe për të përmirësuar të kuptuarit e publikut për aftësinë e kufizuar.

Mësimet e nxjerra

Bashkëpunimi i ngushtë midis agjencive të OKB-së zakonisht shfaqet në ato fusha ku ekziston një agjendë e qartë reformash, e mbështetur nga një problem i identifikuar qartë dhe një angazhim i fortë për ndryshim nga qeveria. Kështu, pronësia kombëtare është një faktor i rëndësishëm që i jep formë ndërveprimit të agjencive të OKB-së në nivel të vendit.

Një mjet tjetër për punën e afërt, të efektshme dhe të përbashkët të OKB-së është mbështetja e marrë përmes burimeve të përbashkëta të financimit. Mjetet e grumbulluara dhe mundësitë e tjera të financimit që i mbështesin propozimet e përbashkëta të shumë agjencive mund të shërbejnë si një mjet bashkimi që mundëson përdorimin më të mirë të ekspertizës për tema të ndryshme të OKB-së për adresimin e sfidave komplekse ndërsektoriale.

Organizata e Kombeve të Bashkuara gjithashtu mund të bëhet me shpejtësi relevante dhe të japë një kontribut të madh në fushat ku më parë ka pasur angazhim minimal. Nëse ka një nevojë të qartë në një fushë të ekspertizës, kapacitetit dhe përvojës së OKB-së, është e mundur që agjencitë e OKB-së të bashkohen, të koordinohen në mënyrë efektive dhe efikase përmes bashkëpunimit të ngushtë me njëri-tjetrin.



Një nga vizatimet fituese të konkursit të OKB-së me temën ruajtja e mjedisit, në vigjile të Ditës së OKB-së

Financat dhe mobilizimi i burimeve

Pasqyra financiare

Në vitin 2022, 37,4 milionë dollarë u vunë në dispozicion të OKB-së për Maqedoninë e Veriut, nga të cilat 31,3 milionë dollarë u shpenzuan, duke rezultuar me shkallën e realizimit prej 84%. Duke parë rezultatet e KBZhQ-së, qeverisja e mirë (10,6 milionë dollarë të shpenzuar) dhe mjedisi jetësor i shëndetshëm (10,3 milionë dollarë) ishin më intensive në aspekt të burimeve, të ndjekura nga prosperiteti gjithëpërfshirës (5,3 milionë dollarë) dhe shërbimet cilësore për të gjithë (5,1 milionë dollarë).



OKB-ja mobilizoi me sukses 82% të burimeve të kërkuara (të buxhetuara) për vitin e dytë të KBZhQ-së, duke bërë të mundur zbatimin e papenguar. Mjetet për zbatimin e aktiviteteve të OKB-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 u pranuan nga

29 burime të financimit. Pjesa më e madhe e mjeteve në dispozicion u morën në formën e financimit të projekteve dhe programeve specifike (61%), të ndjekura nga financimi bazë (14%), financimi i qeverisë (11%), fondet globale vertikale (7%), fondet e bashkuara (4%) dhe fondet tematike (3%).

Dhjetë burimet kryesore të financimit jo-thelbësor/jo-tematik në bazë të shpenzimeve në vitin 2022 për punën e OKB-së në Maqedoninë e Veriut ishin Zvicra, Suedia, Maqedonia e Veriut, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar, Fondi Global i Mjedisit Jetësor, Fondi i Përshtatjes dhe Sllovakia.


Burimet e kërkuara dhe në dispozicion, dhe shpenzimet në vitin 2022

Të dhënat e 31 marsit të vitit 2023, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor të vitit 2022, në miliona dollarë amerikanë



Shpenzimet në vitin 2022 për agjenci të OKB-së

Të dhënat e 31 marsit të vitit 2023, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor të vitit 2022, në miliona dollarë amerikanë



Source: UN North Macedonia, 2023 available funding and expenditures are based on UN entities' financial systems or financial statements information as of 31 March 2022. UNHCR expenditures are estimates based on historic delivery rate as their expenditure reporting is consolidated only in April.

Mobilizimi i burimeve

Në fund të vitit 2021, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut e zhvilloi Strategjinë e Mobilizimit të Burimeve dhe Partneritetit (SMBP) të KBZhQ-së të KB-së, e cila i përvijon objektivat e Ekipit të OKB-së në mobilizimin e përbashkët të burimeve dhe partneriteteve dhe e përcakton fokusin e aktiviteteve dhe qasjet për të siguruar një qasje më koherente, më të efektshme dhe transparente. Për mobilizimin e burimeve, u përcaktuan katër objektiva sasiorë dhe dy qasje. Më poshtë është dhënë raportimi mbi progresin në arritjen e këtyre objektivave për KBZhQ-në për periudhën 2021 – 2025, deri në fundin e vitit të dytë.

OKB-ja në Maqedoninë e Veriut është kryesisht në rrugën e duhur në mobilizimin e mjeteve të nevojshme financiare për përmbushjen e rezultateve të planifikuara sipas KBZhQ-së 2021-2025 (Objektivi 1 i SMBP-së). Në fund të vitit 2022, 124,6 milionë dollarë ishin në dispozicion për aktivitete në periudhën pesëvjeçare, ose 70% e financimit të kërkuar prej 178 milionë dollarësh. Në nivel vjetor, 82% e resurseve të kërkuara për vitin 2022 janë mobilizuar dhe janë vënë në dispozicion, ndërsa 63% e burimeve të kërkuara për vitin 2023 janë mobilizuar para fillimit të vitit (llogaritur në bazë të synimit vjetor të përditësuar të burimeve të kërkuara në PPP-të për vitet 2022 dhe 2023). Për kohëzgjatjen pesëvjeçare të KBZhQ-së, mbetet për t'u mobilizuar një boshllëk i përgjithshëm i financimit prej 53,6 milionë ose 30% e financimit të përgjithshëm të kërkuar.

OPër sa i përket cilësisë së financimit/përzjerjes së financimit, shumica e mjeteve që janë marrë deri më tani janë në formën e burimeve jo-thelbësore (108,4 milionë dollarë, 87%). Në mesin e burimeve jo-thelbësore të financimit, shumica e kontributeve vijnë nga


financimi i projekteve dhe programeve specifike (54%), i ndjekur nga fondet qeveritare (14%), fondet e bashkuara (10%), fondet vertikale globale (6%), fondet tematike (3%) dhe fondet simbolike të sektorit privat (më pak se 1%). OKB-ja tashmë ka arritur ta rrisë bashkë-financimin e qeverisë dhe fondet e bashkuara dhe ato vertikale dhe ta zvogëlojë mbështetjen në financimin e projekteve dhe programeve të caktuara, duke rezultuar në një përzjerje të përmirësuar të financimit.

Në fund të vitit 2022, 10 burimet kryesore të financimit jo-thelbësor për periudhën 2021-2025 ishin Zvicra, Maqedonia e Veriut, Suedia, Bashkimi Evropian, Fondi i Përbashkët i OZhQ-së, Mbretëria e Bashkuar, Fondi Global i Mjedisit Jetësor, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Norvegjia dhe Fondi i Përshtatjes.

OKB-ja në Maqedoninë e Veriut vazhdoi punën e saj të përkushtuar në rritjen e programimit të përbashkët (me shumë agjenci) dhe është në përputhje me synimin vjetor të përcaktuar sipas Objektivit 3 të SMBP-së. Pesë ide të reja për programe të përbashkëta/iniciativa të përbashkëta u zhvilluan në vitin 2022 (dy koncepte që lidhen me sigurinë njerëzore, një koncept mbi sigurinë rrugore, krizën ushqimore-sociale-energjetike dhe një iniciativë e përbashkët mbi Studimin e Fizibilitetit për Ohrin) dhe katër u financuan me sukses/u siguruan burime (financimi i gjelbër, faza kryesore, programi rajonal i të rinjve, rugët sistematike për krizën ushqimore-sociale-energjetike, Studimi i Fizibilitetit për Ohrin, inovacionet për ripërdorimin e mbeturinave). Mjete të reja të rëndësishme financiare u mobilizuan në vitin 2022 për programe/iniciativa të përbashkëta në vlerë prej 9,35 milion dollarëve.


Fondet e mobilizuara për periudhën 2021-2025 sipas modalitetit të inancimit dhe burimit të inancimit

Të dhënat e datës 31 mars 2023, për 1 janar 2021 – 31 dhjetor 2025, në miliona dollarë amerikanë



2021 – 2025 fondet e mobilizuara sipas modalitetit të financimit dhe burimi i financimit

Të dhënat e datës 31 mars 2023, për 1 janar 2021 – 31 dhjetor 2025, në miliona dollarë amerikanë



*Source: UN North Macedonia 2023; available funding and expenditures are based on UN entities financial systems or financial statement information as of 31 March 2023

OKB-ja në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023

Në vitin 2023, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me qeverinë dhe shoqërinë e Maqedonisë së Veriut me qëllim të përsheptimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Këshillat dhe mbështetja e synuar dhe e fokusuar e ekspertëve, të bazuara në parimin që askush të mos lihet pas, do të mbeten pika kryesore të angazhimit.


Në këtë kontekst, OKB-ja do të punojë me partnerët për të krijuar NVM të qëndrueshme dhe konkurrense në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë edhe në sektorët e krijimtarisë dhe të kulturës. OKB-ja do të vazhdojë të bashkëveprojë me partnerët për të përmirësuar aftësitë për punësim të grupeve të cenushme, si p.sh. të rinjtë, njerëzit që e kanë të vështirë për t'u punësuar dhe njerëzit me aftësi të kufizuara me aftësi adekuate për punësim, shërbimet mbështetëse dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; dhe të ndihmojë institucionet për të përmirësuar cilësinë e vendeve të punës, duke i theksuar aspektet e shëndetit dhe sigurisë. Mjedisi afarist i përgjegjshëm në aspekt gjinor dhe politikave e zhvillimit bujqësor/rural, si dhe mbështetja për një kornizë rregullatore moderne dhe të harmonizuar me standardet dhe shërbimet sociale do të mbeten në thelbin e punës së OKB-së në aspekt të politikave, duke e vendosur bazën për zhvillimin digjital. Për të mbështetur një aktivitet konkurrues të ekonomisë rurale, OKB-ja do të vazhdojë të punojë në aspektet kritike të konsolidimit të tokës bujqësore dhe në përforsimin e menaxhimit të shëndetit të kafshëve, duke trajtuar edhe sigurinë ushqimore në kontekstin e krizës aktuale shumëdimensionale. Duke i trajtuar aspektet jo të favorshme demografike, OKB-ja gjithashtu do t'i mbështesë institucionet për të lehtësuar përfshirjen produktive të diasporës në zhvillimin e vendit.

Kombet e Bashkuara do të vazhdojnë të mbështesin reformat aktuale në shëndetësi, arsim dhe në mbrojtjen sociale që i adresojnë sfidat sistematike. Njësia e re analitike dhe e zhvillimit të politikave që do të krijohet në Ministrinë e Shëndetësisë me mbështetjen teknike dhe këshillimore të OKB-së, do të synojë të rrisë kapacitetet në adresimin e sfidave kryesore të sistemit shëndetësor. Do të rritet mbështetja për reformat arsimore për optimizimin e shkollave fillore dhe përmirësimin e sistemit të shpërndarjes së mjeteve buxhetore në arsimin fillor dhe të mesëm. Do të vazhdojë mbështetja për politikave dhe zhvillimin e shërbimeve për të përmirësuar mbrojtjen e kategorive më të rrezikuara, me fokus në parandalimin e të gjitha formave të dhunës, si dhe të personave me aftësi të kufizuara, emigrantëve dhe azilkërkuarve.

Është planifikuar të fillojnë një numër aktivitete të reja në fushën e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike, përfshirë programeve që vazhdojnë: dy programe për adresimin e ndotjes së ajrit në të gjithë vendin, me investime të rëndësishme në ngrohjen e gjelbër, transportin e gjelbër dhe efikasitetin e energjisë së ndërtesave publike; dhënie e kredive të gjelbra për NVM-të dhe amvisëritë përmes Instrumenti i Financim të Gjelbër; investime të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes në Radovich për bujqësi më rezistente ndaj klimës; një program i ri për zbatimin e KPK-së së rishikuar, si dhe aktivitete përgatitore për Planin Kombëtar të Përshtatjes; mbështetje gjithëpërfshirëse për rajonin e Liqenit të Prespës, Studim i Fizibilitetit për Planin Urbanistik të Bregut të Liqenit të Ohrit; dhe hartimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e Tokës. Do të vazhdojë puna për edukimin ekologjik, ruajtjen e burimeve natyrore dhe biodiversitetin, zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme dhe atyre elektronike.

Kombet e Bashkuara mbeten të përkushtuara për të mbështetur finalizimin e Strategjisë Kombëtare për zhvillim (SKZH) përmes debateve të hapura dhe gjithëpërfshirëse; si me ekspertë ashtu edhe me qytetarë; dhe të ndihmojnë në ndërtimin e institucioneve të forta, rezistente dhe

transparente me një vizion të qartë dhe të afta për të bërë një ndryshim transformues në afat të gjatë, por edhe në jetën e njerëzve, veçanërisht të njerëzve pa shtetësi. Disa muajt që i paraprijnë Pasqyrës së katërt Periodike Universale të vendit do të përdoren si një mundësi për angazhim dhe mbështetje më të madhe të vendit në përbushjen e angazhimeve të tij për të drejtat e njeriut. Në veçanti, OKB-ja është e përkushtuar të mbështesë Qeverinë për t'i dhënë fund problemit të njerëzve pa shtetësi deri në vitin 2024 dhe do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me institucionet kombëtare në gjetjen e zgjidhjeve sistematike për njerëzit pa dokumente dhe pa shtetësi që të kenë identitet ligjor dhe të gëzojnë një spektër të plotë të të drejtave.



Një nga vizatimet fituese të konkursit të OKB-së me temën ruajtja e mjedisit, në vigjile të Ditës së OKB-së

Shtojcat

[1] Partnerët në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022

Qeveria dhe agjencitë shtetërore

Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve
Gjykata Administrative
Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive
Agjencia për Rini dhe Sport
Komisioni kundër Diskriminimit
Byroja për Zhvillim Rajonal
Byroja për Zhvillim dhe Arsimit
Qendra për Punë Sociale
Qendrat për Zhvillim dhe Rajoneve Planifikuese
Qyteti i Shkupit
Qendra për Menaxhimin e Krizave
Drejtoria e Doganave
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
Kabineti i Zëvendëskryeministrit
përgjegjës për Çështjet Ekonomike
Kabineti i Zëvendëskryeministrit përgjegjës
për Integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik
Kabineti i Zëvendëskryeministrit përgjegjës
për Sistemin Politik dhe Qeverisjen e Mirë
Drejtoria e Shëndetësisë Elektronike
Agjencia e Punësimit
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
Fondi për Inovacion dhe Zhvillim të Teknologjisë
Fondi i Sigurimit Shëndetësor
Gjykata e Lartë Administrative
Enti për Vepimtarinë Sociale Grupi Ndërmnishtor i
Punës për Miratimin e Politikës së Migracionit
Gjyqësori
Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
Ministria e Kulturës
Ministria e Mbrojtjes
Ministria e Ekonomisë
Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e Financave
Ministria e Punëve të Jashtme
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
Ministri pa Portofol përgjegjës për Diasporën
Qendrat Komunale për Punë Sociale (QKPS)
Komunat
Banka Popullore
Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit
të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit dhe
Grupi Ndërinstitucional i Punës për Riintegrim
Komiteti Kombëtar për PEDH dhe LT
Trupi Koordinues Kombëtar për Zbatimin e KDPK-së
Agjencia Kombëtare për Nxjtitjen e Zhvillimit të Bujqësisë
Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
Parlamenti
Kabineti i Presidentit
Kabineti i Kryeministrit
Prokuroria Publike për Ndjekjen e Krimin
të Organizuar dhe Korrupsionit
Drejtoria e të Ardhurave Publike
Zyrat Rajonale të Punësimit
Sekretariati i Çështjeve Evropiane
Enti Shtetëror i Revizionit
Inspektorati Shtetëror i Punës
Enti Shtetëror i Statistikave
Gjykata Supreme

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për PEDH dhe LT
Institutet për Trajnim Profesional

Organizatet e shoqërisë civile

Delegati Kombëtar i të Rinjve në Asamblenë
e Përgjithshme të OKB-së
Akcija Zdruzenska
Shoqata e Punonjësve Financiarë (SHZF)
Shoqata e Punëtorëve Social
Lidhja e Edukatorëve Speciale
Bashkësia e Njësitë të Vetëqeverisjes Lokale
Shoqata për Hulumtime dhe Analiza - ZMAI
Fondacioni Ballkanik për Zhvillim të Qëndrueshëm
Qendra për Hulumtim dhe Hartim të Politikave
Dhomat e tregtisë
Zyra e Lidhjes së Vlerave Natyrore me Njerëzit
Këshilli për Parandalimin e Delikucencës
së të Miturve - SPPMD
Organizatet e punëdhënësve
Shoqatat e fermerëve
Projekti Opsione për Jetë të Shëndetshme Shkup
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
- Evropa Lindore dhe Azia Qendrore
IZBOR STRUMICE
Shoqata Ekologjike e Maqedonisë
ESSA Sinergji Shkup
Shoqata e Mjekëve të Maqedonisë
Shoqata e Gjinologëve dhe Obstetërve të Maqedonisë
Kryqi Kuq i Maqedonisë
Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë
Federata Kombëtare e Fermerëve
Qendra Kombëtare e Romëve
OJQ "SEGA" PRILEP
Avokat i Popullit
Hapni Dritaret
Organizatet e personave me aftësi të kufizuara
Organizatet e prodhuesve
Shoqatat profesionale
Sindikata e Punëtorëve të Shëndetësisë
Sindikatat
Forumi Arsimit Rinor

Komuniteti akademik

Shoqata për Hulumtim, Komunikim dhe Zhvillim
Fakulteti i Shkencave të Bujqësisë dhe Ushqimit
Fakulteti i Shkencave Komputerike dhe Inxhinierisë
Fakulteti Juridik "Justinianus Primus" (Justiniani i parë)
Fakulteti i Mjekësisë Veterinare - Shkup
Shoqata për Edukim Shëndetësor dhe Hulumtim
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë
Fakulteti i Mjekësisë, Shkup
Universiteti i Evropës Juglindore
Instituti i Bujqësisë
Klinika Universitare e Psikiatrisë
Klinika Universitare e Gjinologjisë dhe Obstetrikës
Universiteti "Goce Dellçev", Shtip
Universiteti i Sauthemptonit

Këshillat me shumë partnerë

Këshilli Ekonomik dhe Social i Maqedonisë së Veriut
Këshillat Lokalë Ekonomike dhe Sociale
të Maqedonisë së Veriut
Komisioni Kombëtar për UNESCO-n

Trupi Koordinues Kombëtar për Mbrojtjen e
Fëmijëve nga Abuzimi dhe Mospërfillja
Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore
Këshilli Kombëtar Trepalësh Social dhe Ekonomik
Këshilli Shtetëror për Parandalimin
e Delikucencës së Fëmijëve
Komisioni Kombëtar i UNESCO-s

Partnerët ndërkombëtarë

Ambasada e Austrisë (ADA)
Ambasada Britanike
Banka Qendrore Evropiane (CEB)
Zyra Konsullore e Republikës së Sllovakisë
Delegacioni i Bashkimit Evropian në
Maqedoninë e Veriut (DBE)
Iniciativa për Përgatitjen dhe Parandalimin e
Fatkeqësive për Evropën Juglindore (IPPF E.JL)
Ambasada e Francës
Ambasada e Suedisë (SIDA)
Ambasada e Zvicrës (SDC, SECO)
Ambasada e Republikës së Turqisë
Ambasada e Federatës Ruse
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
Banka Evropiane e Investimeve
Fondacioni Evropian i Trajnimit (FET)
Konsullata e Përgjithshme e Belgjikës
DCAF (Qendra e Gjenevës për Menaxhimin
e Sektorit të Sigurisë)
Ambasada e Gjermanisë
Ministria Federale Gjermane e Punës
dhe Çështjeve Sociale
Ministria Federale Gjermane e Shëndetësisë
Partneriteti Global për Ujin - Mesdheu
Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit GmbH (GIZ)
Qendra Ndërkombëtare për Migracionin
INTERPOL
Zhvillimi i Politikave (ICMPD)
Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e
Natyrës, Zyra Rajonale për Evropën Lindore
dhe Azinë Qendrore (IUCN – ECARO)
Fondacioni Ndërkombëtar i Klubit "Lions"
Iniciativa Rajonale për Migrimin, Azilin, Refugjatët (MARRI)
Ambasada e Holandës
Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale
të Evropës Juglindore (NALAS)
Misioni i OSBE-së në Shkup
Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë
Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)
Programi Pan-Evropian i Transportit, Shëndetësisë
dhe Mjedisit Jetësor (THE PEP)
Ambasada e Shteteve të Bashkuara (USAID)
Grupi i Ekspertëve të UNECE për Efikasitetin Energjetik

Sektori privat dhe të tjerët

Dhoma e Avokatëve
Konfederata e Biznesit e Maqedonisë
Dhoma e Ndërmjetësuesve
Diaspora
Dhoma e Mjekëve
Media
Entet e Mbrojtjes Parësore Shëndetësore
Komiteti për Amësi të Sigurt
Komisioni Kombëtar për Parandalimin dhe Zbulimin
e Hershëm të Kancerit në Qafën e Mitres
Kompani të ndryshme

[2] Programet e përbashkëta në vitin 2022

- **Planifikimi dhe diskursi i politikave të migracionit të bazuara në dëshmi në Maqedoninë e Veriut, financuar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë-Partnerë (MPTF) për Migracionin, zbatuar nga IOM, UNHCR dhe UNFPA, 1,5 milion dollarë, 30 muaj (tetor 2020 – tetor 2023)**
- **Shërbime shëndetësore të sigurta dhe inovative gjatë Covid-19, financuar nga Fondi për Përgjigjen dhe Rimëkëmbjen nga COVID-19, zbatuar nga UNFPA, OBSSH dhe UNICEF, 850.000 dollarë amerikanë, 14,5 muaj (janar 2021 – mars 2022)**
- **Nga Njohuritë dhe Angazhimi – deri te Fuqizimi dhe Pjesëmarrja (KEEP), financuar nga UN PRPD dhe realizuar nga UNDP, UNICEF dhe UNFPA, 400.000 dollarë, 36 muaj (shkurt 2021 – shkurt 2024)**
- **Instrumenti i Financimit të Gjelbër për të Luftuar Ndryshimet Klimatike dhe Ndotjen e Ajrit, financuar nga Fondi i Përbashkët i OZHQ-së, zbatuar nga UNDP, IOM dhe UNECE, 7,97 milionë dollarë amerikanë/financim i përgjithshëm prej 46 milionë dollarësh amerikanë (prill 2022 – mars 2026)**
- **Projekti Rinor Rajonal, i financuar nga Fondi i OKB-së për Ndërtimin e Paqes, zbatuar nga UNDP, UNFPA, UN Women dhe UNICEF, 4,5 milionë dollarë, nga të cilat 0,65 milionë dollarë amerikanë për aktivitetet në Maqedoninë e Veriut (maj 2022 – maj 2024)**
- **Bio-hek Bota ime, financuar nga "Green Shark Challenge", zbatuar nga UNDP dhe UNICEF, 0,25 milionë dollarë amerikanë, maj 2022 – maj 2023.**
- **Identifikimi i Rrugëve Sistematike për t'iu Përgjigjur Krizës Globale të Ushqimit, Energjisë dhe Financave në Maqedoninë e Veriut, financuar nga Fondi i Përbashkët i OZHQ-së, zbatuar nga UNDP, UNICEF dhe FAO, 0,25 milionë dollarë amerikanë, korrik 2022-shkurt 2023**

[3] Trendet e treguesve të rezultateve të KBZhQ-së

Treguesi i rezultatit	Kategoria	Vlerabazë	Viti bazë	Synimi kombëtar (2025)	Të realizuara (2021)	Të realizuara (2022)	Trendi
Prosperiteti gjithëpërfshirës							
Shkalla e punësimit (20-64)	Gjithsej (20-64 vjeç)	59.2	2019	63.1	59.44	61.8	↗
	Femra	48.4	2019	49.2	49.7	51.7	↗
	Meshkuj	69.8	2019	74.3	68.9	71.8	↗
	Gjithsej të rinj (15-29)	34.4	2019	34.9	32.63	34.4	↗
	Femra	28	2019	28.2	27.79	28.5	↗
	Meshkuj	40.4	2019	41.8	37.2	40.2	↗
Përqindja e punësimit informal në ekonominë e përgjithshme	Gjithsej	16.1	2019	14	12.93	12.3	↗
	Femra	13	2019	Nuk është vendosur	10.1	9.2	↗
	Meshkuj	18.1	2019	Nuk është vendosur	14.89	14.5	↗
	Gjithsej të rinj (15-24)	24.01	2019	Nuk është vendosur	16.53	17.8	↘
Përqindja e të rinjve që nuk janë as të punësuar, e as të përfshirë në arsim apo trajnim	15-29 vjeç	24.5	2019	22	24.26	22.8	↗
	Femra	28.3	2019	28.2	25.48	24.5	↗
	Meshkuj	20.9	2019	20	23.1	21.1	↘
	15-24 vjeç	18.1	2019	15.8	17.82	18	↘
	Femra	19.2	2019	19.1	16.83	18.4	↘
	Meshkuj	17.1	2019	16.9	18.75	17.6	↘
	25-29 vjeç	34.9	2019	33.3	34.7	31.6	↗
	Femra	43.1	2019	43	39.45	35.8	↗
Meshkuj	27.1	2019	25.6	30.19	27.6	↗	
Shkalla e rritjes vjetore të PBB-së reale për person të punësuar		-1.3	2019	2.7	1.54	2.4	↗
Indeksi global i konkurrencës 4.0	Renditja	82/141	2019	67	82	Nuk është publikuar	↔
	Pikët	57.3	2019	Nuk është vendosur	57.3	Nuk është publikuar	↔
Shkalla e varfërisë të të punësuarit	Gjithsej	8.8	2019	7	10	12.5	↘
	Femra	6	2019	Nuk është vendosur	nuk është e disponueshme	8.9	↘
	Meshkuj	10.6	2019	Nuk është vendosur	nuk është e disponueshme	15.1	↘
Shërbime cilësore për të gjithë							
Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muaj që ndjekin një program të edukimit në fëmijërinë e hershme (shkalla e pjesëmarrjes)	Gjithsej	39.8	2019	60	36 (2020)	41	↗
	Vajza	47.76	2019	60	nuk është e disponueshme	47	↘
	Djem	52.24	2019	60	nuk është e disponueshme	53	↗
Përqindja e fëmijëve dhe të rinjve në fund të arsimit të mesëm të ulët, që arrijnë të paktën nivelin minimal të aftësisë	Lexim	45	2018	55	Anketa e ardhshme në vitin 2022	Anketa është shtyrë	↔
	Matematikë	39	2018	49	Anketa e ardhshme në vitin 2022	Anketa është shtyrë	↔
Nevoja e vetë-raportuar e paplotësuar për kontroll dhe kujdes mjekësor, % e popullsisë në moshën 16 vjeç e më lart	Gjithsej	2.3	2018	2	2.5 (2019)	1.7 (2020)	↗
	Femra	2.6	2018	2.2	2.4	1.8	↗
	Meshkuj	2	2018	1.8	2.6	1.7	↗
Përqindja e popullsisë së synuar e mbuluar nga të gjitha vaksinat e përfshira në programin e tyre kombëtar	Mbulimi i të gjitha vaksinave	95	2018	>95	<90	<90	↗
	3 doza të DTP3	92.5	2018	95	80.9	83.9	↗
	Doza e dytë e MCV2	74.8	2018	95	80.4	89.2	↗
Probabiliteti i vdekjes nga sëmundjet kardiovaskulare (SKD), kanceri, diabeti, sëmundjet kronike të frymëmarrjes (SKF) midis moshës 30 dhe 70 vjeç		20.3	2016	18.5	22.73 (2019)	Nuk ka të dhëna	↔
Shkalla e prevalencës së kontraceptivëve modernë		14	2018	Studimi i ardhshëm në vitin 2023	20	Nuk ka të dhëna	↔
Shkalla e vdekshmërisë neonatale		3.8	2019	3.5	4.2	2.9(2021)	↗
Përqindja e amvisërive të mbuluara nga transfertat e parave të gatshme të mbrojtjes sociale		8	2019	14.5	30.9	44.4	↗

Treguesi i rezultatit	Kategoria	Vlerabazë	Viti bazë	Synimi kombëtar (2025)	Të realizuara (2021)	Të realizuara (2022)	Trendi
Indeksi i Zhvillimit Njerëzor	Pikët e indeksit	0.759	2019	0.78	0.774	0.770	↘
	Renditja	82/189	2019	Nuk është vendosur	82	78	↘
Përqindja e popullsisë që jeton nën nivelin kombëtar të varfërisë	Gjithsej	21.9	2018	15.5	21.6	21.8 (2020)	↘
	Femra	22	2018	16.8	22	21.0	↗
	Meshkuj	21.8	2018	14.2	21.1	21.9	↘
	0-17 vjeç	29.3	2018	Nuk është vendosur	27.8	30.3	↘
	Të rinj (15-24)	29.7	2018	Nuk është vendosur	27.4	28.6	↘
	Të rritur (16+)	20.6	2018	Nuk është vendosur	20.4	20.1	↗
	25+	19.2	2018	Nuk është vendosur	19.3	21.1	↘



Mjedis jetësor i shëndetshëm

Emetimet e gazrave serrë (Gg CO2-ek)		8,021	2016	6196	12,290* (2019)	Të dhëna dy herë në vit	↘
Përqindja e zonës së përgjithshme të mbrojtur, të përcaktuar nga shteti që është e mbrojtur		10.34	2019	15	13.47	13.9	↔
Nivelet mesatare vjetore të grimcave PM10 (µg/m3)		51.32	2019	<40	41.90	35.91	↗
INFORM Indeksi i Rrezikut (2020) (në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 është shumë i ulët dhe 10 është shumë i lartë)	pikë	2.6	2020	2	2.5	2.4	↗
	niveli i rrezikut	i ulët	2020	shumë i ulët	i ulët	i ulët	↔
Ekziston sistemi për menaxhimin e integruar të dëmtuesve		no system in place	2020	Sistemi ekziston dhe është plotësisht funksional	jo	jo	↔
Përdorimi mesatar i pesticideve për sipërfaqe të tokës bujqësore (kg/ha)		0.22	2017	Mesatarja e BE-së 3.14	0.3	0.3	↔
Shkalla e zbatimit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore (0-100)	pikë	33	2020	60	40	40	↔
	niveli	mesatar - i ulët	2020	mesatar-ilartë	mesatar-iulët	mesatar - i ulët	↔
Pjesa e energjisë së ripërtëritshme në shumën e përgjithshme bruto	konsumi i energjisë	18.18	2018	29	19.22 (2020)	17.29	↘
	konsumi i energjisë elektrike	24.84	2018	46	23.53 (2020)	21.53	↘



Qeverisja e mirë

Indeksi i sundimit të ligjit (në përgjithësi, në një shkallë nga 0 deri në 1)		0.53	2020	Nuk është vendosur	0.53	0.53	↔
Indeksi i barazisë gjinore		62	2019	65	next survey in 2022	64.5	↗
Niveli i krijimit të mekanizmit të përhershëm kombëtar të koordinimit të të drejtave të fëmijëve		i dobët	2020	i themeluar	i dobët	i dobët	↔
Vendi ka një sistem të vendosur për të ndjekur dhe për të bërë alokime të mjeteve publike për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave		no	2020	Po	Jo	Jo	↔
Treguesit e qeverisjes në mbarë botën	Mesatarja	49.72	2018	>60	52.92	52.36	↘
	Zëri dhe llogaridhënia				50.24	52.17	↗
	Stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës/terrorizmit				50.47	50	↘
	Efektiviteti i qeverisë				57.69	50	↘
	Cilësia rregullatore				68.75	66.35	↘
	Kontrolli i korrupsionit				52.4	52.4	↔
	Control of corruption				37.98	43.27	↗
Indeksi i buxhetit të hapur	Transparenca	41	2019	>=45	41	36	↘
Përqindja e statistikave zyrtare në përputhje me legjislacionin e BE-së		67	2019	95	67 (2019)	67	↔
Niveli i kënaqësisë së përgjithshme me shërbimet publike në nivel lokal (në shkallë nga 1 deri në 5)	Gjithsej	3.07	2020	3.5	2.97	3.2	↗
	Femra	3.12	2020	3.6	2.97	3.21	↗
	Meshkuj	3.02	2020	3.4	2.97	3.19	↗
	Urbane	3.09	2020	3.5	2.83	3.16	↗
	Rurale	3.05	2020	3.5	3.08	3.26	↗
Niveli i harmonizimit të sistemeve të mbrojtjes dhe migrimit të refugjatëve me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së	pjesërisht të harmonizuara		2020	plotësisht të harmonizuara	kryesisht të harmonizuara	kryesisht të harmonizuara	↗
Përqindja e popullsisë që beson se vendimarrja është gjithëpërfshirëse dhe e përgjegjshme		19.8	2020	25	19.3	24	↗

[4] Akronimet dhe shkurtesat

SOB	Strategjia e Operacioneve të Biznesit	LB	Ligji për Buxhetin
PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore	GR -	Grupi i Rezultateve të KBZhQ-së
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave	OPAK	Organizatat e personave me aftësi të kufizuara
BZK	Bujqësia e zgjuar klimatike	ZM	Zonat e mbrojtura
EGJS	Edukimi gjithëpërfshirës seksual	EMP	Ekipi i Menaxhimit të Programit të OKB-së
QPS	Qendrat e Punës Sociale	PZHQ	Partneriteti për Zhvillim Qëndrueshëm
DhF	Dhuna në familje	PAK	Person me aftësi të kufizuara
KRPNK	Kontributi i rishikuar i përcaktuar në nivel kombëtar	KR	Koordinatori i Përhershëm
KN 4	Komunikimi i katërt nacional për UNFCCC	ZKP	Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të KB-ve
NHF	Ndërhyrja në fëmijërinë e hershme	MRSP	Strategjia për Mobilizimin e Resurseve dhe Partneritet
KEP	Kujdesi efektiv perinatal	KBZhQ	Korniza e Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm
RPE	Rishikimi i performancës ekologjike	OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
AP	Agjencia e punësimit	UEJL	Universiteti i Evropës Juglindore
KES	Këshilli Ekonomik dhe Social	MSE	Mësimi social dhe emocional
BE	Bashkimi Evropian	ESHS	Enti Shtetëror i Statistikave
FKGj	Fondi i Klimës së Gjelbër	KB	Kombet e Bashkuara
GS	Gazrat serrë	EOKB	Ekipi i OKB-së në vend
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor	UNFCCC	Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
GREVIO	Grupi i ekspertëve për veprimin kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje	ATP	Arsimi dhe trajnimi profesional
HCFC-të	Hidroklorofluorkarbonet (ftohësit, substancat që e shpëtojnë ozonin)	DhG	Dhuna ndaj grave
HCH	Heksaklorocikloheksan (lindan)		
IZHI	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor		
HOREKA	Hotelet, restorantet dhe kafenetë		
HOTAM	Shoqata e Hoteleve, Restoranteve dhe Kafeneve		
SFSPH	Strategjia e Fuqisë Punëtore në Shëndetësi		
KNF	Klasifikimi ndërkombëtar i funksionimit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit		
IFMIS	Sistemi i Integruar i Informacionit për Menaxhimin e Financave Publike		
SNP	Standardet Ndërkombëtare të Punës		
JSC	Komiteti i Përbashkët Drejtues Qeveri- KBZhQKB		
MBPEU	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave		
PAM	Paketimi me atmosferë të modifikuar		
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale		
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës		
MMJPH	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor		
MRV	Monitorimi, Raportimi dhe Verifikimi		
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim		
NEET	Të rinj që nuk janë as të punësuar, e as të përfshirë në arsim apo trajnim		
SKP	Strategjia Kombëtare për Punësim		



UNITED NATIONS
NORTH MACEDONIA



northmacedonia.un.org

www.facebook.com/1un.mk

www.twitter.com/1UN_MK

Shtojcë – prezantim i detajuar i rezultateve të OKB-së për vitin 2022



REZULTATI 1

Prosperiteti gjithëpërfshirës



Deri në vitin 2025, standardi jetësor i të gjithë njerëzve në Maqedoninë e Veriut është përmirësuar përmes qasjes së barabartë në punë të denjë dhe punësimin produktiv të gjeneruar nga një ekosistem biznesi gjithëpërfshirës dhe inovativ



Интервенциите на УНДП во 2022 овозможиле создавање на 1,204 работни места со целосно или со скратено работно време преку разни мерки, вклучително и новите зелени мерки, од кои 68.5% се жени, 30.5% се млади до 29 години, 34.7% се Роми и 42 работни места се создадени за лица со попреченosti (3.5%). Извор: УНДП

Projektet e zbatuara nga **agjencitë e OKB-së** gjatë vitit 2022 po kontribuojnë drejtpërdrejtë në rritjen e mundësive për vende pune më gjithëpërfshirëse dhe mjedis ekonomik produktiv. Ato janë përpiluar me qëllim të përforsimit të ndërmarrjeve për të krijuar vende pune cilësore; mbështetjes së aftësive për të rritur aftësitë për punësim të grupeve të cenueshme; përmirësimit të kornizës politike dhe ligjore përmes rekomandimeve të politikave dhe ekspertizës teknike për shërbime publike të përmirësuara; adresimit të informaliteteve dhe përmirësimit të cilësisë së punësimit, si dhe përmirësimit të zhvillimit bujqësor dhe rural.

NDËRMARRJET E QËNDRUESHME TË KRIJUARA SI GJENERATORË TË PUNËSIMIT PËRMES PËRFORSIMIT TË ZINXHIRËVE TË VLERAVE DHE RITJES SË KAPACITETEVE PËR TË ADOPTUAR MODELE TË REJA TË BIZNESIT.

Në vitin 2022, UNDP-ja mbështeti gjithsej **671 biznese**, duke i bërë vendet e punës të qasshme për grupe të ndryshme të cenueshme. Prej tyre, 502 NVM janë mbështetur me shërbime të mentorimit dhe këshillimit të bizneseve përmes platformës së krijuar biz4all.mk. Në kuadër të Masës së vetëpunësimit, u

mbështetën romët dhe personat me aftësi të kufizuara për të krijuar 28 biznese të reja (5 romë dhe 23 persona me aftësi të kufizuara) duke i rritur aftësitë e tyre sipërmarrëse përmes trajnimit dhe mbështetjes mentoruese. Si rezultat i kësaj, ata arritën të fillojnë me sukses biznesin e tyre dhe të gjenerojnë 9 punësime shtesë. Për më tepër, UNDP-ja investoi në zhvillimin e politikave dhe masave konkrete për të mbështetur krijimin e vendeve të gjelbra të punës. Me programe konkrete të punësimit u mbështetën 9 kompani private për të bërë investime të gjelbra duke krijuar 34 vende pune të gjelbra. Përveç kësaj, 104 kompani private dhe 28 ofrues të rinj të shërbimeve (të kujdesit) morën mbështetje përmes programeve fleksibël për ATP dhe programeve të trajnimit të përshtatura me nevojat e tyre, kurse mbi 420 njerëz të papunë u trajnuan, duke krijuar vende pune për mbi 70% të tyre.

28 нови даватели на услуги

добија поддршка преку флексибилни програми за оспособување и обука

Ndërhyrjet e UNDP-së mundësuan krijimin e **1.204 vendeve të punës me orar të plotë dhe me orar të pjesshëm** (622 me orar të plotë dhe 582 vende pune me orar të pjesshëm) në vitin

2022 përmes masave të ndryshme, duke përfshirë masën e sapo prezantuar të gjelbër. Prej tyre, 68,5% ishin vende pune për gratë, 30,5% për të rinjtë deri në 29 vjeç, 34,7% për romët dhe 42 vende pune (3,5%) për personat me aftësi të kufizuara. Masa e ekonomisë së kujdesit, si një modul i ri i cili vazhdon të tërheqë interesin e hartuesve të politikave, u mundësoi 117 **personave të bëhen ofrues të licencuar të shërbimeve të kujdesit**, duke u mundësuar kryesisht grave të marrin njohje dhe punësim formal si ofrues të shërbimeve të kujdesit. Kjo masë u mundësua nga 28 OJQ në forma të ndryshme, duke filluar nga krijimi i subjekteve të reja e deri te krijimi i linjave të reja të shërbimit brenda shërbimeve ekzistuese. 582 vende të tjera pune me kohë të pjesshme janë krijuar përmes Programit të Punës në Komunitet për të mbështetur ofrimin e shërbimeve të ndryshme sociale në 52 komuna. Shikuar nga prizmi i grupeve të cënueshme, mentorimi i romëve dhe programi ACCEDER mundësuan krijimin e vendeve të punës me orar të plotë për 359 romë, nga të cilët 157 (43,7%) gra dhe 174 (48,5%) të rinj.

GRATË DHE PERSONAT E CENUESHËM/TË PËRJASHTUAR PËRFITOJNË NGAMJEDISI MBËSHTETËS PËRMES MASAVE TË PËRSHTATURA TË PUNËSIMIT DHE NJË SISTEM MË DINAMIK DHE GJITHËPËRFSHIRËS TË AFTËSIVE QË I PËRGJIGJET NEVOJAVE TË TREGUT TË PUNËS PËR TË GJITHË NJERËZIT

Ndërhyrjet e UNDP-së për përmirësimin e aftësive për punësim dhe për lehtësimin e punësimit të individëve më të rrezikuar dhanë rezultate të rëndësishme në vitin 2022. Këto përfshijnë 5.351 njerëz që përfituan nga shërbimet mbështetëse të aktivizimit dhe punësimit, nga të cilat 2.888 gra (54%), 3.717 të rinj (69,5%) nga të cilët 2.400 të rinj që nuk janë as të punësuar, e as të përfshirë në arsim apo trajnim (NEET), 2.379 romë (44,5%) dhe 152 persona me aftësi të kufizuara. Nga 2.379 romë të aktivizuar në tregun e punës, 2.019 romë të papunë përfituan nga aktivizimi i punësimit përmes qasjes holistike dhe individuale të menaxhimit të rasteve nga mentorët dhe këshilltarët e punësimit (duke përfshirë programin ACCEDER), 167 ishin romë të kthyer nga vendet e BE-së dhe 193 ishin të rinj NEET që përfituan nga shërbimet e aktivizimit të Garancisë për të Rinjtë (në terren).

5,351 лица поддржани

за активирање и вработување

Gjatë vitit 2022, përmes ATP-së dhe trajnimeve për lloje të tjera të aftësive, gjithsej 1.083 persona (70% gra, 31,3% të rinj) i avancuan aftësitë e tyre për punësim dhe i përmirësuan perspektivat e tyre për të gjetur punë. Gjithashtu, 231 persona që e kishin të vështirë të punësohen kanë avancuar aftësitë e tyre për punësim duke fituar njohuri dhe përvojë pune në ofrimin e shërbimeve sociale të bazuara në komunitet për 9.022 përdorues të fundit në 52 komuna (5.122 gra, 679 persona me aftësi të kufizuara).

318 të papunë të tjerë të angazhuar në sektorin e ekonomisë së kujdesit i përfunduan trajnimet e aftësimin profesional dhe 117 prej tyre u punësuan me orar të plotë në 28 ofrues të shërbimeve të kujdesit (OJQ) që sapo u krijuan. Aktivitetet për përfundimin e arsimit fillor vazhduan me 15 të mitur për të ndihmuar në integrimin e tyre më të shpejtë.

Trajnimi për Aftësitë e së Ardhmes (AA) u ndihmoi 147 personave (82 gra) për t'i rritur aftësitë e tyre dhe për të mbështetur transformimin digjital dhe tranzicionin e gjelbër

në tre sektorë kryesorë ekonomikë: ndërtim, energji të ripërtërishtme dhe tekstil.

20,185 регистрирани

во Гаранцијата за млади

Plani i Zbatimit të Garancisë për të Rinjtë (GR) për Maqedoninë e Veriut për periudhën 2022-2026, i mbështetur nga ILO/BE, bazohet në mësimet e nxjerra që nga viti 2018 dhe parimet e përcaktuara në Rekomandimin e Këshillit për një Urë Drejt Vendeve të Punës – Përforcimin e Garancisë për të Rinjtë (tetor 2020). Krahasuar me planet e mëparshme të zbatimit, në periudhën 2022-2026 theksi është vënë më shumë në: (i) përfshirjen e të rinjve të shkëputur mu në vendet ku ata jetojnë, (ii) përmirësimin e cilësisë së ofertave që ofrohen për të rinjtë që regjistrohen në sistemin e ofrimit të shërbimeve të GR-së; (iii) krijimin e partneriteteve më të gjera dhe më të mira me aktorë të tjerë qeveritarë dhe joqeveritarë, dhe (iv) ndërtimin e një sistemi më të fortë të ofrimit të shërbimeve. Në përgjithësi, në vitin 2022, **20.185 persona (10.316 gra) u regjistruan në Garancinë për të Rinjtë, nga të cilat 7.419 (3.595 gra) u punësuan** brenda 4 muajve nga regjistrimi. Shkalla e daljes së suksesshme nga Garancia për të Rinjtë (përqindja e pjesëmarrësve që e përfunduan me sukses Garancinë për të Rinjtë) në vitin 2022 ishte 43%.

UNDP-ja gjithashtu e mbështeti zbatimin e Garancisë për të Rinjtë përmes dy OJQ-ve rinore ombrellë (mbi 60 punëtorë të rinj në terren), të angazhuara për të mbështetur Qendrat e punësimit të AP-së në identifikimin dhe regjistrimin e të rinjve NEET. Me këtë mbështetje, mbi 5.000 të rinj të papunë dhe mbi 1.140 kompani private u informuan për skemën e Garancisë për të Rinjtë në AP. Si rezultat i kësaj, 2.400 të rinj NEET u regjistruan në bazën e të dhënave të AP-së (1.553 gra; 6 persona me aftësi të kufizuara; dhe 193 romë).

POLITIKA DHE MASA RREGULLATORE TË PËRMIRËSUARA DHE TË PËRGJEGJSHME NDAJ GJINISË QË NXISIN SIPËRMARRJEN DHE FINANCIMIN PËR RITJE GJITHËPËRFSHIRËSE DHE TË GJELBËR POLITIKA DHE MASA RREGULLATORE TË PËRMIRËSUARA DHE TË PËRGJEGJSHMENDA JGJINISË QË NXISIN SIPËRMARRJEN DHE FINANCIMIN PËR RITJE GJITHËPËRFSHIRËSE DHE TË GJELBËR

ILO e lehtësoi procesin trepalësh për hartimin e Ligjit të ri për Marrëdhëniet e Punës (LMP) të përfunduar në gjysmën e dytë të vitit 2022, duke përgatitur një propozim të konsoliduar të propozim-ligjit. Versioni draft i LMP-së hyri në fazën e dytë të procesit në dhjetor të vitit 2022, me ç'rast dëgjimi i parë publik nga seria e planifikuar e dëgjimeve publike u mbajt më 26 dhjetor. Tetë dëgjime të tjera publike, që synojnë të përmirësojnë draftin e tekstit dhe ta harmonizojnë atë me Standardet ndërkombëtare të punës, janë planifikuar për tremujorin e parë të vitit 2023.

ILO bëri analizë të harmonizimit të legjislacionit me Konventën për t'i dhënë fund dhunës dhe ngacmimeve ndaj grave dhe burrave në botën e punës, Nr. 190, e cila u vërtetua në takimin trepalësh në prill të vitit 2022. Për më tepër, Konventa e ILO-s për t'i dhënë fund dhunës dhe ngacmimeve ndaj grave dhe burrave në botën e punës, Nr. 190 hyri në procedurën parlamentare për ratifikim më 5 dhjetor 2022.

Në vitin 2022, FAO ndihmoi qeverinë për të filluar hartimin e Strategjisë së parë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore, me

theks të veçantë në përgjigjet adekuate përmes politikave afatmesme dhe afatgjata për bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore, të ushqyerit dhe zhvillimin rural. Në bashkëpunim të ngushtë me Rrjetin e Zhvillimit Rural të Maqedonisë së Veriut, përmes një procesi konsultativ dhe me pjesëmarrje, FAO dhe MBPEU-ja bënë mbledhjen e nevojshme të të dhënave kombëtare për sigurinë ushqimore dhe të ushqyerit, si dhe një analizë të hollësishme të politikave përkatëse kombëtare, që do të shërbejnë si bazë për të hartuar **Strategjinë e ardhshme të Sigurisë Ushqimore dhe të Ushqyerit**. Përveç kësaj, në vitin 2022 u realizua një hulumtim institucional për zhvillimin e një propozimi për krijimin e një mekanizmi kombëtar ndërinstitucional të dedikuar dhe të përhershëm për koordinim, si një organ kryesor shtetëror që do t'i përfshijë të gjitha ministritë dhe agjencitë kombëtare të interesit që të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen strategjike të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore dhe të ushqyerit, legjislacionit, politikave dhe programeve. Zbatimi i kësaj politike të re duhet të kontribuojë në përmirësimin e pavarësisë së vendit duke e rritur prodhimin dhe produktivitetin e qëndrueshëm bujqësor, duke e rritur shpërndarjen dhe duke e forcuar gatishmërinë e vendit për të reaguar në mënyrë efektive ndaj krizave të ardhshme që mund të ndikojnë në sigurinë ushqimore.

Përt të t'i dhënë shtytje ekonomisë rurale, FAO ndihmoi qeverinë për të ndryshuar Ligjin për Shitjen e Tokës Bujqësore në Pronësi Shtetërore, për ta bërë privatizimin e tokës bujqësore në pronësi shtetërore plotësisht funksional. Kjo përfshinte analizën e mjeteve ekzistuese për zgjidhjen e problemit me tokën e braktisur dhe zbatimin e saj, duke përfshirë praktikën e mira evropiane në përdorimin e mekanizmave të ndërmjetësimit për dhënie me qira të tokës bujqësore. Zbatimi i këtij ligji të ri, i cili është në pritje të miratimit nga qeveria, duhet të rezultojë në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të tokës bujqësore, duke e shndërruar tokën bujqësore të braktisur në prodhim dhe përdorim racional. Përdorimi racional i tokës bujqësore, si një burim i kufizuar natyror, është thelbësor për një sektor të vetë-qëndrueshëm të bujqësisë vendore që e nxit krijimin e vendeve të punës në zonat rurale dhe sigurinë ushqimore për popullin në Maqedoninë e Veriut.

Përveç kësaj, FAO gjithashtu ndihmoi MBPEU-në për të zhvilluar, testuar dhe vënë në funksion **Mjetin e Monitorimit dhe Analizës së Çmimeve të Ushqimit (MAÇU)** – një mjet i FAO-s i në internet për analizën dhe shpërndarjen e të dhënave globale të çmimeve, i përshtatur posaçërisht për Maqedoninë e Veriut (mjeti MAÇU i nivelit global u zhvillua fillimisht në vitin 2010, si pjesë e iniciativave të FAO-s për të adresuar çmimet e larta të ushqimit në nivel global). Versioni në nivel të vendit i mjetit të çmimeve është i lidhur me sistemet ekzistuese kombëtare të mbledhjes së të dhënave. Ai i mundëson qeverisë, vendimmarrësve dhe prodhuesve bujqësorë të monitorojnë dhe analizojnë me lehtësi, në kohë dhe në mënyrë të besueshme informacionet mbi çmimet vendore me shumicë dhe pakicë të produkteve bazë ushqimore, si dhe të monitorojnë çmimet e ushqimit në nivel ndërkombëtar, të cilat mund të ndikojnë negativisht në sigurinë kombëtare të ushqimit në kontekst të krizave.

Për të mbështetur AP-në në ndjekjen dhe zbatimin e tendencave të fundit në aktivizimin e punës së grupeve të rrezikuara me instrumente për zbatimin pa probleme të modelit të kontraktimit social, UNDP-ja asistoi në hartimin e "Ligjit të ri për Punësimin dhe Sigurimin në Rast të Papunësisë".

Në vitin 2022, UNDP-ka gjithashtu vazhdoi me aktivitetet e saj të mëparshme për përfshirjen e konceptit të mësimi të përjetshëm dhe kualifikimeve që kërkohen nga tregu në legjislacionin përkatës. **Në këtë kontekst, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) u mbështet për të hartuar një Dokument Koncept për transformimin e shkollave të**

mesme/profesionale në Qendra rajonale gjithpërfshirëse të përsosshmërisë (QRGJP). Koncepti, tani i miratuar nga MASH-i, bazohet në dizajnin universal të të mësuarit dhe synon të ndërtojë kapacitetet e profesionistëve të arsimit për të arritur rezultate të të nxëniet me nxënës të ndryshëm, ndërsa në të njëjtën kohë hap mundësi për aktivitetet të të nxëniet gjatë gjithë jetës të profesionistëve (mësimdhënësve) dhe nxënësve. Gjithashtu, përmes një serie të punëtorive dhe trajnimeve hyrëse, profesionistët nga MASH-it dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit e avancuan të kuptuarit dhe njohuritë e tyre mbi arsimin gjithpërfshirës. Përveç kësaj, 130 profesionistë nga tre Qendrat Rajonale të ATP-së (QRATP) në vend kanë ngritur vetëdijen e tyre për nevojën për të krijuar një mjedis gjithpërfshirës për llojet e ndryshme të nxënësve.

Me ndërhyrje konkrete në nivel të politikave në ekonominë e kujdesit, UNDP-ja mundësoi që **OJQ-të të bëhen ofrues të shërbimeve sociale për ofrimin e kujdesit në shtëpi dhe ofrimin të shërbimit kur ofruesit e shërbimeve janë në pushim** sipas protokolleve të përcaktuara. Kjo është në përputhje me masën për romët e kthyer, ku OJQ-të janë angazhuar që t'i identifikojnë dhe t'i përshtatin përfituesit e mundshëm. Ndërhyrjet mbështeten me Studimin mbi IMG që synon të identifikojë përfitimet dhe shkaqet që pengojnë aktivizimin e punës. UNDP-ja gjithashtu vazhdoi të mbështesë reformën sociale **duke zhvilluar rregullore për t'i udhëzuar dhe mbështetur Këshillat Rajonale për Mbrojtje Sociale për të përgatitur Plane rajonale**, të cilat e integrojnë shërbimin social, buxhetimin dhe punësimin e grupeve të cënueshme. Paralelisht, u miratua Protokollin për fëmijët në rrezik dhe u organizua transferimi i njohurive në mënyrë që OJQ-të lokale të mund të bëhen ofrues të mundshëm të shërbimeve.

UNDP-ja gjithashtu punoi për të përforcuar ekonominë e gjelbër duke mbështetur futjen e masave të tranzicionit të gjelbër për kompanitë në OPE-n e qeverisë për vitin 2022 me vlerë prej 333.000 dollarëve amerikanë.

OKB-ja gjithashtu mbështeti procesin e digjitalizimit, përmes bashkë-krijimit të një **Profilin Digjital të Inovacionit** si bazë për Strategjinë e TIK-ut 2023-2027, të ndërmarrë nga ITU. Për më tepër, UNDP-ja zhvilloi produkte specifike, të tilla si **mjeti digjital HANA**, i cili siguron qasje në të dhënat e shkruara në gjuhën shqipe për personat e verbër, si dhe një aplikacion celular për përputhjen e aftësive të të rinjve për të lehtësuar më tej përparimin në karrierën e tyre.

Me mbështetje të ITU-s, u krye **Vlerësimi Kombëtar i Aftësive Digjitale** për Maqedoninë e Veriut nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Vlerësimi kishte për qëllim të kuptojë kërkesën dhe ofertën aktuale të aftësive digjitale në Maqedoninë e Veriut dhe të kontribuojë në zhvillimin e strategjisë për aftësitë digjitale e cila do t'i përmbushë nevojat e qytetarëve, dhe do të kontribuojë për rritjen e mëtutjeshme të ekonomisë digjitale dhe të shoqërisë digjitale. Rezultatet e vlerësimit janë dhënë në një formë të përmbledhur të rekomandimeve të qarta dhe të zbatueshme. Diapazoni i tyre përfshin një vlerësim të aftësive themelore digjitale në sektorin privat, kompanitë fillestare (start-up) dhe në sektorin e arsimit, si dhe një vlerësim të kërkesës aktuale për të gjithë nivelet e aftësive digjitale në të gjithë ekonominë. Rekomandimet kanë ofruar udhëzim strategjik për **Strategjinë Kombëtare të TIK-ut 2023-2027**, të zhvilluar në vitin 2022 me mbështetjen e OKB-së.

Në fund, duke e njohur sfidën e migracionit, IOM-i u ndihmoi institucioneve për të përfshirë diasporën në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Më shumë se 20 aktorë institucionale me kompetenca në çështjet e lidhura me diasporën, nga Kabineti i Ministrit pa Portofol Përgjegjës për Çështjet e Diasporës, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencia e Emigracionit, Ministria e

Shëndetësisë, Banka Popullore, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Agjencia për Investime të Huaja, Diaspora e Bashkuar Maqedonase dhe anëtarët e Grupit Ndërmintor të Punës për Politikën e Migracionit u aftësuan në zhvillimin dhe realizimin e projekteve për përfshirjen e diasporës për të mbështetur zhvillimin socio-ekonomik të Maqedonisë së Veriut, në përputhje me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut për Bashkëpunim me Diasporën 2019-2023 dhe Rezolutën për Politikën e Migracionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2025.

PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË PUNËSIMIT PËRMES MASAVE PËR KALIMIN NË FORMALITET DHE MBROJTJES ADEKUATE NË PUNË NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NËRËKOMBËTARE TË PUNËS

ILO e përforcoi mbikëqyrjen e tregut të punës duke trajnuar **106 inspektorë shtetëror të punës** mbi Ligjin e Marrëdhëniesve të Punës në një seri prej katër punëtorish; me zhvillimin e një **platforme mësimore me modul për mësim elektronik** për inspektorët e punës, si dhe një **faqe të re interneti të Inspektoratit Shtetëror të Punës** me aplikacione digjitale për punëdhënësit dhe punëtorët dhe **pajisje të reja të TI-së dhe për matje**.

Ajo gjithashtu realizoi një masë pilot në bashkëpunim me Shoqatën e Hotelierëve - Shoqata e Hoteleve, Restoranteve, Kafeterive dhe Kampeve - HOTAM. **Masa pilot – Ta Bëjmë Punën e Deklaruar tek Autoritet Tërheqëse për Punëdhënësit dhe Punonjësit (MDWA)** ofroi dëshmi se thjeshtimi i procedurave të punësimit dhe kontributet më të ulëta për sigurimin social të punëtorëve që janë të angazhuar përkohësisht dhe herë pas here, ndikon në re

duktimin e punësimit dhe punës joformale. Faqja e internetit e HOATM-it ishte platforma hyrëse për pjesëmarrjen e punëdhënësve dhe punëtorëve të interesuar për masën pilot që u zbatua në Ohër dhe Strugë. Vlerësimi i masës dhe mësimet e nxjerra janë duke u bërë.

ILO gjithashtu finalizoi **analizën krahasuese (të boshllëqeve) të Konventës nr. 167 për sigurinë dhe shëndetin** në ndërtim, Konventës nr. 176 për sigurinë dhe shëndetin në miniera, Konventës nr. 184 për sigurinë dhe shëndetin në bujqësi dhe të legjisllacionit kombëtar, të ligjeve të përgjithshme dhe ligjeve të veçanta për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve të ndërtimit dhe të gjitha akteve ligjore shtesë në fushën përkatëse. Të tre analizat e boshllëqeve në konventat e SSHP të ILO u vërtetuan dhe u organizua Dita e SSHP 2022 në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të SSHP.

POLITIKAT DHE KAPACITETET E PËRFORCUARA PËR EKONOMI RURALE TË QËNDRUESHME DHE KONKURRUESE TË HARMONIZUARA ME BE-NË, ME FOKUS NË FERMAT E VOGLA DHE GRATË FERMERE

Gjatë vitit 2022, FAO me mbështetjen e BE-së, ka vazhduar me sukses mbështetjen për zbatimin e **Programit Kombëtar të Konsolidimit të Tokës** përmes realizimit të njëkohshëm të dhjetë projekteve të konsolidimit të tokës në terren. Ky proces përfshinte përgatitjen dhe miratimin e planeve për rishpërndarjen dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore që përfshin 3.102 hektarë tokë bujqësore, në pronësi të 2.954 pronarëve të tokave bujqësore (663 gra). Si rezultat i kësaj, numri i parcelave të tokës është zvogëluar për pothuajse 2,5 herë, nga 8.237 në 3.344 parcela, ndërsa madhësia mesatare e parcelave të tokës është trefishuar (nga 0,42 ha në 1,34 ha) në zonat ku është finalizuar konsolidimi i tokës. Strukturat e

përmirësuar të tokës duhet të përmirësojnë potencialin e fermerëve për të rritur prodhimin bujqësor dhe për të kaluar në bujqësinë konkurruese, moderne dhe më rezistente ndaj

3,102 хектари

во процес на консолидација на земјиште

klimes.

FAO e mbështeti Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) për të realizuar hapat përgatitorë për përmirësimin e **Sistemit Kombëtar të Informacionit për Kafshët (SNIK)** në përputhje me standardet e BE-së në fushën e shëndetit të kafshëve dhe sigurisë ushqimore. Kjo përfshinte një vlerësim gjithëpërfshirës të sistemeve të AUV, gjë që çoi në një specifikim teknik për një sistem të përshtatur të SNIK, i bazuar në sistemin e zhvilluar nga FAO në Gjeorgji. Specifikimi përfshinte një udhërrëfyes për zbatim dhe propozimin e projektit për fazën e zbatimit të sistemit.


UN Women e mbështeti Fakultetin e Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit (FSHBU) për të ofruar mbështetje hulumtuese dhe teknike për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU), për integrimin e aspektit gjinor në politikat kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Ministria, në bashkëpunim me FSHBU-në dhe Grupin e Punës për Barazinë Gjinore, rishikoi kriteret dhe dyfishoi shpërndarjen e buxhetit për masën specifike gjinore (Masa 115) për mbështetjen e grave prodhuese të produkteve bujqësore, duke e bërë këtë masë t'u përgjigjet më shumë nevojave të tyre. Kjo siguroi që Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të jetë më i përgjegjshëm në aspekt gjinor duke e rritur mbështetjen financiare nga 3.000 euro në 6.000 euro. Si rezultat i kësaj, **70 gra fermerë përfituan nga rritja e subvencioneve financiare**, të cilat synojnë të ndikojnë drejtpërdrejt në jetesën e tyre dhe ta zvogëlojnë cenueshmërinë e prodhuesve të vegjël bujqësorë.

REZULTATI 2

Shërbime cilësore për të gjithë



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut kanë qasje universale në shërbime sociale cilësore të bazuara në të drejta – qasje në kujdes shëndetësor, arsim dhe mbrojtjen e nevojshme sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve - të rrënjosura në sisteme rezistente ndaj situatave emergjente



Пандемијата ковид-19 го оптовари здравствениот систем на многу непредвидливи начини и предизвика прекин на многу основни здравствени услуги, вклучително и тие за менталното здравје. СЗО ги поддржува напорите на Министерството за здравство за да се подобрат услугите за ментално здравје во рамки на заедниците. Извор СЗО

SISTEMI SHËNDETËSOR ËSHTË PËRFORCUAR PËR TË SIGURUAR QASJE UNIVERSALE NË SHËRBIME TË PËRBALLUESHME ME CILËSI TË LARTË DHE TË PËRQENDRUARA TE NJERËZIT, PËR TË PROMOVUAR MËNYRË TË SHËNDETSHME TË JETESËS DHE PËR TË ADRESUAR NEVOJAT SHËNDETËSORE SPECIFIKE TË POPULLSISË DHE FAKTORËT E RREZIKUT, DUKE I PËRFSHIRË SITUATAT EMERGJENTE.

Në vitin 2022, Ministria e Shëndetësisë së bashku me OKB-në dhe me mbështetjen e partnerëve të tjerë vazhduan me zbatimin e reformës së sistemit shëndetësor duke u bazuar në parimet e të drejtave të njeriut dhe të barazisë. Puna u fokusua në përmirësimin e mbrojtjes parësore shëndetësore, shëndetit të nënës dhe fëmijës dhe shëndetit mendor, si dhe të shëndetit seksual dhe riprodhues, duke filluar aktivitetet për zhvillimin e burimeve të reja njerëzore për zbatimin e strategjisë shëndetësore, trajtimin e faktorëve të rrezikut të sëmundjeve jo të transmetueshme, sjelljen e shërbimeve më afër njerëzve dhe përgatitjen e sistemit shëndetësor për imunizime në shkallë të gjerë. Katër agjenci të OKB-së ishin aktive në këtë fushë gjatë vitit 2022 – WHO, UNICEF, UNFPA dhe UNHCR.

Për të përshpejtuar zbatimin e Reformës Kombëtare të Mbrojtjes Parësore Shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë, dhe Fondi për Sigurim Shëndetësor, me mbështetjen e OBSH-

së, bënë një vlerësim të kontekstit kombëtar ligjor. Vlerësimi i identifikoi ndryshimet e nevojshme në kornizën ligjore dhe rregullatore për të mundësuar zbatimin e reformës në fushën e vazhdimësisë të kujdesit, koordinimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve, dhe matjes të performancës. Paralelisht, gjatë vitit 2022, me mbështetjen e OBSH-së u përfunduan edhe disa aktivitete të tjera që synojnë të kontribuojnë në përshpejtimin e reformës. E para prej tyre – analiza sistematike e proceseve administrative, e cila u kërkua nga autoritetet shëndetësore për mjekët e mbrojtjes parësore shëndetësore, identifikoi vështirësitë specifike dhe mundësitë për të rritur efikasitetin e administratës së MPSH-së. Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria për e-Shëndetësi u përfunduan dizajnimin e sistemit për caktimin elektronik të termineve për mbrojtjen parësore shëndetësore. Pasi të implementohet në vitin 2023, sistemi do t'u mundësojë pacientëve të sëmurë të shmangin pritjet e gjata në qendrat e tyre shëndetësore, pa imponuar ngarkesa administrative shtesë për punonjësit e MPSH-së, por edhe për të përmirësuar përvojën dhe kënaqësinë, si të pacientëve ashtu edhe të profesionistëve. Pastaj, u zhvilluan protokollet klinike dhe shtigjet për sëmundjet prioritare jo të transmetueshme (hipertensioni, diabeti, astma, hipotiroidizmi). Këto protokolle sigurojnë futjen e standardeve minimale të cilësisë së kujdesit që ofrohet në të gjitha praktikët e MPSH-së dhe vendosin bazën për monitorimin e cilësisë dhe futjen e intervenimeve të bazuara në dëshmi në praktikët ditore. Me mbështetjen e OBSH-së, Instituti kombëtar i Shëndetit Publik e miratoi

Planin e Zhvillimit (2023-2027) për **zvogëlimin e konsumit të kripës përmes dietës**, si një masë e rëndësishme me kosto efektive për përmirësimin e rezultateve shëndetësore të popullsisë. Plani i veprimit do të paraqesë një udhëzues për vendin që të arrijë synimet e dakorduara globalisht për të zvogëluar konsumin e kripës për 30% deri në vitin 2025, si pjesë e veprimit global për të zvogëluar barrën e sëmundjeve jo të transmetueshme (SJT) në pajtimin me Synimin 3.4 të OZHQ-së për zvogëlimin e vdekshmërisë nga sëmundjet jo të transmetueshme për një të tretën.

Vlerësimi i parë gjithëpërfshirës i strukturës dhe proceseve të planifikimit të fuqisë punëtore shëndetësore në vend, i zhvilluar me mbështetjen e OBSH-së, i hodhi themelet drejt zhvillimit të Strategjisë së parë të Fuqisë Punëtore Shëndetësore. **Platforma online e trajnimit www.obuki.zdravstvo.gov.mk** u ridizajnuar dhe u pasurua me funksionalitete të reja për të ofruar mundësi më të mira të të mësuarit për profesionistët shëndetësorë dhe qasje të lehtë në trajnimet elektronike të sapo krijuara dhe të përshtatura, si dhe për monitorim të lehtë të numrit dhe profileve të punonjësve shëndetësorë që i ndjekin trajnimet. Kjo platformë tani është në dispozicion në tri gjuhë: maqedonisht, shqip dhe anglisht.

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Klinikën Universitare të Psikiatrisë dhe Qendrën për Mjekësi Familjare, me mbështetjen e OBSH-së, pilotuan **Programin e Veprimit për Boshllëkun në Shëndetin Mendor (Mh-GAP)** në rajonet e Gjevgjeliës dhe Koçanit. Si pjesë e programit, rreth 100 praktikues të mbrojtjes parësore shëndetësore u aftësuan për t'i përmirësuar shërbimet për qytetarët e këtyre rajoneve në përballimin e problemeve të lidhura me shëndetin mendor, duke përfshirë terapinë e duhur dhe referimin. Përveç kësaj, u krye një **vlerësim i Qendrave të Shëndetit Mendor me Bazë në Komunitet (QShMBK)** në të gjithë vendin, në bashkëpunim me Klinikën Universitare për Psikiatri. Vlerësimi vuri në dukje sfidat dhe nevojat me të cilat përballen QShMBK-të dhe shërbeu si bazë për zhvillimin e një Plani të Veprimit për Kujdesin Shëndetësor Mendor me Bazë në Komunitet. Paralelisht, UNICEF-i luajti një rol kyç në **gjenerimin** për herë të parë të **të dhënave kritike për shëndetin mendor** përmes studimit mbi shëndetin mendor të adoleshentëve dhe familjeve të tyre, dhe studimit mbi shëndetin mendor të grave në periudhën perinatale. Të dy studimet vërtetuan supozimet fillestare në lidhje me tendencat shqetësuese dhe siguruan prova të forta që ofruan informacion për sistemet kombëtare për përmasat e problemeve dhe nevojën urgjente për investime shtesë në shëndetin mendor.

Megjithëse shëndeti mendor ka qenë pasoja më kritike nga pandemia e KOVID-19, kjo nuk ishte e vetmja. Duke shfrytëzuar momentin, mbështetja dhe asistencë teknike e UNICEF-it jo vetëm që lehtësoi përgjigjen ndaj nevojave urgjente, por gjithashtu mbështeti reformën e sistemit shëndetësor. Kjo u arrit përmes gjenerimit të provave kritike për shëndetin mendor, ushqimin e fëmijëve, efektivitetin e sistemit të vizitave në shtëpi, shërbimet e NfH-së; zhvillimin e zgjidhjeve digjitale dhe modelimin e shërbimeve të telemjekësisë, zhvillimin e kapaciteteve dhe asistencën teknike në zhvillimin e udhëzimeve dhe protokolleve kombëtare për masat për KOVID-19. Dëshmitë e gjeneruara përmes 'Analizës funksionale të shërbimeve të patronazhit (vizitave në shtëpi)' të mbështetur nga UNICEF-i, siguruan informacion për sistemin kombëtar për boshllëqet më kritike të këtyre shërbimeve, siç është mungesa e stafit dhe mungesa e mbikëqyrjes mbështetëse. Dëshmitë e gjeneruara paraqesin informator kryesor për rishikimin e politikave dhe udhëzimeve për këto forca kritike të punës për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë të porsalindur. **Analiza e situatës së Ndërhyrjeve në Fëmijëri të Hershme (NFH)** jo vetëm që siguroi të dhënat më të përditësuara rreth sistemit, por mundësoi të zbulohet një boshllëk i ri për sa i përket barazisë në qasjen në shërbimet e ndërhyrjes së hershme, duke e

dëshmuar pabarazinë e qartë në aspekt të të ardhurave në qasjen në shërbimet e NFH-së. Sistemi i mbrojtjes parësore shëndetësore u përforcua përmes zhvillimit të kapaciteteve të 190 punonjësve të mbrojtjes shëndetësore për telemjekësi, duke përfshirë monitorimin në distancë të pacientëve për të mundësuar ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjet në rastet kur prania fizike nuk është e mundur. Softueri digjital i zhvilluar për krijimin e një rrjeti profesional të komunikimit që mundësin konsultimin e profesionistëve shëndetësorë në nivelin parësor, dytësor dhe terciar, duke i kursyer pacientët nga shpenzimet financiare për shkak të udhëtimeve dhe duke i shmangur turmat në dhomat e pritjes nëpër spitale. Versioni pilot është vënë në praktikë nga 5 mjekë amë dhe 5 specialistë dhe aktualisht është duke u përdorur. **Protokollet për trajtimin dhe kujdesin ndaj KOVID-19** në nivelin e mbrojtjes parësore shëndetësore (për fëmijët, gratë shtatzëna dhe popullatën e përgjithshme) janë finalizuar, publikuar dhe përdoren nga punonjësit shëndetësorë në vend.

Duke u mbështetur në rezultatet e vitit 2021, UNFPA-ja trajnoi edhe 175 punonjës të tjerë shëndetësorë nga 6 objekte/spitale kryesore për kujdesin efikas perinatal (KEP), duke kontribuar kështu në **përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për nënat dhe të porsalindurit**, përforcimin e njohurive dhe aftësive në KEP, dhe përmirësimin e shëndetit të nënave dhe të të porsalindurve. Klinikat e lëvizshme gjinekologjike, të krijuara me mbështetjen e UNFPA-së në vitin 2021, fokusi i të cilave është në **parandalimin e kancerit të qafës së mitrës**, u integruan pjesërisht në buxhetin kombëtar të shëndetësisë, në kuadër të programit për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të qafës së mitrës duke i rritur mjete e alokuara në buxhetin nga viti në vit. Paralelisht u zhvilluan **dy fushata në shkallë të gjerë për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës** me përfshirje të rreth 400.000 personave në mediat sociale dhe përafërsisht 1.8 milionë personave përmes mediave televizive kombëtare. Gjatë vitit 2022, **2.000 gra dhe vajza kanë marrë shërbime të ShSR-së përmes klinikave të lëvizshme**. Në bashkëpunim me OShC-në HOPS, këto shërbime janë mundësuar edhe për **gratë dhe vajzat në burgje, punëtorët e seksit dhe përdoruesit e drogës**. Këto klinika janë plotësisht të integruara në sistemin kombëtar shëndetësor, duke mundësuar menaxhimin përkatës të të dhënave dhe mbrojtjen e privatësisë, si dhe shërbime të thjeshta të referimit dhe të ndjekjes.

Nisma për futjen e **shkollave për promovimin e shëndetit (ShPSh)** po përparon mirë në vitin 2022. Me mbështetjen e OBSH-së, pikat e kontaktit për shëndetin në shkollë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Instituti i Shëndetit Publik, mësimdhënësit dhe stafit tjetër shkollor dhe partnerët zbatues, u sensibilizuan për këtë program dhe u arrit konsensus kombëtar për të realizuar programin në katër shkolla për adoptim të hershëm. U përforcuan kapacitetet e mësimdhënësve dhe të personelit tjetër shkollor në shkollat që bënë adoptim të hershëm të programit dhe u krye analiza e situatës për të identifikuar sfidat kryesore të shëndetit dhe të mirëqenies të fëmijët e moshës shkollare. U hartua edhe plani i zbatimit për futjen e programit ShPSh, kështu që programi është gati për t'u zbatuar gjatë vitit të ardhshëm shkollor.

Me mbështetjen e **OKB-së**, Ministria e Shëndetësisë, Fakulteti i Mjekësisë dhe Spitali i Specializuar për Kujdesin Geriatrik dhe Paliativ, hartuan një plan për veprim për transformimin e Spitalit të Specializuar të Kujdesit Geriatrik dhe Paliativ në një qendër mësimore për nën-specializimin e ri të sapo hartuar geriatrik dhe zhvilluan një udhërrëfyes për zhvillimin e fuqisë punëtore. Këto dy plane kontribuojnë në përpjekjet e MSH-së për të përgatitur fuqinë punëtore shëndetësore për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të numrit gjithnjë e më të madh të njerëzve të moshuar dhe nevojave të ndryshuara për kujdesin shëndetësor dhe social.

Vlerësimi i pengesave për shërbimet shëndetësore në zonat

rurale dhe të largëta dhe në vendbanimet e vogla urbane i përgatitur me mbështetjen e OBSH-së ka kontribuar në identifikimin e pengesave për sa i përket ofertës dhe kërkesës për shërbimet shëndetësore në vendbanimet e vogla urbane dhe në zonat rurale dhe të largëta. Këto njohuri shfrytëzohen nga Ministria e Shëndetësisë për planifikim të balancuar territorial për të zvogëluar pabarazitë shëndetësore dhe për të adresuar përcaktuesit social të shëndetit.

Me mbështetjen e OBSH-së dhe UNICEF-it, është bërë përparim i mirë në rritjen e aftësive dhe njohurive të profesionistëve dhe organizatave të kujdesit shëndetësor në mbikëqyrjen, mbulimin dhe menaxhimin e vaksinave, duke përfshirë vaksinat kundër COVID-19. 200.000 doza të vaksinave kundër COVID-19 u shpërndanë me ndihmën e UNICEF-it përmes mekanizmit KOVAKS. U përfundua Strategjia e imunizimit të fëmijëve të pavaksinuar për të siguruar qasje në vakcina për të gjithë fëmijët që nuk janë vaksinuar. Në bazë të rezultateve të një studimi të sjelljes për hezitimin për të marrë vaksinat MMR1, UNICEF-i ka zhvilluar pesë prototipe që u shtypën dhe u shpërndanë në 34 qendra shëndetësore, pika të vaksinimit dhe te mjekët amë në të gjithë vendin. Përmes seancave të trajnimit, mbështetjes teknike dhe përfshirjes së komunitetit, shkallët e vaksinimit u përmirësuan ndjeshëm, duke synuar arritjen e shkallëve para COVID-19. Gjithashtu u vë në dukje përparimi për sa i përket raportimit në kohë dhe menaxhimit të të dhënave që kanë të bëjnë me vaksinat. Ky rezultat luajti një rol jetësor në luftën kundër COVID-19 dhe kontribuoi shumë në mbrojtjen e komuniteteve nga sëmundjet që mund të parandalohen nga vaksinat.

200,000 вакцини обезбедени

со поддршка од УНИЦЕФ преку КОВАКС механизмот

Udhëzimet kombëtare dhe Procedurat Standarde Operative për COVID-19 dhe imunizimin e rregullt u përditësuan në bashkëpunim me Qendrën për Mjekësinë Familjare për të mundësuar shpërndarjen e sigurt dhe efektive të vaksinave. Rreth 300 profesionistë shëndetësorë (mjekë dhe infermierë në MPSH, duke përfshirë pediatrat dhe ekipet vullnetare të lëvizshme) u trajnuan për shpërndarjen e vaksinave, e po ashtu mbi 90 menaxherë për imunizim u trajnuan për procedurat standarde operative. Arritja e programit të imunizimit në çdo zonë (RED) u pilotua në 12 komuna në të gjithë vendin, duke synuar zvogëlimin e boshllëqeve në mbulimin me imunizim dhe përfshirjen e grupeve më të rrezikuara, si për aktivitetet e programit për imunizim kundër COVID-19 ashtu edhe për aktivitetet e imunizimit rutinor. 50 menaxherë për imunizim nga e gjithë Maqedonia e Veriut u trajnuan se si të zhvillojnë mikroplanifikimin rajonal të imunizimit. Mbi 500 punonjës shëndetësorë nga pikat e vaksinimit në të gjithë vendin u trajnuan mbi "Shëndetin dhe sigurinë në punë", për të mundësuar promovimin e praktikave më të mira, të drejtave, roleve dhe përgjegjësisë të punonjësve shëndetësorë, duke përfshirë vështrimet kryesore për sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë reagimit ndaj COVID-19. U organizuan trajnime shtesë për mbi 30 punëdhënës të mëdhenj për promovimin e sigurisë në punë, të cilat përfshinin përfitimet nga vaksinimi kundër COVID-19 për procesin e punës.

Sistemi i monitorimit të ngjarjeve të padëshiruara përmes sistemit kombëtar për të dhënat elektronike shëndetësore – "Moj termin" (Takimi im) u përditësua me qëllim të përforcimit të integritimit midis "Takimit tim" dhe sistemit të Agjencisë së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (MALMED). Mbi 650 mjekë amë si dhe specialistë-pediatër nga ekipet parandaluese nga qendrat shëndetësore u trajnuan mbi mundësitë e reja për të raportuar në mënyrë digjitale për ngjarjet e padëshiruara pas imunizimit, me

qëllim të minimizimit të barrës administrative të punonjësve shëndetësorë.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, u kryen dy rrethe të analizës sasiore dhe cilësore të pasqyrës së sjelljes (BI) për të vlerësuar perceptimet e rrezikuar, sjelljet, besimin dhe njohuritë në lidhje me pandeminë e COVID-19 te publiku i gjerë dhe punëtorët shëndetësorë në vend, e cila ofroi informata veprimet që duhet të ndërmerren në aspekt të politikave dhe komunikimit.

ËSHTË SIGURUAR ARSIM CILËSOR DHE I PËRBALLUESHËM NË MJEDISËT PËR MËSIM QË I MARRIN PARASYSH TRAUMAT E PËRJETUARA, QË JANË TË PËRGJEGJSHME NË ASPEKT GJINOR DHE GJITHËPËRFSHIRËSE, PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË NË VEND ME QËLLIM TË RRRITJES SË REZULTATEVE TË MËSIMIT, PËR TË MUNDËSUAR ZHVILLIMIN E TYRE SOCIO-EMOCIONAL DHE PËR T'U FUQIZUAR ME AFTËSI PËR KALIMIN NË TREGUN E PUNËS.

Në vitin 2022, UNICEF-i, UNFPA-ja, UNHCR-ja dhe UNDP punuan me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe partnerët e tjerë relevantë për të trajtuar boshllëqet sistemore në fushën e arsimit, të cilat ishin përqësuar edhe më shumë nga pandemia. Agjencitë e OKB-së ofruan mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve të profesionistëve të institucioneve parashkollore dhe të shkollave fillore për arsimin gjithëpërfshirës, shëndetin mendor dhe mbështetjen psiko-sociale, mësimdhënien dhe mësimin e shoqëruar nga teknologjia, mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike.

Në përgjigje të këtyre sfidave, UNICEF-i orientoi përpjekjet e tij për të rritur qasjen në arsimin parashkollor së bashku me një proces më të gjerë për të optimizuar të gjithë rrjetin e shkollave dhe për të përdorur më mirë burimet që janë në dispozicion. UNICEF-i gjithashtu i ka përfshirë drejtpërdrejt komunitat në planifikimin për optimizimin e burimeve dhe shfrytëzimin e hapësirave të papërdorura në shkolla me qëllim të përfshirjes më të madhe të fëmijëve në arsimin e nivelit parashkollor.

Realizimi i programit kombëtar për Mësimin Social dhe Emocional u përfundua përmes një rrjeti për mbështetje të kolegëve prej 192 mësimdhënësish, duke përfshirë 71 institucione parashkollore dhe 1.366 mësimdhënës parashkollorë (të gjithë punojnë si mësimdhënës të nivelit parashkollor). Me qëllim të përforcimit të sistemit të mbështetjes dhe zhvillimit horizontal në institucionet parashkollore, u zhvillua një program trajnimi dyvjeçar për Komunitetet e qëndrueshme të Mësimin Profesional (KMP). Përmes një programi me shtatë module, 202 mësimdhënës parashkollorë morën një kornizë konceptuale dhe përvojë praktike dhe u mbështetën për të iniciuar krijimin e KMP-ve në institucionet parashkollore, për të promovuar një kulturë të mësimin të vazhdueshëm për të gjithë stafin.

10,000 родители опфатени

со кампања за родителски ресурси

Në mars të vitit 2022 u organizuan një konferencë ndërkombëtare mbi 'Ndërveprimin midis mirëqenies së fëmijëve dhe arritjeve akademike', ku u mblodhën së bashku ekspertë, mësimdhënës dhe profesionistë të shquar kombëtarë dhe ndërkombëtarë (nga Britania e Madhe, SHBA-të, Kanadaja, Kroacia dhe Moldavia) për të diskutuar të mësuarit social dhe emocional, prindërimin, teknologjitë digjitale në arsim dhe mirëqenien e fëmijëve. Konferenca ngriti vetëdijen për rëndësinë e zhvillimit social dhe emocional dhe zgjerimin e qasjes në arsimin parashkollor për të gjithë fëmijët, rëndësinë

e mbështetjes psiko-sociale dhe mirëqenies gjatë procesit të arsimit dhe më vonë në moshën e rritur, për aspektet e ndryshme të rritjes së përdorimit të teknologjisë digjitale në arsim, efektet e saj në proces dhe mundësitë e vërejtura. Në konferencë kishte më shumë se 4.600 pjesëmarrës online, dhe 200 pjesëmarrës me pjesëmarrje fizike.

Në institucionet parashkollore u organizuan **një seri prej 15 ngjarjesh 'Ndarja dhe Luajtja'**, duke bashkuar profesionistë të institucioneve parashkollore dhe prindër nga komunitete të ndryshme. Ngjarjet kishin për qëllim programin dhe burimet e të mësuarit social dhe emocional ta bëjnë më të afërt për prindërit dhe kujdestarët dhe të promovojnë një angazhim më të madh të prindërve, kujdes të përgjegjshëm dhe mësimin social dhe emocional (MSE) në shtëpi. Në ngjarjet hibride u përfshinë më shumë se 10.000 prindër, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e MSE-së, duke rritur kështu kërkesën e publikut për mundësi të të mësuarit social dhe emocional.

Për të mbështetur **përfshirjen e hershme të fëmijëve me aftësi të kufizuara**, një masë kritike prej 400 profesionistësh në të gjithë vendin, duke përfshirë edhe ata nga institucionet parashkollore dhe qendrat e burimeve, u mbështetën me ngritjen e kapaciteteve për të zbatuar Komunikimin augmentantiv dhe alternativ për t'u ndihmuar fëmijëve me nevoja komplekse të komunikimit që të komunikojnë me bashkëmoshatarët dhe kujdestarët e tyre, duke e lehtësuar kështu përfshirjen, mësimin dhe zhvillimin e tyre të hershëm.

Për të mbështetur **përfshirjen e plotë të të gjithë fëmijëve në arsimin e integruar deri në vitin 2023**, në partneritet me BZHA-në, UNICEF-i mbështeti zhvillimin e një Doracakut të ri për Plan-programin e Ndryshuar për Fëmijët me Nevoja Komplekse. Për më tepër, **1.236 anëtarët e ekipeve gjithëpërfshirëse shkollore nga të gjitha 364 shkollat fillore** i rritën njohuritë dhe të kuptuarit e tyre se si të punojnë në mënyrë bashkëpunuese për të krijuar një mjedis zhvillues dhe stimulues për fëmijët me aftësi të kufizuara për të mësuar dhe zhvilluar aftësitë që u nevojiten për të përparuar.

Eduino vazhdoi të ofrojë uebinare për zhvillimin profesional të mësimitshënësve. Gjatë vitit 2022, seria e uebinareve u përqendrua në **metodat inovative të mësimitshënësve, përdorimin e mjeteve digjitale, gjithëpërfshirjen, mjedisin dhe mirëqenien e nxënësve** si një faktor i rëndësishëm në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve. Seria e uebinareve për zhvillim profesional kishte më shumë se 10.000 pjesëmarrës (fuqia e përgjithshme e punës së mësimitshënësve në Maqedoninë e Veriut është 26.000). **Gjashtë kurse online me ritëm individual për zhvillimin e mësimitshënësve për mësimitshënënie dhe mësimnxënënie digjitale gjithëpërfshirëse të mbështetur nga teknologjia**, u zhvilluan, u miratuan nga BZHA-ja. Modulet do të vihen në dispozicion të mësimitshënësve si kurse online me ritëm individual në vitin 2023.

Duke njohur potencialin e pashfrytëzuar të sistemit arsimor për të promovuar shëndetin mendor dhe mirëqenien psiko-sociale, u zhvilluan, u pilotuan dhe u testuan module dhe mjete online të trajnimit për ShMMPs për psikologët, duke u ofruar psikologëve të shkollave një burim për mësimin sipas ritmit individual, së bashku me një pako të verifikuar mjetes. Përveç kësaj, grupi i ri i mësimitshënësve të klasës 1 dhe klasës 4 (3.000) u mbështetën për të zbatuar **plan-programin e ri kombëtar** përmes trajnimit mbi rëndësinë e shëndetit të mirë mendor dhe mirëqenies në rritjen e të nxënësve, kreativitetit dhe produktivitetit të nxënësve, shëndetit fizik dhe jetëgjatësisë së tyre.

UNFPA-ja vazhdoi me mbështetjen për futjen e arsimit gjithëpërfshirës seksual në plan-programet e shkollave dhe iniciativat që lidhen me të rinjtë. Në bazë të Memorandumit për mirëkuptim të nënshkruar me Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA), UNFPA-ja në vitin 2022 vazhdoi mbështetjen e

BZHA-së në procesin e pozicionimit strategjik, planifikimit dhe zbatimit të edukimit gjithëpërfshirës seksual. **UNFPA-ja** dhe **UNICEF-i** kontribuan në zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për EGJS Ky dokument është një parakusht për përhapjen e EGJS-së në nivel kombëtar, pas pilotimit të EGJS-së në vitet 2021/2022, në 3 shkolla fillore. Strategjia u hartua në atë mënyrë që të ofrojë qasje dhe zgjidhje inovative për EGJS-në në sistemin arsimor dhe fokusohet në 2 prioritet kryesore: Përmirësimi i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në fushën e edukimit gjithëpërfshirës seksual dhe rritja e vetëdijes për nevojën për të mësuar përmbajtjen e edukimit gjithëpërfshirës seksual në arsimin fillor.

Në vitin 2022, në përgjigje të pandemisë së COVID-19, **UNICEF-i** vazhdoi të mbështesë **shkollat** që përballen me sfidat e sigurimit të ujit, pajisjeve sanitare dhe higjienës (WASH) dhe parandalimin dhe kontrollin i infeksioneve. UNICEF-i vazhdoi bashkëpunimin me komitetin trepalësh për WASH, të përfaqësuesve nga MASH-i, Instituti për Shëndet Publik dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit. Si rezultat i kësaj, 58 shkolla periferike, kryesisht rurale, morën pajisje të lëvizshme për larjen e duarve – duke mbuluar në mënyrë efektive 8.260 nxënës. Prandaj, përfaqësuesit e stafit teknik nga këto shkolla ndoqën trajnime të specializuara për WASH dhe ndihmuar në avancimin e planeve për përmirësimin e higjienës së shkollave.

Në prag të **Samitit të Transformimit të Arsimit** të organizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, një seri prej 10 konsultimesh kombëtare mbi të ardhmen e arsimit u organizuan nga UNICEF-i nën koordinimin e përgjithshëm të Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së dhe me pjesëmarrjen aktive të disa agjencive të tjera të OKB-së. Mbi 600 të rinj, studentë, mësimitshënës, zyrtarë komunalë, deputetë dhe OSHC u përfshinë në konsultime. Duke u bazuar në kontributin nga konsultimet, u përgatit një deklaratë kombëtare e përkushtimit dhe u prezantua nga Kryeministri në Samitin në Nju Jork.

SISTEMI I MBROJTJES SOCIALE ËSHTË REZISTENT NDAJ GODITJEVE TË JASHTME DHE I PËRFORCUAR PËR TË OFRUAR SHËRBIME TË PËRMIRËSUARA NË MËNYRË PROGRESIVE PËR TË GJITHË PERSONAT NË NEVOJË, VEÇANËRISHT PËR ATA QË JANË LËNË PAS.

Gjatë vitit 2022, katër agjenci të OKB-së (UNICEF-i, UNHCR-ja, IOM-i dhe UNDP-ja) bashkëpunuan me institucionet përkatëse (ministritë e linjës, agjencitë qeveritare dhe shoqërinë civile) për të adresuar nevojat e fëmijëve, të personave që janë lënë pas, e që kanë nevojë për ndihmë dhe shërbime. Rezultatet e UNDP-së për këtë dhe për pjesën e mëparshme mbi arsimin janë dhënë në nën Rezultatit 1 mbi Prosperitetin gjithëpërfshirës.

Për të siguruar një **mjedis përkujdesës për fëmijët**, UNICEF-i aplikoi një qasje të dyfishtë të mbështetjes së politikave dhe të zhvillimit të shërbimeve. Në nivel të politikave, për herë të parë në vend u zhvillua **një strategji e re ndërsektoriale e prindërimit**, duke ofruar udhëzime për prindërimin pozitiv. Strategjia ofron një qasje sistemore në ofrimin e shërbimeve, burimeve dhe iniciativave për mbështetjen e prindërve. Ajo është hartuar jo vetëm për të përmirësuar aftësitë pozitive të prindërimit, por edhe për të rritur mjediset që ofrojnë mundësi dhe kapacitetet e fuqisë punëtore për të mbështetur prindërit, për të promovuar kujdesin e përbashkët dhe teknikat e disiplinës jo të dhunshme, duke i dhënë fund praktikave të ashpra dhe abuzive të prindërimit dhe për të mbështetur shëndetin mendor dhe mirëqenien e prindërve.

Në nivelin e shërbimeve, fëmijët përfituan nga **shërbimet e modelit për përmirësimin e aftësive të prindërimit përmes: Programit të Prindërimit Përkëdhelës**, të realizuar online,

aplikacionit të prindërimit Bebo, që ofron udhëzime dhe informacione për zhvillimin e fëmijës; dhe **Linjës së ndihmës për prindërit** - të gjitha që mundësojnë qasje të lehtë dhe me kosto të ulët në ndërhyrjen e hershme dhe mbështetjen e prindërve

Mbështetja e UNICEF-it për përfundimin e sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve u përqendrua në zhvillimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore të shërbimit social. Duke filluar nga sistemi i kujdesit për fëmijët, kapaciteti i profesionistëve kryesorë në këtë sistem u ndërtua në bazë të standardeve të reja për kujdestarinë dhe kujdesin e fëmijëve sipas lidhjes farefisnore. Procesi i identifikimit dhe kërkesës së familjeve të reja kujdestare dhe qasja në informacione për popullsinë e përgjithshme, profesionistët dhe familjet ekzistuese kujdestare është lehtësuar përmes faqes së internetit për kujdestari. **Regjistri i kujdestarisë**, i mbështetur nga UNICEF-i, përpilon informacion mbi familjet kujdestare të mundshme, aktive dhe atyre që janë në dispozicion, duke lehtësuar kështu komunikimin midis profesionistëve kryesorë.

Platforma e re dhe unike e Mësimi Digjital për fuqinë punëtore të shërbimit social, e krijuar në partneritet me UNHCR-në dhe UNICEF-in, siguron zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale. Ajo ofron mbajtjen e trajnimeve të specializuara online, që janë të nevojshme për proceset e licencimit. Deri tani, më shumë se njëqind punëtorëve të sektorit social që punojnë drejtpërdrejt me palët u janë ofruar mjetet për të përmirësuar qëndrueshmërinë personale dhe në këtë mënyrë të sigurojnë përgjigje më të mirë të sistemit në situata krize. Këta profesionistë gjithashtu kanë përfutur aftësitë e nevojshme për të zhvilluar programet vjetore për shëndetin mendor dhe mbështetjen psiko-sociale për fëmijët më të rrezikuar, duke përdorur qasje holistike ndaj shëndetit mendor.

Mbështetja e UNICEF-it për të adresuar lodhjen e mundshme të tepërt në punë gjatë pandemisë, duke siguruar që më shumë se njëqind punëtorë të sektorit social që punojnë drejtpërdrejt me palët të pajisen me mjete për të përmirësuar qëndrueshmërinë personale dhe në këtë mënyrë të sigurojnë përgjigje më të mirë të sistemit në situata krize. Më shumë se 200 familje që ishin në gjendje të vështirë gjatë pandemisë me COVID-19 morën shërbime të menjëhershme të mbrojtjes sociale ose referim nga shtatë ekipe të lëvizshme të përbëra nga avokatë dhe punëtorë socialë, në bashkëpunim të ngushtë me QPS-të, me mbështetjen e UNICEF-it.

Në fushën e mbrojtjes sociale të ndjeshme ndaj fëmijëve, UNICEF-i e përfundoi punën për zhvillimin e njohurive dhe mjeteve që përdoren nga profesionistët e punës sociale në Qendrat e Punës Sociale (QPS) të vendit, për të aplikuar metodën e menaxhimit të integruar të lëndëve dhe për të menaxhuar më mirë ngarkesën e punës. Pothuajse të gjithë përgjegjësit e lëndëve në të gjithë 30 Qendrat e Punës Sociale (QPS) morën pjesë – 197 përgjegjës të lëndëve, duke përfshirë edhe në 168 sesionet e mentorimit të programit. Nga kjo do të përfitojnë mbi 50.000 amviseri që marrin shërbime sociale dhe ndihma përmes QPS-ve. Materiali i trajnimit i programit të mentorimit për profesionistët e punës sociale u transferua në Institutin e Punës Sociale dhe është inkorporuar në platformën elektronike për edukimin e profesionistëve të punës sociale.

Në fushën e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, UNICEF-i zhvilloi kapacitetet kombëtare për zgjerimin e modelit të aftësisë së kufizuar të bazuar në të drejtat e njeriut dhe vlerësimin e nevojave të fëmijëve dhe të rinjve në Rajonin Planifikues Verilindor, Lindor, të Vardarit dhe atë Jugperëndimor. Me këtë do të përfundojë futja e modelit të ri si një pikë e vetme hyrëse për shërbimet mbështetëse dhe përfitimet në të gjithë vendin. **Një vlerësim i kryer nga jashtë i ndërhyrjeve të mbështetura nga UNICEF-i** që synojnë të përmirësojnë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara arriti në përfundimin se ndërhyrjet kontribuan shumë në

rritjen e disponueshmërisë dhe ofrimit të shërbimeve, si dhe të burimeve njerëzore të kualifikuara dhe ndihmuan ndjeshëm për të ndryshuar pozitivisht paradigmen dhe për të përmirësuar të kuptuarit e publikut për aftësinë e kufizuar.

Në mbështetje të Qeverisë, të udhëhequr nga parimi që askush të mos lihet pas, UNICEF-i e mundësoi dhe e lehtësoi ofrimin e shërbimeve shëndetësore, arsimore, sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve për familjet afgane që ishin vendosur përkohësisht në vend.

Në partneritet me UNHCR-në, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Kryqi i Kuq i Qytetit dhe Porta e Hapur-La Strada mbështetën gjithsej **40 persona (refugjatë dhe azilkërkuar) me nevoja specifike**, të akomoduar në akomodim privat dhe në Qendrën e Pranimit për azilkërkuar në Vizbeg. Organizatat e lehtësuan qasjen në shërbime, të tilla si arsimit, punësimi, ndihma sociale dhe i plotësuan aktivitetet e udhëhequra nga qeveria, u ndihmuan personave në gjetjen e akomodimit të përshtatshëm për nevojat e veçanta, i lehtësuan ndërhyrjet mjekësore aty ku ishte e nevojshme, duke ofruar orë për mësimin e gjuhës dhe mbështetje psiko-sociale në baza ditore.

Në aspekt të ndihmës së drejtpërdrejtë, **IOM-i** mbështeti drejtpërdrejtë më shumë se **26.000 emigrantë, refugjatë dhe azilkërkuar** të akomoduar në Qendrat e përkohshme të tranzitit në VINOJUG dhe në Qendrat e Pranimit të azilkërkuarve në Vizbeg, të cilët morën mbështetje mjekësore dhe mbështetje psiko-sociale, ndërmjetësim kulturor, aktivitete rekreative, ndihmë gjuhësore dhe nevoja të tjera të pranimit dhe mbrojtjes.

Në fund, në lidhje me **zotimin e Fondit të Paktit Global për Refugjatët në lidhje me refugjatët e mbetur nga Kosova**, 5 persona kanë marrë nënshtetësi dhe 6 janë kthyer vullnetarisht në Kosovë, 244 persona nga numri fillestar i refugjatëve të Kosovës janë ende në vend, dhe situata e tyre pritet që të zgjidhet deri në vitin 2024.

PËRGJIGJE E PËRMIRËSUAR MULTISEKTORIALE PËR TË PARANDALUAR DHE ADRESUAR TË GJITHA FORMAT E DHUNËS DUKE U BAZUAR NË QASJEN E PËRQENDRUAR TE VIKTIMAT/TË MBIJETUARIT, DUKE PËRFSHIRË EDHE PRAKTIKAT E DËMSHME DHE NORMAT DHE STEREOTIPET DISKRIMINUESE GJINORE

Gjatë vitit 2022, OKB-ja (dhe në mënyrë specifike UN Women and UNFPA) e mbështeti zbatimin e Ligjit të miratuar rishtazi për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, duke siguruar mbështetje teknike për zhvillimin e dokumenteve kryesore dhe dizajnimin dhe pilotimin e shërbimeve për viktimat dhe kryerësit e veprave.

Me mbështetje të UNFPA-së, u përfundua Protokollin Multisektorial (Protokollin MSR), gjashtë (6) akte nënligjore, Programi për Riintegrimin e Viktimave, me përpjekje të përbashkëta të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe OSHC-ve që punojnë në parandalimin e DhBGJ-së, barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave është themeli për politikat e bazuara në dëshmi që kontribuojnë drejt cilësisë së shërbimeve për ata që kanë përjetuar DhBGJ. Duke synuar mungesën kronike të të dhënave cilësore dhe të besueshme për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, UNFPA-ja mbështeti Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale në hartëzimin e kushteve dhe sfidave aktuale në lidhje me mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të DhBGJ-së në Maqedoninë e Veriut, pas të cilit filloi zhvillimi i një Modeli IMS plotësisht funksional.

Në forumin e organizuar nga UNFPA-ja në kuadër të fushatës rajonale për të drejtën e trupit me titull: **“Virtualja është e vërtetë: Përforsimi i kornizave ligjore në mbështetje të autonomisë së trupit”**, u diskutua për situatën aktuale dhe kornizën ligjore për dhunën kibernetike. Forumi kontribuoi për përforsimin e partneriteteve rajonale përmes hartimit të masave të qëndrueshme dhe efektive ligjore dhe për ngritjen e vetëdijes për të luftuar dhunën digjitale dhe dhunën me bazë gjinore në përgjithësi.

Një fushatë mbarëkombëtare që fokusohet në ngritjen e vetëdijes në lidhje me shërbimet në dispozicion për viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në vend dhe në adresimin e pengesave të përhapura që i pengojnë gratë të raportojnë dhunën si p.sh. turpi, frika dhe keqkuptimet, kishte për synim të gjitha gratë dhe vajzat që jetojnë në zonat urbane dhe rurale me fokus në popullsinë rome. Fushata mbarëkombëtare arriti një shtrirje prej 1,67 milionë personash, me ç'rast u përfshinë 57.000 persona, me një inkuadrim unik të 455.000 personave në mediat kryesore sociale. Në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit, OKB-ja e mbështeti organizimin e ngjarjeve në komunitet për të ngritur vetëdijen në lidhje me dhunën në internet në tre komunitete (Dibër, Strumicë dhe Prilep), me ç'rast më shumë se 100 pjesëmarrës diskutuan në mënyrë aktive për mënyrat e parandalimit dhe mbrojtjes nga DhBGj-ja.

2,430 Роми

вклучени во обуки за родово-базирано и домашно насилство

Me mbështetjen e UN Women: **2.430 gra, burra, vajza dhe djem romë kanë rritur njohuritë dhe vetëdijen për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave (DhG) dhe dhuna në familje**, duke përfshirë diskriminimin gjinor, stereotipet e dëmshme gjinore dhe martesat e hershme, përmes mbi 2.000 vizitave në kuadër të një fushate derë më derë, 10 takimeve në rrjet dhe tetë takimeve për dialog të udhëhequra nga OShC-ja “Qendra Kombëtare Rome”. Si rezultat i kësaj, u vërejt një ndryshim në pikëpamjet e tyre personale mbi dhunën dhe në disa raste, një ndryshim në sjellje - 19 gra rome kanë kërkuar ndihmë ligjore, duke përfshirë procedurat e divorcit për shkak të dhunës në familje. 10 raste përfunduan me vendime gjyqësore pozitive në favor të grave dhe martesat e tyre u ndërpre në vendime të plotfuqishme gjyqësore. Gratë tani e gëzojnë mundësinë për të jetuar jashtë mjedisit të dhunshëm, të marrin mbështetje për fëmijët dhe përfitime shtetërore.

Përveç kësaj, mbështetja e UN Women për viktimat e dhunës përmes ofrimit të shërbimeve rezultoi me 249 gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës në Rajonin Juglindor të Maqedonisë së Veriut që përfituan nga shërbimet e dy qendrave të reja të

hapura të këshillimit psiko-social, të udhëhequra nga OShC-të partnere “Skaj Plus” nga Strumica dhe “EHO” nga Shtipi, të cilat u ndihmuan me mbështetje teknike dhe mentoruese nga partneri i UN Women, OShC “HERA – Shoqata për Edukim Shëndetësor dhe Huluntim”. Qëndrueshmëria për Qendrën e këshillimit psiko-social në Strumicë u siguroa me hartimin dhe miratimin e një Plani Lokal të Veprimit komunal për Dhunën me Bazë Gjinore, me mbështetjen e UN Women, i cili parashikon alokime financiare për funksionimin e qendrës.

UN Women e mbështeti fuqizimin ekonomik të 15 grave të mbijetuara të dhunës, të cilat janë gjithashtu të papuna për një periudhë afatgjate dhe janë nëna të vetme, përmes një programi 12-mujor të mentorimit social për fuqizimin ekonomik, të organizuar nga OShC partnere e UN Women -Shoqata për Huluntim, Komunikim dhe Zhvillim - PUBLIC. 13 gra kanë gjetur punë dhe e kanë mbajtur atë dhe kanë gëzuar cilësi më të mirë të jetës falë këtij programi.

Me mbështetjen e UNFPA-së, materialet aktuale të trajnimit mbi ShSR-në dhe DhBGj-në për profesionistët e ShSR-së, ofruesit e shërbimeve të DhBGj-së dhe për organizatat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK) u shqyrtuan dhe u përditësuan nga personat me aftësi të kufizuara të trajnuar profesionalisht për KDPK dhe edukatori dhe rehabilituesi special, duke kontribuar kështu për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ShSR dhe DhBGj për personat me aftësi të kufizuara. Këto materiale synojnë t'i sensibilizojnë ofruesit e shërbimeve duke përfshirë OPAK dhe iniciativat e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara, që janë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, në kuadër të këtij rezultati, me mbështetjen e Zyrës së ITU për Evropën, u realizua **Vlerësimi i parë Kombëtar për Sigurinë e Fëmijëve në Internet** nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Vlerësimi përfshin huluntim cilësor dhe sasior dhe përfundon me një udhërrëfyes operativ të bazuar në sfidat e identifikuara, mundësitë dhe rekomandimet. Rekomandimet e raportit u shfrytëzuan për Strategjinë Kombëtare të TIK-ut 2023-2027. Vlerësimi çoi në nënshkrimin e Memorandumit për Bashkëpunim (MB) ndërmjet Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të avancuar mbrojtjen e fëmijëve të vendit në internet.

REZULTATI 3

Mjedisi jetësor i shëndetshëm



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga veprimet ambicioze klimatike, burimet natyrore të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe biodiversiteti i ruajtur mirë përmes menaxhimit të mirë të mjedisit jetësor dhe nga komunitetet rezistente ndaj fatkeqësive.



Децата учат за климатските промени и развиваат љубопитност за наука преку експерименти и учење преку правење. Учители и обучувачи се вклучија во работилниците поддржани од УНИЦЕФ за развој на вештини за учење преку експерименти. На работилниците учителите и обучувачките добија вештини за примена на нови достапни експерименти во рамки на часовите. Овој пристап им помага на децата да ги научат основите на науката и ефектите врз животната средина и климатските промени, како што е деградацијата на вода, масла, воздух, топлина и циклusi на затоплување. Учењето преку искуство им помага на децата да развијат вештини за решавање на проблеми, упорност и соработка. *Извор: УНИЦЕФ*

POLITIKAT LEHTËSUJESË, MJEDISI RREGULATOR, KAPACITETET NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL DHE VEPRIMET E KOMUNITETIT U PËRFORCUAN PËR ZHVILLIM ME EMETIM TË ULËTA, DHE REZISTENCË MULTISEKTORIALE NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Në vitin 2022, UNDP-ja e mbështeti zhvillimin e **Komunikimit të katërt kombëtar (KK 4)**, i cili u miratua nga Qeveria në janar të vitit 2023. Është zhvilluar **Inventari Kombëtar i GS** për periudhën 2015 – 2019, duke e plotësuar serinë kohore ekzistuese për vitet 1990 – 2014. U përdorën disa mjete inovative, të tilla si parashikimi dhe ndjesia nga distanca, të cilat rezultuan në integrimin e aspekteve të ndryshimeve klimatike në planifikimin hapësinor/urbanistik, përmirësimin e cilësisë së inventarit të GS në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit tjetër të tokës (BPPTT), vlerësimin e përmirësua të fundosjeve të mundshme dhe futjen e nivelit të ri të cenueshmërisë në nivel komunal duke futur indeksin e cenueshmërisë së jetesës. Qëndrueshmëria e përditësimeve të ardhshme të Inventarit të GS sigurohet përmes transferimit sistematik të njohurive në institucionet përkatëse, aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve dhe bashkëpunimit të ngushtë

me ofruesit kryesorë të të dhënave siç është Enti Shtetëror i Statistikave.

Potenciali për zbutje i vendit deri në vitin 2040 u rishikua dhe u vërtetua për të siguruar harmonizimin me prioritetet përkatëse kombëtare. KK 4 së bashku me **Raportin e Përditësuar Dyvjeçar 3 (RPD 3)** paraqesin një vizion të qartë për objektivat ambicioze të zbutjes së klimës, duke u bazuar në hulumtime të dëshmuara shkencore dhe në inventarin ekzistues të fortë dhe gjithëpërfshirës të GS. Ato kanë kontribuar me informacione në Strategjinë e re të Energjisë, Planin Kombëtar të Veprimit për Energjinë dhe Klimën (PKVEK), KPNK-në e rishikuar dhe Strategjinë Afatgjate për Veprimin Klimatik. Si pjesë e KK 4, u përditësua informacioni mbi ndjeshmërinë e vendit ndaj efekteve negative të ndryshimeve klimatike, dhe u propozuan **masat e nevojshme të përshtatjes** për të përmbushur nevojat dhe shqetësimet specifike që dalin nga këto efekte padëshiruara. Janë zhvilluar skenarët për ngjarjet e ardhshme të motit ekstrem. Është zhvilluar **Platforma e Monitorimit, Raportimit dhe Verifikimit (MRV)**. Ajo është dizajnuar për të shërbyer si një bazë për raportim të vazhdueshëm transparent si në UNFCCC dhe BE/Komunitetin e Energjisë mbi ndryshimet klimatike. UNDP-ja gjithashtu mbështeti përgatitjen e propozimit të projektit për zhvillimin e Planit Kombëtar të

Përshtatjes (PKP) i cili do të dorëzohet në FKGj në tremujorin e parë të vitit 2023.

Vendi është gjithashtu pjesë e iniciativës kryesore të UNDP-së, **Premtimi Klimatik**: Nga Zotimi në Ndikim - Shfrytëzimi i Premtimit Klimatik për të kthyer Kontributet e Përcaktuara në Nivel Kombëtar në veprime ambicioze klimatike. Ajo synon të krijojë një bazë për ndërmarrjen e aktiviteteve fillestare të nevojshme për **zbatimin e KPNK-ve të rishikuara** duke krijuar një mjedis që mundëson koordinim më të mirë midis aktorëve kryesorë kombëtarë dhe realizimin e veprimeve të tij ambicioze klimatike duke zhvilluar propozime konkrete të projekteve dhe duke mobilizuar burime për realizimin e tyre.

Bashkëpunimi me Qytetin e Shkupit në katër vitet e fundit rezultoi me zgjerimin e bazës për të dhënat ekologjike, informacionet dhe studimet e nevojshme për marrjen e vendimeve në bazë të informatave, dhe krijoi **modele të terrenit për përmirësimin e rezistencës urbane**. U përfrocau kapacitetet e administratës së **Qytetit të Shkupit** për ofrimin e shpejtë dhe cilësor të shërbimeve për qytetarët dhe për përfshirjen e palëve lokale gjatë hartimit dhe zbatimit të programit. Janë kryer disa studime që i përcaktojnë veprimet e ardhshme që do ta avancojnë agjendën lokale ekologjike: Harta e Biotopeve për Rajonin e Shkupit, Inventarizimi i vendbanimeve përgjatë lumenjve dhe Plani i Veprimit për Aglomeratin e Shkupit. Studimi i ujërave nëntokësore, Strategjia e Menaxhimit të Ujërave për rajonin e Shkupi, Studimi i shtigjeve të mundshme të transmetimit të kromit gjashtëvalent në ujërat nëntokësore të malit Zheden dhe ndikimi i tyre në burimin e Raçes, që e furnizon qytetin me ujë të pijshëm, Dokumenti i planifikimit strategjik për ridizajnimin e hapësirave publike, si dhe dokumentacioni teknik për një korridor të gjelbër përgjatë lumenjve Seravë dhe Lepenc. Qyteti i Shkupit ka krijuar modele për rritjen e rezistencës urbane dhe i ka testuar ato për të ofruar dëshminë e konceptit: Kadastra e Gjelbër e Shkupit, Ndërtimi i kulmeve të gjelbra në Qendrën Tregtare të Qytetit dhe në Shtëpinë e Kulturës "Koço Racin", Gjelbërimi i shpatinave në Kalanë e Shkupit. Laboratori i Shkupit, Qendra për Inovacion e Qytetit të Shkupit që u krijua me mbështetjen e UNDP-së, i zhvilloi kapacitetet e administratës së Qytetit të Shkupit për qasje dhe teknika të reja të dizajnit dhe ofrimin të shërbimeve, ndihmoi në dizajnimin dhe ridizajnimin e dy shërbimeve për të rritur kënaqësinë e qytetarëve që i përdorin ato shërbime, dhe krijoi një mjedis të favorshëm për rritjen e bashkëpunimit me bizneset dhe qytetarët.

МОДЕЛИ ЗА ПОДОБРУВАЊЕ НА УРБАНА ОТПРНОСТ

се развиени

FAO mbështeti zhvillimin e një platforme në internet **E-agri, "E-bujqësia"** (<http://e-zemjodelstvo.mk/>). Për të përmirësuar rezistencën klimatike të bujqësisë. Platforma i integron të dhënat kombëtare të bujqësisë, duke përfshirë informacionin për tregun, të dhënat klimatike dhe të dhënat hapësinore, nga sisteme dhe baza të ndryshme të të dhënave digjitale (të tilla si, Sistemi i Informacionit të Tregut Bujqësor, platforma kombëtare "Agro-meteo" e shërbimit kombëtar Hidrometrologjik, si dhe informacionin nga baza e të dhënave hapësinore kombëtare përmes **Platformës globale të Hartës së Tokës** (<https://northmacedonia.earthmap.org/>). Ky mjeti do të sigurojë informacion për politikëbërësit në krijimin e politikave dhe masave për tranzicione të qëndrueshme në bujqësi. Platforma gjithashtu ofron një mjet falas "Ferma ime" për fermerët, për të ndjekur hyrjet dhe daljet dhe për të përmirësuar produktivitetin dhe të ardhurat e tyre nga ferma, duke e ruajtur qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor. (Kontributi në Treguesin e Rezultatit 3_1_30 të KBZhQ-së)

Më tutje, Qeveria u mbështet për të zhvilluar strategjinë kombëtare dhe mekanizmat për të promovuar **sistemet e farave rezistente ndaj klimës**. Në vitin 2022, u arritën rezultatet

e mëposhtme: i) Përfundimi i **një analize ligjore të legjislacionit kombëtar për farat**, duke i theksuar mangësitë dhe boshllëqet kryesore në raport me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe duke ofruar rekomandime për përmirësimin e kornizës institucionale dhe ligjore për prodhimin e farës dhe materialit mbjellës. ii) Në partneritet me Institutin e Bujqësisë të UKdheM, në vitin 2022 FAO realizoi demonstrime në fermë dhe programe të trajnimit në internet me qëllim të rritjes së aftësive të rreth 60 fermerëve, prodhuesve bujqësorë, përfaqësuesve të fermave për farë, kooperativave bujqësore dhe përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë. Kjo përpjekje synon të promovojë ripërtëritjen dhe shumëzimin e varieteteve lokale të farave të qëndrueshme ndaj klimës, duke u përafuar kështu me një nga qëllimet e Strategjisë Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (2021-2027) për rritjen e biodiversitetit në bujqësi dhe sigurimin e furnizimit me ushqim përmes prodhimit të farave me cilësi të lartë, tolerante ndaj klimës për kulturat kryesore. (Kontributi në Treguesin e Rezultatit 3_1_10 dhe 3_1_30 të KBZhQ-së). Në vitin 2022, FAO mbështeti Qeverinë për të përfunduar me sukses projektin e dytë të gatishmërisë së Fondit të Klimës së Gjelbër (FKGj) të Maqedonisë së Veriut. Një hap i madh për të rritur përfshirjen e sektorit privat në veprimet dhe investimet klimatike ka qenë vendimi i Qeverisë në prill të vitit 2022, për përcaktimin e Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik (FIZHT) të Maqedonisë së Veriut si **subjekt i parë kombëtar për të filluar procesin e akreditimit të FKGj**. Nëse akreditohet si një Subjekt Kombëtar për Qasje të Drejtpërdrejtë, FIZHT-ja do të jetë krah për krah me Subjektet Ndërkombëtare për Qasje në FKGj, siç janë agjencitë e Kombeve të Bashkuara, bankat multilaterale të zhvillimit dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Përmes FIZHT-së, vendi mund të ketë qasje të drejtpërdrejtë në FKGj, vendi do të ketë mundësi për qasje të plotë në fondet e ndryshimeve klimatike dhe për integrim më të mirë me planet e saj kombëtare të veprimit për klimën. Si hap i parë, u publikua Thirrja e parë e përbashkët Publike me titull "Sfida e Ndryshimeve Klimatike 2022", duke shpërblyer pesë kompani private për të realizuar idetë e tyre të projektit që propozojnë zhvillimin ose përdorimin e teknologjive inovative miqësore ndaj klimës dhe të pastra që mund të kontribuojnë në zbutjen ose përshtatjen e ndryshimeve klimatike në sektorët prioritarë të vendit. (Kontributi në Treguesin e Rezultatit 3_1_30 të KBZhQ-së) Në bashkëpunim me Kabinetin e Zëvendëskryeministrit për Çështje Ekonomike (IPN për FKGj) dhe Ministrinë e Financave, FAO përfundoi **Procedurën për Monitorimin, Ndjekjen dhe Integrimin e Financimit të Klimës** për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. U zhvillua dhe u pilotua një sistem në internet, i qasshëm përmes www.greendevlopment.mk, për të ndihmuar në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të financimit të klimës. U përgatit dhe u vërtetua Raporti i parë pilot për financimin e klimës i Agjencisë për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural. Kjo mbështet qëllimin e qeverisë për të krijuar një sistem kombëtar për të ndjekur, monitoruar dhe modernizuar financimin e klimës. Sistemi gjithashtu mund të monitorojë financimin e ndryshimeve klimatike nga burime publike, private dhe alternative dhe të vlerësojë progresin e vendit në përmblidhjen e angazhimit të UNFCCC-së për të mobilizuar financimin e klimës për përshtatjen dhe zbutjen e klimës. (Kontributi në Treguesin e Rezultatit 3_1_70 të KBZhQ-së)

Për të mbështetur Qeverinë në përfshirjen e sektorit privat në zhvillimin me emetime të ulëta dhe rezistent ndaj klimës, FAO zhvilloi **mjetin e parë në internet për përfshirjen e sektorit privat në veprimet klimatike**. Mjeti online shërben për të shfletuar terminologjinë kyçe, konceptet, përvojat dhe mundësitë, gjë që duhet të ndihmojë aktorët e sektorit privat të përfshihen në veprimet klimatike dhe investimet klimatike. Ai përmban informacione mbi ndryshimet klimatike, kërcënimet dhe mundësitë për sektorin privat të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, financat klimatike, teknologjitë klimatike dhe rolet e aktorëve të sektorit privat në zbutjen dhe përshtatjen ndaj

ndryshimeve klimatike. Ky mjet gjithashtu i udhëheq aktorët e sektorit privat nëpër të gjithë kontekstin institucional dhe politik në lidhje me veprimet klimatike në Maqedoninë e Veriut. (Kontributi në Treguesin e Rezultatit: 3_1_30 të KBZhQ-së). Në vitin 2022, FAO mbështeti IPN për FKGj në realizimin e **tetë trajnimeve tematike mbi temat klimatike** të identifikuar gjatë Vlerësimit të nevojave të kapaciteteve për FKGj në vitin 2021. Me këto trajnime u përmirësuan aftësitë e 140 të punësuarve të qeverisë nga institucionet përkatëse për të menaxhuar dhe koordinuar veprimet dhe financat klimatike. (Kontributi në Treguesin e Rezultatit 3_1_30 të KBZhQ-së)

FAO ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, për të përgatitur një propozim të plotë të projektit për Fondin e Prshtatjes që synon rritjen e rezistencës klimatike të prodhimit bujqësor të Radovshit përmes ujitjes më të mirë, menaxhimit më të mirë tokës dhe ujit. Pritet që ky propozim, me një buxhet prej 9,9 milion dollarë, të dërgohet.

Në vitin 2022, UNDP-ja, IOM-i dhe UNECE-ja filluan fazën kryesore të realizimit të **Fondit të Klimës së Gjelbër**. Aktivitetet kryesore u përqendruan në zhvillimin e energjisë së ripërtërishme dhe mjeteve të efikasitetit energjetik dhe finalizimin e kornizës ligjore për krijimin e FKGj-së. Në vitin 2022, UNECE-ja përgatiti një rishikim dhe përditësim të Mjetit të përzgjedhjes së teknologjisë të FKGj-së për Maqedoninë e Veriut. Si një platformë online, ajo u mundëson përdoruesve të kenë qasje në një regjistër global të teknologjive të gjelbra. Ndër teknologjitë e përfshira aktualisht në platformë, bëjnë pjesë pompat termike me efikasitet energjetik dhe panelet diellore që prodhojnë energji të ripërtërishme, pastaj sistemet e ujitjes me pika dhe makinat e mbjelljes që mbështesin menaxhimin e qëndrueshëm të tokës. Më tej, UNECE-ja zgjodhi dy konsulentë për hartimin dhe zbatimin e trajnimeve dhe filloi me zhvillimin e kurrikulës së trajnimit për Konsulentët e projekteve dhe Konsulentët e verifikimit, të cilët nga ana e tyre do të mbështesin kompanitë në hartimin dhe verifikimin e projekteve të efikasitetit energjetik dhe energjive të ripërtërishme. Procesi i miratimit të marrëveshjes midis UNDP-së dhe BERZH-it është në fazë përfundimtare, ndërsa procesi i shqyrtimit me kujdesin e duhur i bankave pjesëmarrëse vendase ka përfunduar.

Në vitin 2022, UNICEF-i në partneritet me Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) ndihmoi me kontribute në zhvillimin e plan-programit të lëndës së Shkencave natyrore për klasat e 2-ta dhe të 5-ta në arsimin fillor. Përveç kësaj, UNICEF-i në partneritet me BZHA-në zhvilloi materiale mësimore për ndryshimet klimatike dhe edukimin për mjedisin jetësor me aktivitete për mësim përmes përvojës për arsimin parashkollor (kopshtet) dhe arsimin fillor. Materialet mësimore, të shoqëruara me video, u shërbejnë mësimit dhe edukatorëve për avancimin e edukimit për klimën dhe mjedisin jetësor në kopshte dhe shkolla.

Më tutje, UNICEF-i në partneritet me OShC-në "Shoqata e Ekologjisë së Maqedonisë" zhvilloi një kornizë për rrjetin e qendrave shkencore për të mbështetur zbatimin e plan-programeve shkencore në sistemin arsimor të bazuar në mësimin përmes përvojës. Qendrat shkencore që u përfshinë në zhvillimin e kornizës ishin: Instituti Hidrobiologjik - Ohër, Muzeu i Shkencave Natyrore - Shkup, Parku Kombëtar "Galiçica", Qendra arsimore "Negrevo" në Pehçevë, Teknika Kombëtare - Shkup, Kopshti Botanik i Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore - Shkup. U hartua dhe u zbatua komunikimi i bazuar në dëshmi për iniciativat zhvillimore për veprimet klimatike të udhëhequra nga të rinjtë. Ekipi i komunikimit i UNICEF-it arriti të përfshijë 140.929 njerëz, ndërsa 5.113 persona u angazhuan në mediat sociale me postime që lidhen me mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike.

UNIDO-ja arriti të miratojë rregulloren për llojet e kategorive të licencave për menaxhimin e mjeteve ftohëse dhe/ose produkteve që përbajnë mjete ftohëse; monitorimin dhe

kontrollin e përhershëm të konsumit të HCFC dhe substancave të tjera të kontrolluara nga Protokollin i Montrealit mbi substancat që e shtojnë shtresën e ozonit (vlerësimi i 50 licencave të importit); monitorimin e skemës së ripërtërjtjes dhe riciklitimit me 25.009,50 kg substanca të kontrolluara dhe pëzierjet e tyre të ripërtëritura dhe të ricikluara në vitin 2021; zhvillimin e një studimi mbi sasitë e mbeturinave ftohëse, duke përfshirë metodologjinë për të dhënat mbi mbeturinave nga mjetet ftohëse dhe zhvillimin e pajisjeve RAC të mbeturinave dhe pyetësorin në lidhje me ciklin jetësor të pajisjeve RAC. Në fazën II, UNIDO-ja e përfundoi rishikimin e legjislacionit aktual kombëtar dhe mbledhjen e të dhënave; vlerësimin e dyqaneve të servisimit që do t'u jepin pajisje për ripërtëritje dhe riciklim; vlerësimin e pajisjeve shtesë për dyqanet e servisimit; dhe listën e pajisjeve që do t'u jepin dyqaneve të servisimit.

UNIDO-ja kreu një vlerësim të teknologjisë klimatike për sektorin industrial; finalizoi zhvillimin e legjislacionit sekondar mbi Revizionet e Energjisë të Ndërmarrjeve të Mëdha me Ministrinë e Ekonomisë dhe Agjencinë e Energjisë të Maqedonisë së Veriut; përfundoi implementimin e sistemit të menaxhimit të energjisë (SME) dhe certifikimin e palëve të treta për ISO 50001 për kompleksin e ndërtesave të Qeverisë dhe Presidencës së Maqedonisë së Veriut; vazhdoi realizimin e mekanizmit të asistencës teknike dhe të mekanizmit të shpërbllimit financiar të bazuar në performancë; dhe e kreu vlerësimin përfundimtar të projektit dhe mbledhjen e të dhënave për vlerësimin e ndikimit të projektit.

Gjatë periudhës raportuese, **UNESCO-ja** punoi në koordinim me Komisionet Kombëtare të UNESCO-s të vendeve përfituese dhe vendeve pjesëmarrëse në Ballkanin Perëndimor për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve në fushën e ndryshimeve klimatike, menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen dhe promovimin e rezervave të biosferës dhe lokaliteteve të trashëgimisë botërore. Në veçanti, u zhvillua dhe u mbajt një program trajnimi për palët e interesuara përkatëse në lokalitetet e përcaktuara nga UNESCO, duke përfshirë tre sesione online të mbajtura midis 4 dhe 11 tetorit të vitit 2022 dhe një punëtori rajonale të mbajtur në Ohër, nga 17 deri më 21 tetor të vitit 2022. Trajnimi u ofroi pjesëmarrësve njohuri mbi identifikimin e të dhënave përkatëse për të zbatuar masat për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë (ZrRf) dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike (PNK), procedurat për vlerësimin e shpejtë të rreziqeve klimatike dhe fatkeqësive, dhe identifikimin e opsioneve për ZrRf dhe PNK. Trajnimi gjithashtu kontribuoi në krijimin e një rrjeti të njohurive, të përbërë nga profesionistë që punojnë në lokalitetet kulturore dhe natyrore në Evropën Juglindore, i cili pritet që, pas trajnimit, të vazhdojë të bashkëpunojë dhe të ndajë përvojat dhe zgjidhjet e ZrRf/PNK për ruajtjen e lokaliteteve të përcaktuara nga UNESCO.

JANË IDENTIFIKUAR DHE AVANCUAR ZGJIDHJET NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR, TË QËNDRUESHËM DHE GJITHËPËRFSHIRËS TË BURIMEVE NATYRORE (UJI, TOKA, PYJET DHE BIODIVERSITET)

Me mbështetje nga UNEP-i janë zhvilluar **Librat e parë Kombëtarë të Kuq të Zvarranikëve dhe Amfibëve**, duke i ndihmuar kështu politikën e ruajtjes së vendit, nevojat për informacione, analiza të e statusit, tendencat dhe kërcënimet ndaj këtyre specieve dhe katalizimin e veprimeve specifike për mbrojtjen e biodiversitetit. Iniciativa e vitit 2022 për valorizimin e pemëve të vjetra individuale me karakteristika të jashtëzakonshme natyrore dhe lokaliteteve me komunitete të rëndësishme bimore do ta përmirësojë **menaxhimin efektiv** në aspekt të zbatimit të masave të mbrojtjes për vlerat e tyre natyrore, shëndetësore dhe vlerat e tjera kulturore. **Procedura strategjike e vlerësimit të mjedisit jetësor për planin draft të menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit Sharrit** kontribuon në procesin e miratimit të një dokumenti të tillë të planifikimit, që paraqet një udhëzues për menaxhimin aktual të qëndrueshëm

të zonës dhe të vlerave të saj natyrore. Përveç **planit draft të menaxhimit të Liqenit të Ohrit**, rajoni do të marrë një mendim ekspertësh, gjegjësisht një **Studim të fizibilitetit të vlerave natyrore dhe kulturore**, që do t'i mbështesë më tej **proceset e vendimmarrjes në lidhje me planifikimin urban**, duke i mbrojtur në të njëjtën kohë vlerat unike të rajonit të Ohrit.

Pyjet e identifikuar me **vlerë të lartë natyrore** (të paktën 188, të përhapura në pothuajse 56.000 ha) me udhëzimet e propozuara për menaxhimin e pyjeve për dy zona pilot (Bukoviq dhe Bellasicë), si dhe përvojat e fituara përmes identifikimit të kuotave për produktet pyjore që nuk janë lëndë druri për speciet bimore të përzgjedhura që janë kryer gjatë disa viteve të fundit, do të shërbejnë si për menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre vlerave, ashtu edhe për identifikimin e praktikave specifike për menaxhim të qëndrueshëm të tokës (MQT)/menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve (MQP) që do të zbatohen gjatë vitit 2023/24 në komunat e synuara. Udhëzimet e përpiluara për zbatimin e masave/dizajnimin e korridoreve të gjelbër/korridorëve-bio për mishngrënësit e mëdhenj (veçanërisht rrëqebulli i Ballkanit dhe ariu i murrëmë) gjatë ndërtimit të projekteve të reja të infrastrukturës, pritet të kontribuojnë në rritjen e sigurisë së trafikut dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

Analiza ligjore dhe institucionale në sektorin e tokës, e përgatitur në vitin 2022 me mbështetjen e OKB-së, e përcakton **bazën për zhvillimin e Strategjisë së parë Kombëtare për Mbrojtjen e Tokës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Tokës**, që paraqet përparim në rregullimin e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës në vend. Paralelisht, filloi rishikimi dhe përditësimi i Planeve lokale të veprimit të mjedisit jetësor dhe planeve të erozionit të tokës të komunave të synuara (Haraçinë, Gazi Babë, Likovë, Zhelinë, Saraj dhe Jegunovcë) me objektivin kryesor për të kontribuar në **menaxhimin e qëndrueshëm të tokës (MQT) dhe kontrollin e erozionit**. Të njëjtat komuna vazhdojnë të punojnë me ekspertë kombëtarë në vlerësimin e **ekosistemit (shërbimeve) të pyjeve dhe të kullotave**, për të kontribuar në menaxhimin e qëndrueshëm të tokës (MQT) dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve (MQP) në rajon. Këto rezultate, si dhe mësimet e nxjerra nga aktivitetet e ndryshme të ngritjes së kapaciteteve (gjashtë roje të pyjeve/përfaqësues të zonave të mbrojtura, 16 përfaqësues të shoqatave bjeshkatere dhe 20 gra lokale), gjithashtu e hapin rrugën në përshtatjen e suksesshme dhe zbatimin e programit të trajnimit për MQT/MQP/NDT për institucionet kombëtare dhe lokale për aplikimin e metodave, qasjeve dhe praktikave në ndalimin dhe rikthimin e degradimit dhe shpyllëzimit të tokës. **Raporti i parë Kombëtar për Konventën e OKB-së për Luftën kundër Shkretëtirizimit (UNCCD)** paraqet një pasqyrë të të dhënave të mbledhura biofizike dhe socio-ekonomike të nevojshme për zhvillimin e një sistemi të fortë të monitorimit dhe raportimit në UNCCD, që do të strukturohet për t'i shërbyer nevojave kombëtare të DT dhe statistikave, si dhe për t'u përgjigjur detyrimeve të Maqedonisë së Veriut që rrjedhin nga konventat e ratifikuara ndërkombëtare.

UNDP-ja gjithashtu mbështeti zhvillimin e një studimi të fizibilitetit për **përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit në pellgun e lumit Bregallnica**.

Gjatë vitit u mblodhën të dhëna dhe informacione për intervenimet e planifikuara në **rajonin e Prespës** dhe u zhvilluan konsultime me aktorët kryesorë në nivel qendror dhe lokal për prioritetet në fushën e bujqësisë, turizmit, menaxhimit të ujit dhe të mbeturinave, si dhe për bashkëpunimin ndërkufitar. Dokumenti draft i veprimit për Programin e BE-së për Prespën është dërguar në Delegacionin e BE-së në Shkup, dhe kanë filluar negociatat. Nënshkrimi i marrëveshjes me BE-në dhe fillimi i Programit pritet në tremujorin e dytë të vitit 2023.

JANË PËRFORCUAR KAPACITETET NË NIVELIN QENDROR DHE LOKAL PËR TË PARANDALUAR DHE T'U PËRGJIGJUR NDAJ KËRCËNIMEVE TË NDOTJES TË AJRIT DHE PASOJAVE SHËNDETËSORE NË KOMUNITETET MË TË CENUESHME.

Në vitin 2022, **UNDP-ja** e pilotoi skemën e mbështetjes për përmirësimin e efikasitetit energjetik në ndërtesat e banimit, e cila u dëshmuar të jetë efektive në zvogëlimin e ndotjes së ajrit, me 41% ulje të grimcave PM10 (60,359 µg/m³ në vitin 2020 kundrejt 35,5 µg/m³ në vitin 2021) në këtë fushë, dhe me ulje të emetimeve ndotëse prej 60% (5,56 t në vitin 2021 kundrejt 2,23 t në vitin 2021). 129 amvisëri dhe familje me të ardhura të ulëta nga Lisiçja u mbështetën për t'i zëvendësuar pajisjet joefikase të ngrohjes dhe për t'i zbatuar masat e efikasitetit energjetik (përshtatja e kulmit/fasadës, zëvendësimi i dritareve të vjetra/dyerve të hyrjes), dhe 270 familje të tjera të cenushme në aspekt socio-ekonomik në Shkup u mbështetën për të zëvendësuar pajisjet e tyre të vjetra të ngrohjes. Mbështetja e Qeverisë në transpozimin e pjesëve përkatëse të legjislacionit sekondar duke përgatitur 23 tabela korresponduese për Rregulloren për Shënimin e Produkteve të Lidhura me Energjinë dhe Rregulloren draft për Cilësinë e Lëndëve Djegëse Ngurta duhet të kontribuojnë në zvogëlimin e ndotjes së ajrit në të gjithë vendin duke i detyruar operatorët e tregut të vendosin soba të reja efikase në treg.

Të dhënat nga monitorimi dhe modelimi që u bë si pjesë e zhvillimit të Studimi i Ndarjes së Burimeve të Ndotjes për aglomeratin e Shkupit siguroi bazën për një Plan të Veprimit për Qytetin e Shkupit të bazuar në informata, i cili duhet të mbledhë së bashku aktorë të shumtë për të zbatuar veprimet dhe masat e nevojshme që do të zvogëlojnë ndotjen e ajrit në qytet. Platforma online që u krijua do të lehtësojë dialogun midis qeverisë, shoqërisë civile, sektorit privat në identifikimin e pengesave dhe në kërkimin e zgjidhjeve konsensuale që do t'i trajtojnë problemet në afat të mesëm dhe të gjatë.

UNDP-ja i ka shtuar aktivitetet për zvogëlimin e ndotjes së ajrit në pesë komuna të reja (Kumanovë, Kavadar, Gostivar, Strumicë dhe Strugë) me burime të reja të mobilizuara. Kjo duhet të rezultojë me përforcimin e kapaciteteve të tyre për të parandaluar dhe për të reaguar ndaj ndotjes së ajrit. Kapaciteti mobilizues i botës akademike dhe i organizatave të shoqërisë civile do të vazhdojë të shfrytëzohet për të krijuar zgjidhje dhe për të ndihmuar në ndryshimin e sjelljes së publikut.

NË PËRPTHJE ME KORNIZËN SENDAI JANË PËRFORCUAR KAPACITETET NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL PËR T'Ë IDENTIFIKUAR RREZIQT E SHUMTA DHE PËR TË PLANIFIKUAR, FINANCIUAR DHE REALIZUAR ZVOGËLIMIN E DHE PËRGJIGJEN EFEKTIVE NDAJ RREZIKUT NGA FATKEQËSITË, DUKE PËRFSHIRË EDHE ZHVENDOSJEN E NJERËZVE,

Me mbështetjen e **OBSH-së** dhe në bashkëpunim me partnerët, u krijuan operacione strategjike të inteligjencës së shëndetit publik në të gjitha strukturat e shëndetit publik anembanë vendit (Qendra operative për reagim në rast të emergjencave të shëndetit publik dhe Rrjeti funksional i laboratorëve të digjitalizuar të shëndetit publik). Me përfshirjen e Institucionit Ndërkombëtar të Ekspertëve - Epikoncept, Qeveria përshtati një Program të trajnimit për epidemiologjinë në terren (PTEF) dhe duke i përforcuar kapacitetet e 8 epidemiologëve të lartë, janë trajnuar 48 epidemiologë nga i gjithë vendi për epidemiologjinë në terren, vlerësimin e rrezikut, reagimin e shpejtë në rast të shfaqjes së epidemive, përdorimin e sistemit të ri të digjitalizuar të mbikëqyrjes, analizën e të dhënave dhe menaxhimin e emergjencave. Ky trajnim do të fillojë të realizohet dhe do të kontribuojë për përforcimin e kapaciteteve të vendit për zbulimin e shpejtë të patogjenëve dhe reagimin më të mirë ndaj pandemive, epidemive dhe emergjencave të tjera shëndetësore në të ardhmen në përputhje me OZHQ 3.d. Përforcimi i kapaciteteve të të gjitha vendeve, në veçanti i vendeve në zhvillim, për paralajmërimin e hershëm, zvogëlimin e rrezikut dhe menaxhimin e rreziqeve shëndetësore kombëtare dhe globale. MSH-ja së bashku me Laboratorin Kombëtar të Institutit të Shëndetit Publik, me mbështetjen e

OBSH-së dhe të USAID-it, zhvilluan një Sistem të Menaxhimit të Informacionit të Laboratorit të Shëndetit Publik (SMIL), i cili kontribuoi për ndjekjen dhe ruajtjen e të dhënave në kohë reale dhe përmirësimin e menaxhimit dhe raportimit të të dhënave të laboratorëve të mikrobiologjisë. Softueri SMIL do t'u ndihmojë profesionistëve shëndetësorë që të arrijnë kontroll efektiv të cilësisë dhe që të sigurojnë sigurinë dhe pajtueshmërinë e pacientit duke i përmbushur kërkesat e rrepta rregullatore. Ky veprim kontribuon për OZHQ 3.d Përforcimi i kapaciteteve të të gjitha vendeve, në veçanti i vendeve në zhvillim, për paralajmërimin e hershëm, zvogëlimin e rrezikut dhe menaxhimin e rreziqeve shëndetësore kombëtare dhe globale. MSh-ja me mbështetjen e OBSH-së rriti kapacitetin e 3 spitaleve klinike dhe 8 reparteve të ridestinuara të spitaleve që kishin mungesë të pajisjeve për monitorim dhe kujdes intensiv në rajonet më të goditura të vendit, duke dhuruar 50 monitorë të pacientëve me 6 ventilatorë me presion pozitiv (BiPAP) dhe 4.600 maska të oksigjenit dhe mundësoi terapinë e duhur të oksigjenit për pacientët me COVID-19, me sëmundje të rënda të frymëmarrjes.

Në vitin 2022, përmes mbështetjes së UNDP-së, në përputhje me Direktivën Kornizë të Ujërave të BE-së, janë zhvilluar modele hidrologjike dhe hidraulike të nivelit të lartë dhe harta të rrezikut nga përmblytjet në pellgun e lumit Drin, të shoqëruara me një vlerësim gjithëpërfshirës socio-ekonomik dhe të cenueshmërisë së komuniteteve që jetojnë brenda pellgut. Kjo rezultoi me identifikimin e masave dhe aktiviteteve më të përshtatshme për zbutjen e rrezikut nga përmblytjet. Për herë të parë pas më shumë se 40 vitesh, janë iniciuar masa serioze për rehabilitimin e pjesëve kritike të shtratit të lumit Sateska, duke përfshirë devijimin e tij në shtratin e vjetër të lumit. Pasi të përfundojë, kjo masë strukturore do të zvogëlojë ndjeshëm rrezikun e përmblytjeve për komunitetet përgjatë lumit Sateska.

Është përmirësuar përgatitja për reagim efektiv ndaj fatkeqësive i agjencive përkatëse të emergjencave dhe institucioneve të tjera lokale në rajonin e Pollogut përmes sigurimit të pajisjeve, organizimit të ushtrimeve për të testuar kapacitetet e tyre për t'u përgjigjur me efikasitet përmblytjeve të mëdha. Është përgatitur koncepti draft për krijimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm në rajonin e Pollogut dhe ai pritet të jetë funksional deri në fund të vitit 2023. Anëtarët e Rrjetit të rezistencës së Pollogut morën pjesë në një udhëtim studimor në Krlevë të Serbisë, dhe patën mundësi të mësojnë nga përvoja e agjencive të emergjencës dhe pushteteve lokale rreth masave që ata i zbatojnë për të zvogëluar rrezikun e fatkeqësive në komunën e tyre. Është përvijuar një strategji në nivel kombëtar për zbutjen e rrezikut nga përmblytjet, duke krijuar kështu një bazë për planifikim më të mirë dhe priorizim të investimeve në masat e rrezikut nga përmblytjet në mbarë vendin. Është përgatitur rregullorja draft për përgatitjen e planeve komunale për mbrojtjen nga përmblytjet, dhe pasi të miratohet nga Ministri i mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor do të jetë një mjet për gatishmëri më të mirë të komunave për të parandaluar dhe reaguar ndaj përmblytjeve në nivel lokal. U zhvillua dhe u pilotua Udhëzuesi për integrimin e reduktimit të fatkeqësive në planifikimin urban për planin e detajuar urbanistik të fshatit Kamjan.

U bënë investime për reduktimin e rrezikut nga përmblytjet në të gjithë rajonin e Pollogut. Më shumë se 40 hektarë tokë erozive u pyllëzuan/ripyllëzuan në Parkun Kombëtar të Malit të Sharrit. U rindërtua shtrati i lumit të Bogovinës dhe u pastrua rrjeti i ujërave atmosferikë në Gostivar duke e zvogëluar rrezikun e përmblytjeve urbane.

UNDRR-ja mbështeti përforcimin e vendimmarrjes së bazuar në dëshmi për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë përmes futjes në përdorim të modelit të indeksit nën-kombëtar të të rrezikut INFORM, hartëzimin e cenueshmërisë, ekpozimin dhe kapacitetet e përbaljes së subjekteve nën-kombëtare në Maqedoninë e Veriut dhe të rajonit më të gjërë të Evropës Juglindore. Zbatimi i modelit të indeksit nën-kombëtar të rrezikut u bë në bashkëpunim me Pikat kombëtare të kontaktit

të Sendait dhe me Qendrën e Hulmtimeve të Përbashkëta të Komisionit Evropian, me mbështetjen financiare të USAID-it, ndërsa rezultatet janë në dispozicion në internet.

JANË PËRFORCUAR KAPACITETET KOMBËTARE DHE LOKALE, DHE ËSHTË NGRITUR VETËDIJA PËR ZVOGËLIMIN E MBETURINAVE DHE MENAXHIMIN EFIKAS TË MBETURINAVE (KIMIKE, TË UJIT, MBETURINAVE KOMUNALE, MBETURINAVE TË RREZIKSHME, MBETURINAVE MJEKËSORE – DUKE PËRFSHIRË ZONAT RURALE)

Në vitin 2022, UNOPS-i filloi aktivitetet e rehabilitimit. Gërmimet kanë nisur në qershor dhe deri në fund të dhjetorit, 480,25 tonë mbeturina HCH janë gërmuar, paketuar dhe transportuar në Francë.

UNIDO-ja përfundoi blerjen e pajisjeve laboratorike dhe materialeve harxhuese për rritjen e kapaciteteve analitike të dy laboratorëve për bio-monitorimin ekologjik dhe njerëzor; aktivitetet për rregullimin e vendit, d.t.th. rrethimin, zonimin dhe shënimin e vendit; vendosjen e një kabine për strehim dhe mbrojtje për personelin e sigurisë ose personelin tjetër të vendosur në pikën e kontrollit ose portën hyrëse; instalimin e kompresorëve për presion negativ dhe sistemin e pastrimit të ajrit; shpërndarjen e pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme (fuçive dhe kontejnerëve të miratuar nga OKB-ja; pajisjet personale mbrojtëse; rezervuarët e grumbullimit të ujërave të zeza dhe njësjia e filtrimit të ujërave të zeza; njësitë e dekontaminimit për punëtorët; instrumentet e monitorimit të ajrit; një instrument dore për analizat e tokës (XRF); makineri (rrip transportues me hinkë të montuar; kamionë, buldozerë, vinça, etj.). Janë gërmuar, paketuar, eksportuar dhe të shkatërruar sasitë e parashikuara prej 477,1 tonë mbeturina të HCH-së., ndërsa 126,37 tonë tokë e kontaminuar me HCH, janë gërmuar, paketuar dhe ruajtur përkohësisht në pritje të eksportimit, nga të cilat rreth 20 tonë janë eksportuar para do kohësh. Bio-monitorimi ekologjik dhe njerëzor është kryer rregullisht dhe rezultatet e tyre nuk i tejkalonin vlerat kufitare, që konfirmon se karakteristikat e sigurisë së pajisjeve të instaluara dhe procedurat dhe standardet e zbatuara të sigurisë gjatë aktiviteteve të rehabilitimit të lokacionit e minimizojnë dhe e eliminojnë rrezikun për mjedisin jetësor dhe njerëzit.

IOM-i mbështeti shëndetin dhe higjienën e emigrantëve të cenueshëm dhe infrastrukturën e pastrimit të mjedisit përmes qasjes në ujë cilësor dhe menaxhimin të ujërave të zeza në qendrat e pranimit të emigrantëve, duke përfshirë mbledhjen e mbeturinave dhe asgjësimin adekuat.

ITU-ja, UNEP-i dhe UNITAR-i filluan punën në Monitorin e e-mbeturinave, përmes trajnimeve, pyetësorëve dhe diskutimeve, si dhe përmes hulumtimeve dhe mbledhjes së të dhënave/statusit të legjislacionit për e-mbeturinën, statistikave dhe menaxhimin në nivel kombëtar. Këto aktivitete u zhvilluan në partneritet të ngushtë me partnerët kombëtarë.

REZULTATI 4

Qeverisja e mirë



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga sundimi i përmirësuar i ligjit; politikat e bazuara në dëshmi, të parashikueshme dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë; nga kohezioni më i madh shoqëror; dhe ofrimi efektiv i shërbimeve nga institucione transparente, llogaridhënëse dhe të përgjegjshme



The first Resource Center on gender-responsive policymaking and budgeting was promoted in North Macedonia, under the leadership of MLSP and thanks to the continued support by Sweden and Switzerland-SDC. The Centre will further advance the Government's gender equality commitments and will provide opportunities for continued exchange, learning and replication of good practices, not only in the country but across the region. The role of public administration is crucial in developing policies and programmes that are responsive to the needs of women and men in society. *Credit: UN Women*



ËSHTË PËRMIRËSUAR SUNDIMI I LIGJIT, QASJA NË DREJTËSI DHE MBROJTJA DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT PËR TË GJITHË, VEÇANËRISHT I ATYRE TË LËNË PAS, PËRMES KORNIZAVE LIGJORE GJITHËPËRFSHIRËSE DHE TË PËRGJEGJSHME NË ASPEKT GJINOR, POLITIKAVE DHE KORNIZAVE INSTITUCIONALE DHE NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË PËRFORCUARA

Gjatë gjithë vitit 2022, OKB-ja mbështeti partnerët kombëtarë për të përshpejtuar reformat politike, ligjore dhe institucionale kritike për anëtarësimin në BE dhe arritjen e OZHQ-ve. Duke përfutur nga avantazhi i tyre krahasues dhe komplementariteti i tyre, agjenci të shumta të OKB-së kontribuan në harmonizimin e ligjeve dhe politikave kombëtare me legjislacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, duke u përqendruar te njerëzit në rrezik ose ata të lënë pas.

UNICEF-i filloi një transformim të madh të drejtësisë për fëmijët në një sistem jo ndëshkues dhe restaurues (të rikthimit). Ndryshimet në Kodin Penal për dhunën ndaj fëmijëve, Ligjin për Drejtësi për Fëmijët dhe Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve u hartuan për të siguruar një sistem të drejtësisë që i jep përparësi mbrojtjes dhe zhvillimit të fëmijëve që janë në konflikt me ligjin. Reformat u mbështetën përmes zhvillimit dhe miratimit të Strategjisë ndërsektoriale për Parandalimin dhe Drejtësinë për Fëmijët për periudhën 2022-2026, të hartuar me pjesëmarrjen e fëmijëve, së bashku me analizën

e shpenzimeve me rekomandime për alokime adekuate dhe të barabarta buxhetore, ngritjen e kapaciteteve, vetëdijësimin dhe përfaqësimin. U hartua një kornizë e përbashkët për trajnime të standardizuara për të gjithë profesionistët që merren me fëmijët në rrezik, dhe fëmijët në konflikt dhe në kontakt me ligjin. Mbi 800 profesionistë u përfshinë në aktivitete të ndryshme të ngritjes së kapaciteteve, si .psh., në zbatimin e qasjes që i merr parasysh nevojat e atyre që kanë përjetuar/përjetojnë traumë, punën multisektoriale në sistemin J4C, krijimin e modelit Barnahus. 150 prej tyre u trajnuan për zbatimin e qasjes që i merr parasysh nevojat e atyre që kanë përjetuar/përjetojnë traumë, ndërsa 200 u trajnuan për punë multisektoriale. Grupet e synuara përfshinin gjykatës, prokurorë, ndërmjetësues, avokatë, punonjës socialë, punonjësit për mbështetje profesionale të shkollave dhe punonjësit në shtëpitë me grupe të vogla, punonjësit në institucionet edukuese-korrektuese dhe në burgjet për të mitur. UNICEF-i ka përpunuar pesë programe për rehabilitimin, riintegrimin dhe risocializimin e këtyre fëmijëve të cenusëm.

Masat specifike që rrjedhin nga Strategjia e Reformës së Sektorit Gjyqësor (2017-2022) u zbatuan me mbështetjen e UNOPS-it. Ato lidhen me zbatimin e Konventave të Hagës për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar në Çështjet Civile (HCCH) nga gjyqtarët, avokatët dhe profesionistët e mbrojtjes sociale. Është përgatitur Ligji i Procedurës Civile dhe ndryshimet në Ligjin për Përgjegjësi Qytetare për Shpifje dhe Fyerje, së bashku me partnerët kombëtarë. Janë hartuar njëmbëdhjetë

akte nënligjore për zbatimin e Ligjit të Prokurorisë Publike, shtatë nga të cilat u miratuan, duke përfshirë edhe rregulloren për bashkëpunimin e institucioneve me EUROJUST-in.

Së bashku me partnerët kombëtarë dhe agjencitë e tjera të OKB-së, **OHCHR-ja kontribuoi për harmonizimin e politikave dhe legjisllacionit me të drejtat e njeriut.** Është miratuar Ligji për Kompensimin e Viktimave të Veprave Penale të Dhunshme, Strategjia e Barazisë dhe Mosdiskriminimit 2022-2026, dhe ndryshimet në Kodin Penal për sa i përket dhunës ndaj grave dhe fëmijëve. Institucionet u mbështetën për të përfshirë mekanizmat e të drejtave të njeriut të OKB-së, veçanërisht për përgatitjen e raportit periodik shtetëror në kuadër të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR). IKNDNJ-të, organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe shoqëria civile përfituan nga pjesëmarrja në konsultimet tematike rajonale, ndër të tjera, për rishikimin dhe zhvillimin e komenteve të përgjithshme për KDPAK-në.

UN Women kontribuoi në disa arritje kyçe mbi barazinë gjinore, që u arritën së bashku me partnerët kombëtarë. Ato përfshijnë Strategjinë e re Kombëtare për Barazinë Gjinore (2022-2027), e cila përcakton 17 qëllime specifike dhe e thekson rëndësinë e financimit adekuat për barazinë gjinore dhe Ligjin për Buxhetin që e përfshin barazinë gjinore midis parimeve kryesore buxhetore të tij dhe përcakton dispozita që kërkojnë nga përdoruesit e buxhetit të marrin parasysh prioritetet e barazisë gjinore në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit. Programi i ri i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (2022-2025) i zhvilluar nga Ministria e Financave, parashikon etiketimin gjinor të programeve buxhetore (duke kontribuar në OZHQ 5.c.; OZHQ 16.6). Indeksi i dytë i Barazisë Gjinore (2022) u zhvillua në bashkëpunim me EShS-në, sipas të cilin Maqedonia e Veriut ka 64,5 pikë, që paraqet një rritje prej 2,5 pikësh në krahasim me indeksin e mëparshëm.

Janë bërë përparime të rëndësishme në përfshirjen e aftësisë së kufizuar. UNICEF-i, UNDP-ja, UNFPA-ja dhe OHCHR-ja e mbështetën zhvillimin e një Strategjie të re për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2023-2030. Konsultimet me personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese dhe shoqërinë civile mundësuan që të dëgjohet zëri i tyre. OHCHR-ja e mbështeti Avokatin e Popullit për të udhëhequr një dialog nën-rajonal mbi praktikën më të mira në monitorimin e zbatimit të KDPAK-së, duke përfshirë 120 palë të interesuara nga Ballkani Perëndimor dhe vendet e BE-së, dhe Komitetin e KDPAK-së. Përmes avokimit të përbashkët, 100 njerëz të marginalizuar u ndërgjegjësuan për të drejtat e tyre dhe rrugët që i kanë në dispozicion për të kërkuar mbrojtje, për qasje në drejtësi dhe për mjete efektive ligjore.

Avokimi dhe angazhimi strategjik i UNHCR-së rezultoi në përmirësimin e kapaciteteve dhe kornizës për mbrojtjen ndërkombëtare të personave të zhvendosur dhe ndihmën juridike falas. Në vitin 2022, kishte 27.425 të persona të rinj që erdhën në vend, dhe gjithsej 168 kërkesa për azil, me ç'rast për më pak se 1% të tyre vendimet u morën në bazë të meritës. UNHCR-ja realizoi 162 ndërhyrje avokuese dhe ofroi këshilla ekspertësh në 39 raste për të harmonizuar kornizën ligjore dhe praktikën kombëtare me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes. Në kontekstin e fluksit të refugjatëve nga Ukraina, qeverisë iu rekomanduan plane të reagimit. Avokimi i përforcuar dhe partneritetet **për t'i dhënë fund problemit të njerëzve pa shtetësi deri në vitin 2024 rezultuan me një Udhërrëfyes** që i përshkruan hapat kryesorë që duhet të ndërmerren për një zgjidhje sistemore, duke i përfshirë ndryshimet në Ligjin për Evidencën Amë. Gjithsej 190 njerëzve, shumica e të cilëve të ndihmuar drejtpërdrejtë nga UNHCR-ha dhe SHJRM-ja, u është dhënë shtetësia në bazë të ndryshimeve të Ligjit për Shtetësinë.

UNODC-ja vazhdoi përforcimin e kapaciteteve kombëtare në luftën kundër krimit të organizuar. Profesionistët e drejtësisë penale rritën njohuritë dhe aftësitë për hetimin, ndjekjen

penale dhe gjykimin e rasteve të trafikimit të paligjshëm të drogës dhe armëve, trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabandës së emigrantëve dhe financimit të paligjshëm të terrorizmit. 30 përfaqësues të agjencive të ndryshme dhe 12 prokurorë dhe gjyqtarë u njohën me rreziqet strategjike për sigurinë, duke përfshirë terrorizmin dhe kërcënimet e lidhura me krimin e organizuar transnacional dhe korrupsionin. 36 palë të interesuara përmirësuan të kuptuarit e tyre për boshllëqet sistematike dhe faktorët e rrezikut të trafikimit të qenieve njerëzore duke u bazuar në analizën e 13 rasteve të trafikimit, diskutimet e vlefshmërisë dhe përgatitjen e raportit kombëtar. Këto përpjekje siguruan informata për ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të Ligjit të Procedurës Penale, punëtorinë multidisiplinare për 55 përfaqësues kombëtarë, si dhe prezantimin e raportit "Shkalla dhe Përmasat e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Evropën Juglindore".

IOM-i i mbështeti ekipet e lëvizshme për identifikimin, referimin dhe ndihmën për viktimat e trafikimit dhe kontrabandimit të emigrantëve. U arritën të kontaktohen 691 persona të rrezikuar, nga të cilat 13 viktimat e trafikimit (VT) dhe 142 viktimat të mundshme të trafikimit. Pothuajse 80% e VT-ve të identifikuara ishin gra dhe vajza, të mitur dhe shtetas të vendit, kryesisht të trafikuar për shfrytëzim seksual, shfrytëzim për punë dhe martesë të detyruara.

JANË PËRFORCUAR KAPACITETET E AUTORITETEVE QENDRORE DHE LOKALE PËR TË PLANIFIKUAR, BUXHETUAR, MONITORUAR DHE NDJEKUR MË MIRË SHPENZIMET DHE PËR TË SHFRYTËZUAR BURIMET, SI DHE PËR TË PËRMIRËSUAR DIZAJNIMIN DHE OFRIMIN EFIKAS TË SHËRBIMEVE PUBLIKE CILËSORE

UNOPS-i kontribuoi në përmirësimin e kapaciteteve kombëtare mbi integrimin në BE-në, politikën e BE-së dhe procesin e negociatave. U trajnuan 500 nëpunës administrativë nga Kuvendi dhe institucionet kryesore ekzekutive, të tilla si SÇE-ja, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave, Drejtoria e Zbulimit Financiar dhe të tjera. Portali i NPPA-së dhe zgjidhjet digjitale i lidhën institucionet e përfshira në procesin e negociatave evropiane në një sistem të vetëm. Përgatitjet e legjisllacionit të BE-së në gjuhën maqedonase u përshpejtuan me ofrimin e shërbimeve të përkthimit, redaktimit teknik, rishikimit gjuhësor dhe lekturimit. U përgatitën analiza të ndryshme të politikave, procedura standarde operative, studime bazë, raporte dhe doracakë për të mbështetur SÇE-në dhe qeverinë në marrjen e vendimeve në bazë të informatave në procesin e anëtarësimit.

UNDP-ja e mbështeti pushtetin qendror dhe lokal në reformat e menaxhimit të financave publike. Fokusi ishte në zbutjen e efekteve negative të krizës shumëdimensionale, por edhe në përforcimin e rezistencës institucionale ndaj tronditjeve të mundshme në të ardhmen. Ndryshimet e bëra në Ligjin për Financimin e NJVL-ve prezantuan mekanizma të rinj për financimin lokal. U zhvilluan mjete digjitale për decentralizim dhe ekonominë joformale për MVL-në dhe MF-në, respektivisht. U krijua Fondi i Bazuar në Performancë dhe Fondi për Barazim dhe u përditësua një platformë shtesë për mbledhjen e tatimeve komunale. **UNDP-ja gjithashtu e përditësoi Indeksën e Zhvillimit komunal (IZHK),** i cili u rillogarit me të dhënat e Regjistrimit të popullsisë të vitit 2021. Si rezultat i kësaj, 50 komuna kanë instaluar dhe publikojnë rregullisht informacionin e tyre financiar në e-Tabelën me të dhëna. Modeli i e-komunës është implementuar në 19 komuna. Pesë komuna të tjera (ose gjithsej 46) u mbështetën për të raportuar përmes e-tabelës me të dhëna për ekzekutimin e buxhetit komunal. U arritën rezultate të dukshme në ofrimin e shërbimeve të përqendruara të njerëzimit

dhe me cilësi më të mirë - shtatë komuna përfituan nga bashkëpunimi ndërkomunal, duke përfshirë digjitalizimin, përmes të cilit i ulën shpenzimet dhe e përmirësuan cilësinë e shërbimeve; 30 komuna i përmirësuan shërbimet e zjarrfikësve, 17 njësi zjarrfikëse, që mbulojnë territorin e 46 komunave u pajisën me automjete dhe pajisje; tre komuna rurale e pilotuan një model të partneritetit publiko-privat për menaxhimin e bio-mbeturinave për të rritur të ardhurat; dhe shtatë komuna përfituan nga Fondi i Dokumentacionit Teknik i harmonizuar të OZHQ-të. Vazhdoi të zbatohet skema e granteve komunale, përmes të cilës u mbështetën projektet prioritare të komunitetit të përzgjedhura përmes konsultimeve publike në 40 komuna. Më shumë se 170 këshilltarë dhe nëpunës shtetërorë nga 10 komuna i përforcuan kapacitetet e tyre në ushtrimin e kompetencave të tyre vendimmarrëse, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese në nivel lokal.

Si rezultat i mbështetjes së UN Women, institucionet kryesore qeveritare e integruan gjininë dhe e harmonizuan planifikimin dhe programimin e tyre me legjislacionin e BE-së për barazinë gjinore. SÇE-ja dhe Grupet sektoriale të punës, si subjekte udhëheqëse dhe koordinuese në procesin e anëtarësimit në BE, zhvilluan disa pjesë të punës së tyre në lidhje me integrimin në BE. Gjithashtu, njësitë e dedikuara për IPA në kuadër të ministrive dhe institucioneve publike arritën të kuptonin më mirë integrimin gjinor në proceset e IPA-s. Qëndrueshmëria dhe ndjenja e pronësisë lokale për proceset e integritit gjinor u arrit me krijimin e liderëve të barazisë gjinore në 7 institucione, të cilët e përfunduan me sukses trajnimin e parë të trajnuesve. U identifikuan gjeneruesit kryesorë të të dhënave administrative gjinore, si dhe disponueshmëria e të dhënave të ndara sipas gjinisë, përmes hartëzimit të treguesve gjinorë të OZHQ-ve në të gjithë sistemin statistikor. Për më tepër, u zhvilluan dy module për trajnimin e stafit të IPA-s, duke u bazuar në gjetjet dhe nevojat e hartuara të administratës për integrimin gjinor. Përveç kësaj, u hartuan dy propozim-ligje të administratës publike, krahas Programit 5-vjeçar të Entit Shtetëror të Statistikave. U identifikuan trendet 20-vjeçare përmes analizës së trendit të botimeve "Gratë dhe Burrat"; përmes analizës së kryer u përgatitën rekomandime se si të përmirësohet barazia gjinore në sport. Stafi i administratës publike nga 16 institucione, si dhe përfaqësues nga institucione të ndryshme në sistemin statistikor u trajnuan për shfrytëzimin e statistikave gjinore dhe u aftësuan për të kryer analiza gjinore.

UN Women kontribuoi në përmirësimin e mbikëqyrjes publike mbi politikën e përgjegjshme gjinore. Enti Shtetëror i Revizionit u aftësua për të integruar perspektivën gjinore në praktikën e revizionit. Si rezultat i kësaj, ESHR-ja e përfundoi Revizionin e parë të performancës për barazinë gjinore si një hap i rëndësishëm përpara për të siguruar një mbikëqyrje të pavarur të shpenzimeve publike dhe për të përforcuar llogaridhënien e institucioneve për të avancuar barazinë gjinore, e po ashtu përpiloi edhe një Udhëzues Metodologjik për Integrimin Gjinor në Praktikën e Revizionit. UN Women i lehtësoi diskutimet midis Komisionit Parlamentar për Mundësi të Barabarta dhe Klubit të deputeteve për përfaqësim dhe lobim për politika dhe buxhete të përgjegjshme gjinore. Komisioni mbajti dy debate publike, një për integrimin e gjinisë në Propozim-ligjin për Buxhetin dhe i dyti për Strategjinë e re Kombëtare për Barazinë Gjinore (2022-2027) (OZHQ5; OZHQ 16). 169 përfaqësues nga 13 institucione shtetërore i përforcuan kapacitetet e tyre përmes Qendrës së Burimeve të MPPS-së për Politikën dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor. Në vitin 2022, 11 ministri dhe institucione shtetërore e integruan gjininë dhe siguruan alokime specifike të buxhetit në kuadër të programeve të përzgjedhura sektoriale. 307 përfaqësues (212 nëpunës publikë dhe 95 këshilltarë komunalë) u trajnuan për BPGj dhe BGj. Si rezultat i kësaj, u krijuan 67 programe dhe 357 masa në nivel lokal që i adresojnë nevojat e grave dhe më të rrezikuarve.

Në nivel lokal, Komuna e Kriva Pallankës u mbështet për të zhvilluar Strategjinë e saj të parë të Përgjegjshme Gjinore për Zhvillimin Lokal (2022-2025).

UNICEF-i kontribuoi në transformimin e rrjetit të shkollave fillore dhe për alokime buxhetore, me qëllim të përmirësimit të shpenzimeve publike për fëmijët. U punua për ngritjen e kapaciteteve dhe avokimin në nivel kombëtar dhe komunal, për të siguruar se të gjitha shkollat fillore të mund të ofrojnë arsim me cilësi të mirë dhe se alokimet e mjeteve bazohen në kriteret objektive dhe se janë të barabarta. Formula e re dhe mekanizmi i financimit për arsimin fillor u miratuan publikisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave. Mbështetje iu ofrua MASH-it dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit për të rishikuar standardin. Përveç kësaj, UNICEF-i përgatiti vlerësimin bazë të **përshtatshmërisë së financimit** të drejtësisë për fëmijët. Kjo u ndihmoi institucioneve kombëtare dhe lokale për ndjekjen, planifikimin dhe ekzekutimin më të mirë të shpenzimeve lidhur me drejtësinë për fëmijët dhe programet parandaluese. Gjetjet e Analizës për Gjendjen e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve u përdorën për përfaqësim dhe konsultime të gjera për krijimin e një sistemi të monitorimit në sektorë të ndryshëm që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve.

Konferenca e nivelit të lartë mbi "Menaxhimin e Qëndrueshëm të Migracionit në Ballkanin Perëndimor", që u mbajt më 15-16 nëntor të vitit 2022, e mbështetur nga IOM-i, rezultoi me një Deklaratë për të përforcuar bashkëpunimin nën-rajonal në adresimin e kontrabandës së emigrantëve dhe trafikimit të personave, veçanërisht duke e përmirësuar qasjen në rrugë të rregullta për emigrantët dhe nxitjen e përfshirjes sociale, ripranimit dhe praktikave dhe procedurave të riintegritit.

ËSHTË PËRMIRËSUAR SHFRYTËZIMI I PARASHIKUESHMËRISË DHE E TË DHËNAVE CILËSORE DHE NDARA PËR HSRTIM TË PËRMIRËSUAR TË POLITIKAVE PROGRESIVE, TË BAZUARA NË DËSHMI, TË ORIENTUAR DREJT REZULTATEVE DHE TRANSPATENTE

OKB-ja e ofroi ekspertizën e saj kolektive për të përmirësuar hartimin e politikave të bazuara në dëshmi, parashikuese dhe gjithëpërfshirës dhe për vizionin strategjik afatgjatë, të bazuar në të dhëna. Procesi i formulimit të Strategjisë së parë Kombëtare për Zhvillim që e përcakton rrugën e zhvillimit të vendit për dy dekadat e ardhshme ishte një pikë kthese për hartimin e politikave duke përfshirë gjithë qeverinë dhe gjithë shoqërinë. **UNDP-ja** e mbështeti përfshirjen dhe konsultimet me mbi 2.500 qytetarë dhe aktorë multisektorialë të zhvillimit në punëtoritë vizionare për SKZH-në dhe konsultimet për krijimin e të ardhmes. Paralelisht, u përpunuan 23 analiza bazë për fushat e rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, duke përfshirë arsimin, menaxhimin e ujit, infrastrukturën e transportit, menaxhimin e mbeturinave dhe infrastrukturën e mbeturinave, trashëgiminë kulturore, zhvillimin ekonomik, financat publike dhe politikën fiskale, rininë dhe sportin, turizmin, zhvillimin e barabartë rajonal, tregun e punës, planifikimin hapësinor, mjedisin jetësor, ndryshimet klimatike dhe vendbanimet, digjitalizimin, politikën sociale dhe sistemin e pensioneve, shëndetin dhe infrastrukturën shëndetësore, sistemin energjetik, sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit, institucionet publike, ekonominë e gjelbër dhe vendet e gjelbra të punës, dhe në fund, shkencën dhe hulumtimin. Përsëritja e parë e SKZH-së pritet të përfundojë para fundit të vitit 2023, së bashku me Planin e Veprimit për të operacionalizuar zbatimin e tij dhe për të krijuar kornizën për menaxhimin dhe financimin institucional të SKZH-së. UN Women kontribuoi në krijimin e të gjitha fushave të SKZH-së të përfshira në fazën fillestare të

REZULTATE TË DETAJUARA PËR VITIN 2022

zhvillimit të saj.

Në këtë drejtim, programi i përbashkët “Planifikimi dhe diskursi i politikave të migracionit të bazuara në dëshmi në Maqedoninë e Veriut”, i zbatuar bashkërisht nga UNHCR-ja, IOM-i dhe UNFPA-ja dhe institucione të ndryshme, u ndërmorën aktivitete për ngritjen e kapaciteteve dhe aktivitete të tjera. Vlerësimi i nevojave parashikuese i UNHCR-së për menaxhimin e migracionit në Maqedoninë e Veriut u bazua në hulumtim në zyrë dhe në 14 intervista me anëtarët kryesorë të palëve të interesuara kombëtare të Trupit Ndërqeveritar për Zhvillimin dhe Zbatimin e Politikës së Migracionit për periudhën 2021-2025 dhe me aktorë të tjerë përkatës. 328 përfaqësues të qeverisë, parlamentit, gjyqësorit, botës akademike, sektorit privat, OShC-ve, OJQ-ve, organizatave ndërkombëtare dhe të tjerë, i përmirësuan kompetencat e tyre për migracionin e parashikuar me mbështetjen e UNHCR-së dhe IOM-it. U zhvilluan tre mjete/mekanizma për menaxhimin e të dhënave për qëllimet e EShS-së. Gjithashtu, u siguroa mbështetje për prokurimin e sistemeve të reja të TI-së/bazave të të dhënave/softuerëve ose për përmirësimin e atyre ekzistuese në MSHIA, Njësinë e Analizës Kriminallistike të Zbulimit (OKRA) të MPB-së dhe BPRMV-së për të përmirësuar më tej mbledhjen dhe analizën e të dhënave për menaxhimin e migracionit dhe proceset e digjitalizimit të institucioneve.

Në kuadër të programit të njëjtë të përbashkët, UNFPA-ja, IOM-i dhe UNHCR-ja i rritën kapacitetet e partnerëve kombëtarë për shfrytëzimin e burimeve alternative të të dhënave. Analiza e gjendjes me remitanat u pasua nga një hulumtim kombëtar për remitanat, i cili i siguroi njohuri BPRMV-në për kanalet për pranimin marrjen dhe përdorimin e remitanancave nga familjet. Një përpjekje pioniere për hartëzimin e burimeve të mundshme të të dhënave për vlerësimet e migrimit duke përdorur të “Dhënat e mëdha” u përfundua duke u bazuar në Modelimin e Integruar të Statistikave Evropiane (MISE). U përforcuan kapacitetet e 169 aktorëve kombëtarë (ministri, institucioneve kombëtare, botës akademike shoqërisë civile), nga të cilat 108 gra (64%) dhe 61 burra (36%), mbi të dhënat për remitanat dhe aplikimin e “Të dhënave të mëdha” në vlerësimin e migracionit dhe hartimin e politikave. 44 përfaqësues nga institucione të ndryshme u trajnuan si për aplikimin e Modelit të Integruar të Statistikave Evropiane (MISE), ashtu edhe për modelin e ashtuquajtur pasqyra e statistikave.

Mbështetja e UNFPA-së për publikimin e parë zyrtar dhe shpërndarjen e rezultateve të Regjistrimit të popullsisë të vitit 2021 ishte me rëndësi thelbësore. Publikimi, që i përmban rezultatet kryesore dhe vizualizime, në format të shtypur dhe elektronik, i rriti njohuritë dhe ndërgjegjësimin për tendencat kryesore demografike në vend. Meqenëse Maqedonia e Veriut ishte vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që kreu regjistrimin e popullsisë duke përdorur metodologjinë e kombinuar të numërimit në terren dhe të të dhënave nga regjistrat e popullsisë, UNFPA-ja e mbështeti EShS-në në shpërndarjen e praktikave të mira në forume ndërkombëtare dhe rajonale. Mbështetje shtesë nga ekspertët u ofrua për zhvillimin e **Programit të ri për Hulumtimet Statistikore për periudhën 2023-2027**, duke i identifikuar nevojat përkatëse të të dhënave në dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare të ratifikuara, duke i kushtuar një segment të veçantë të analizës nevojave për të dhënat e treguesve të OZHQ-ve. Synimi i OZHQ-së 17.18. Rishikimi i Strategjisë për Politikën Demografike për periudhën 2022-2024 zbuloi fusha ku nevojitet një përgjigje më efektive e politikave ndaj sfidave demografike. Forumi rajonal “Ndërtimi i Qyteteve Miqësore për të Rinjtë në një Botë me 8 Miliardë Njerëz”, i organizuar në nëntor të vitit 2022 në Bosnjë dhe Hercegovinë, që mbledhi 120 kryetarë komunash, përfaqësues komunash dhe të rinj, u fokusua në pjesëmarrjen e të rinjve dhe përforcimin e rezistencës demografike në shoqëri.

MSHIA u mbështet me mbështetje teknike nga ITU për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare të TIK-ut për periudhën 2023-2027, e cila ofron një kornizë strategjike për procesin e transformimit të përsheptuar digjital të vendit përmes digjitalizimit të shërbimeve publike për qytetarët dhe bizneset, duke përfshirë teknologjitë e avancuara digjitale, siç është intelijenca artificiale, të dhënat e mëdha dhe shërbimet në re (cloud).

ËSHTË PËRMIRËSUAR KOHEZIONI SOCIAL DHE MIRËBESIMI PËRMES DIALOGUT DHE PJESËMARRJES DOMETHËNËSE NGA TË RINJTË, GRATË DHE PAKICAT ETNIKE DHE RELIGJIOZE, REFUGJATËT DHE GRUPET E TJERA TË CENUESHME

Në vitin 2022, OKB-ja e përforcoi kohezionin social duke promovuar pjesëmarrjen e të rinjve dhe grave dhe përfshirjen e njerëzve të lënë shumë më pas, si njerëzit me aftësi të kufizuara, emigrantët, refugjatët, azilkërkuesit, njerëzit pa shtetësi dhe disa pakica etnike. **UNDP-ja, UNFPA-ja dhe UNICEF-i** e mbështetën Agjencinë për Rini dhe Sport në krijimin e një Strategjie të re Kombëtare për të Rinjtë për periudhën 2023-2027. Nevojat dhe pikëpamjet e të rinjve me prejardhje të ndryshme u gjeneruan përmes përfshirjes së gjerë të të rinjve dhe konsultimeve përmes mjetit “U-Report” në të gjithë vendin. Procesi i themelimit të këshillave rinorë lokalë dhe fuqizimi i të rinjve u mbështet në pesë komuna.

Në kuadër të Projektit rajonal për të rinjtë, UNDP-ja dhe UNFPA-ja i zgjeruan partneritetet rreth narrativeve konstruktive për të përfshirë rrjetet mediatike rajonale, mediat publike dhe rrjetet lokale të mediave rinore dhe ndikuesit e rinj në mediat sociale. 35 nxënës të shkollave të mesme dhe 6 mësimsdhënës nga Maqedonia e Veriut i zgjeruan njohuritë e tyre mbi keqinformimin, dezinformimin dhe lajmet e rrejshme. Të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë në zonat rurale, shoqatat e nxënësve të shkollave të mesme dhe shoqatat e studentëve u përfshinë në përpjekjet për të ndërtuar besimin dhe mirëkuptimin reciprok.

UNICEF-i zgjeroi mundësitë që të rinjtë ta thonë fjalën e tyre në politikat kryesore kombëtare, duke përfshirë për Angazhimin Kombëtar për Transformimin e Arsimit – si pjesë e Samitit Global për Transformimin e Arsimit, për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, Strategjinë Kombëtare për Parandalimin dhe Drejtësinë për Fëmijët. Përfshirja e tyre përmes debateve të shumta të drejtpërdrejta, konsultimeve dhe mjetit “U-Report”, i cili i rriti bazën e tij në vitin 2022 nga 200 në 920 përdorues. Gjithsej 465 të rinj me prejardhje të ndryshme (shumica e të cilëve ishin vajza) morën pjesë aktive dhe zhvilluan 94 inovacione dhe produkte përmes katër programeve kryesore: UPSHIFT, Generation Unlimited (Gjenerata e pakufizuar), Mësimi Social dhe Emocional (SEL) dhe Drejtësia për Fëmijët (J4C). 150 të rinj morën pjesë në programin UPSHIFT të fokusuar në zgjidhjet e udhëhequra nga të rinjtë për sfidat e mjedisit jetësor në tre fusha: uji, ajri dhe energjia. Nga 30 zgjidhjet e zhvilluara, 15 morën fonde fillestare dhe u realizuan në komunitete. **Fushata në nivel kombëtar e UNICEF-it “Thjesht një fëmijë”** ngriti vetëdijen për fëmijët në kontakt me ligjin. Ajo tërhoqi 313.546 reagime dhe 315.783 shikime në rrjetet sociale. Programi inovativ i avokatëve për fëmijët dhe të rinjtë mundësoi një hapësirë të sigurt për 13 fëmijë dhe të rinj nga shtëpitë me grupe të vogla dhe institucioni edukues-korrektues për t’u takuar, bashkëpunuar dhe mësuar për të drejtat e tyre dhe për t’i ndarë përvojat dhe shqetësimet në lidhje me sistemin e drejtësisë. Programi ishte i dobishëm si për fëmijët në konflikt me ligjin, ashtu edhe për institucionet përgjegjëse për riintegrimin.

Në kuadër të programit të përbashkët “Planifikimi dhe

diskursi i politikave të migracionit të bazuara në dëshmi në Maqedoninë e Veriut”, i zbatuar bashkërisht nga UNHCR-ja, IOM-i dhe UNFPA-ja u promovuan narrative pozitive publike ndaj refugjatëve, azilkërkuessve dhe personave pa shtetësi në partneritet me OShC-të, të tilla si FAR-i, ShJRM-ja, mediat dhe aktorë të tjerë. U realizuan 87 aktivitete të transformimit të narrativeve, duke përfshirë përfaqësimin, Strategjinë e Komunikimit për Ndryshim Social, mbështetjen për Festivalin e Xhazit në Shkup dhe Maratonën e Shkupit dhe për ngjarje të tjera publike, dhe për fushatën kryesore “#IBelong” për t’i dhënë fund problemit të personave pa shtetësi deri në vitin 2024. Në bashkëpunim me Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, u pilotua programi i parë “Rruga e Arsimit” duke ofruar një mundësi për refugjatët dhe azilkërkuessit për t’u regjistruar në universitet, për të rritur pavarësinë e tyre dhe fuqizimin ekonomik dhe social.

UN Women mbështeti 13 organizata lokale të grave për t’i shprehur nevojat e tyre në vendimmarrjen lokale. Kjo rezultoi me 74 rekomandime të politikave për hartuesit e politikave për krijimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike lokale, duke përfshirë këshillimin për viktimat e dhunës në familje. Si rezultat i kësaj, mbi 3.000 gra nga komunitetet lokale u fuqizuan për t’i shprehur nevojat dhe prioritetet e tyre në vendimmarrjen lokale në 16 komuna (duke kontribuar në OZHQ 5.c; OZHQ 5.5; OZHQ 16.6; OZHQ 16.7). Përveç kësaj, UN Women mbështeti NALAS-in në organizimin e Forumit të katërt të kryetareve të komunave në EJL. Mbi 60 kryetarë të komunave dhe zyrtarë të nivelit lokal i shkëmbyen përvojat, praktikat më të mira dhe sfidat për promovimin e barazisë gjinore në jetën lokale.

OHCHR-ja dhe familja e OKB-së, partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë e shënuan së bashku Ditën e të Drejtave të Njeriut, duke i fuqizuar zërat dhe vizionin e të rinjve. Nën sloganin “Dinjitet, Liri dhe Drejtësi për të Gjithë”, 300 të rinj të moshave, gjinive dhe prejardhjeve të ndryshme, përmes veprave të artit u ngritën për të drejtat e tyre dhe të bashkëmoshatarëve të tyre që janë të cenueshëm dhe të padukshëm, dhe ndërmorën veprime për të drejta dhe liri të barabarta.

JANË RRIUR KAPACITETET KOMBËTARE DHE LOKALE PËR RIKUPERIMIN E PASURISË DHE LUFTIMIN E KORRUPSIONIT NË JETËN PUBLIKE PËRMES ZBATIMIT MË TË MIRË TË LIGJEVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE MASAVE PARANDALUESE

UNODC-ja e mbështeti qeverinë, organet e zbatimit të ligjit, prokurorinë, gjyqësorin dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm në zbatimin e Udhërrëfyesit të Ballkanit Perëndimor kundër Korrupsionit dhe Rikuperimit të Pasurisë së Paligjshme, si pjesë e procesit të Berlinit. U rritën kapacitetet e partnerëve kombëtarë për të luftuar korrupsionin institucional dhe atë të

nivelit të ulët, përmes mbështetjes dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Hetimet Financiare dhe Rikuperimin e Pasurisë. UNODC-ja propozoi ndryshime normative për të siguruar masa mbrojtëse për integritetin dhe llogaridhënien. Kanë filluar disa iniciativa të reja, duke përfshirë korrupsionin në sport, dhe luftimin e korrupsionit të nivelit të ulët.

UNDP-ja i mbështeti përpjekjet e vendit kundër korrupsionit në zbatimin e UNCAC (nenet 7, 8 dhe 10; si dhe nenet 53 deri 59) dhe përgatiti një Vlerësim të rreziqeve të korrupsionit brenda ndërmarrjeve publike kombëtare dhe komunale. Më shumë se 200 nëpunës publikë, kryetarë komunash dhe këshilltarë komunalë i rritën kapacitetet në fushat që lidhen me pushtetin lokal, mbikëqyrjen, anti-korrupsionin dhe menaxhimin e financave publike. UNDP-ja e lehtësoi bashkëpunimin ndërkufitar midis Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve. 415 policë nga vendi i rritën kapacitetet dhe shkëmbyen përvoja me kolegët e tyre për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, kategorizimin e armëve dhe konvertimin e tyre. Në të dy vendet u zhvilluan fushata të përbashkëta për ngritjen e vetëdijes mbi keqpërdorimin e armëve të vogla dhe të lehta dhe të shtënat festive. 200 policë u trajnuan si të përdorin Sistemin e ri të Menaxhimit të Informacionit të Policisë.